REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE

“Cilësia e ujërave në plazhe”

Tiranë, 2025

Shënim: Realizimi i këtij auditimi performance është kryer me mbështetjen e Institucionit Suprem të Auditimit të Norvegjisë, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit që KLSH ka nënshkruar me këtë institucion.

P Ë R M B A J T J A

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT 6

1.1 Konteksti i problemit social 6
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës 7
1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë 7
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim 7
2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim 10
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit 11
2.4 Pesha në buxhet 13
2.5 Përkufizimet dhe terminologjia 16
2.6 Skema e analizës së programit auditues 18
2.7 Feedback-u i subjektit në fazën studimore 19
3. DETAJET E AUDITIMIT 19

3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit 19
3.2 Objektivi i auditimit 20
3.3 Pyetjet e auditimit 21
3.4 Fushëveprimi i auditimit 21
4. SHJTELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT 22

4.1 A ka qenë efektiv procesi i menaxhimit të cilësisë së ujërave të larjes? 22
4.1.1 Si ka qenë ecuria e cilësisë së ujërave të larjes përgjatë periudhës 2019-2023? 22
4.1.2 A kanë marrë institucionet përgjegjëse masat e duhura për monitorimin e cilësisë së ujërave të larjes? 29
4.1.3 Pse nuk janë marrë masat e duhura për të mos ekspozuar popullsinë ndaj ujërave të larjes me cilësi të keqe? 33
4.2 A ka qenë efektiv procesi i trajtimit të ujërave të ndotura urbane nga institucionet përgjegjëse? 38
4.2.1 A ofrohet shërbimi i duhur i trajtimit të ujërave të ndotura urbane për popullsinë e bashkive subjekt auditimi? 39
4.2.2 A janë planifikuar dhe realizuar projekte dhe investime lidhur me trajtimin e ujërave të ndotura urbane në bashkitë subjekt auditimi? 48
4.2.3 Si ka funksionuar vendosja e impianteve individuale të trajtimit të ujërave të ndotura? 63
4.2.4 A janë zbatuar standardet mjedisore të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane në bashkitë subjekt auditimi? 77
5. Grupi i auditimit ..... Error! Bookmark not defined.
6.Anekset 82

AKRONIMET

RSH	Republika e Shqipërisë
BE	Bashkimi Evropian
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MPV	Ministri për Pushtetin Vendor
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKUK	Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve
NJVQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
ISHSH	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
VKM	Vendimi i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendimi i Këshillit Bashkiak
INTOSAI	The International Organization of Supreme Audit Institutions
EUROSAI	The European Organisation of Supreme Audit Institutions
ISSAI	International Standards of Supreme Audit Institutions
UK	Ujësjellës Kanalizime
SKP	Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta
ITUN	Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
SHRUK	Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime

PËRMBLEDHJA

Auditimi me temë "Cilësia e ujërave në plazhe" u realizua përgjatë periudhës maj 2024-qershor 2025 duke pasur si periudhë objekt auditimi 2019-2023 edhe pse në disa raste mund të jenë referuar periudha të tjera por vetëm me qëllim krahasimin e treguesve të ndryshëm. Auditimi u zhvillua në nëntë bashki dhe katër ministri si dhe disa institucione varësie të tyre. Të gjitha këto institucione kanë detyra dhe kanë përgjegjësi e detyrime që ndikojnë në cilësinë e ujërave në plazhe dhe masave që duhen ndërmarrë kur cilësia e tyre nuk është e mirë. Objektivi i këtij auditimi ishte vlerësimi i procesit të monitorimit të cilësisë së ujërave të larjes si dhe trajtimi i ujërave të ndotura urbane që ndikojnë në cilësi jo të mirë të ujërave në plazhe.

Cilësia e ujërave në plazhe në Shqipëri është prej vitesh ndër më të ultat në Evropë. Viti 2023 ka rezultuar si viti me cilësinë më të keqe të ujërave të plazheve në Shqipëri të paktën për 5-6 vitet e fundit. Një arsye e rëndësishme për këtë cilësi të dobët është mungesa e kapaciteteve për trajtimin e ujërave të ndotura urbane. Në 9 bashkitë subjekt auditimi kapaciteti real i trajtimit të ujërave të ndotura urbane sigurohet për vetëm 20 % të popullsisë rezidente. Megjithatë, rritja e numrit të turistëve në zonat bregdetare gjatë muajve të verës bën që përqindja e ujërave të trajtuara të jetë edhe më e ulët. Përveç kapacitetit të përgjithshëm të ulët të rrjetit publik të tubacioneve, kapaciteti i ulët i trajtimit lidhet gjithashtu me faktin që shumë aktivitete ekonomike (hotele, resorte etj) përgjatë bregdetit nuk kanë respektuar detyrimin ligjor për të instaluar pajisjet e nevojshme të trajtimit të ujërave të ndotura urbane.

Auditimi gjithashtu ka zbuluar mangësi të mëdha sistematike në mënyrën se si autoritetet kanë ndjekur kërkesat për procesin e monitorimit të cilësisë së ujërave të larjes, njoftimin e popullsisë në rastet kur cilësia e ujërave në plazhe ka rezultuar e keqe dhe më e rëndësishmja zbatimin e ligjeve që synojnë të garantojnë cilësi të mirë të ujërave për larje. Auditimi ka nxjerrë në pah se kuadri ligjor e rregullator është i pa qartë dhe i pa harmonizuar sa i përket përgjegjësive institucionale lidhur me procesin e monitorimit të cilësisë së ujërave të larjes.
Agjencia Kombëtare e Mjedisit, nuk ka informuar në mënyrë periodike dhe në kohë të gjitha bashkitë në raste kur kanë rezultuar ujëra të plazheve me cilësi të keqe. Për më tepër, nga auditimi ka rezultuar se bashkitë që marrin informacion nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për cilësi të keqe të ujërave të larjes (plazheve) nuk kanë njoftuar popullatën dhe turistët për këtë, siç kërkohet.

Autoritetet përgjegjëse nuk kanë përgatitur një plan të detajuar për mënyrën e financimit dhe ndërtimit të një numri të mjaftueshëm impiantesh trajtimi për të arritur objektivin prej 26 për qind mbulim të popullsisë deri në vitin 2030. Auditimi tregon se investimet lidhur me impiantet e trajtimit të ujërave të ndotua urbane kanë ardhur në rënie nga viti në vit dhe se një pjesë e madhe e fondeve shtetërore mbulojnë vetëm funksionimin e impianteve ekzistuese. Për të rritur investimet në impiante trajtimi, autoritetet aktualisht varen më shumë nga fondet e jashtme. Mungesa e diversifikimit të burimeve financiare kufizon mundësinë për zgjerimin e investimeve dhe shton presionin mbi buxhetin publik. Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve nuk ka informacion të plotë dhe të detajuar për investimet dhe projektet e zbatuara nga institucione të tjera që lidhen me sektorin e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Kuadri ligjor nuk përcakton qartë përfshirjen e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizime në të gjitha projektet (pavarësisht kush i zbaton ato) që zhvillohen në fushën e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

Ligji për Trajtimin e Ujërave të Ndotura i miratuar në vitin 2003 synonte të siguronte që të gjitha subjektet që gjenerojnë ujëra të ndotura urbane, të marrin masa për trajtimin mjedisor të tyre. Autoritetet përgjegjëse nuk e kanë ndjekur zbatimin e këtij ligji. Krijimi i Task-Forcës (referuar Aktit Normativ nr. 8 datë 28.12.2023), kishte për qëllim t'i jepte një shtysë zbatimit të këtij ligji i cili për dekada thuasje ishte i pa zbatuar. Megjithatë, auditimi tregon se Task-Forca ka hasur

në vështirësi së pari sa i përket identifikimit të subjekteve që duhet të zbatojnë Aktin Normativ nr. 8 dhe së dyti detyrimin e subjekteve për vendosjen e impianteve individuale të trajtimit të ujërave të ndotura urane. Nga rreth 2400 subjekte të identifikuara nga Task-Forca, rreth 150 prej tyre e kanë vendosur impiante.

Nga ana tjetër krahas impianteve individuale, impiantet qendrore të trajtimit të ujërave të ndotura urbane në administrim të Shoqërive Rajonale të Ujësjellës Kanalizimeve nuk kanë garantuar trajtim të duhur të ujërave të ndotura urbane për disa arsye. Së pari, disa prej tyre nuk kanë qenë të pajisur me leje mjedisi për disa vite, disa të tjerë nuk kanë monitoruar periodikisht treguesit mjedisorë dhe thuajse të gjithë këto impiante janë ballafaquar me shkarkime të ujërave industriale, bujqësore, etj., kur ndërkohë ata janë projektuar për të trajtuar vetëm ujërat e zeza.

Kjo është një situatë shumë serioze dhe kërkon koordinim dhe ndjekje rigoroze të detyrimeve institucionale nga institucionet përgjegjëse për përmirësimin e situatës së ujërave në plazhe. Për të gjitha problematikat e adresuara më sipër, janë dhënë rekomandime veçanërisht për shkaqet e tyre në mënyrë që të identifikohet sa më qartë rruga drejt përmirësimit.

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT
1.1 Konteksti i problemit social

Uji në të cilin ne notojmë mund të ndotet nga bakteret *Escherichia coli* – ose E. coli – dhe *enterokoket* e zorrëve që mund të shkaktojnë sëmundje. Zakonisht, këto baktere rrjedhin nga ujërat e zeza të patrajtuara që përfundojnë në ujërat e larjes (plazheve)[1]. Përmirësimi i cilësisë së ujërave të larjes ndodh kryesisht për shkak të përmirësimit të trajtimit të ujërave të zeza.[2]
Klasifikimi i ujërave të larjes ofron një panoramë të plotë dhe afatgjatë të cilësisë bakteriologjike të tyre dhe gjithashtu tregon se sa mirë po menaxhohet disa nga shkaqet kryesore (kryesisht shkarkimi i ujërave të ndotura urbane). Si i tillë, ky është një vlerësim shumë më i kufizuar dhe i fokusuar sesa vlerësimi i statusit të mirë ekologjik dhe kimik të ujërave sipërfaqësore që kërkohet nga Direktiva Kuadër për Ujërat dhe statusi i mirë mjedisor i Direktivës së Strategjisë Detare. Ndotja e ujit rregullohet nga legjislacioni tjetër i BE-së, në veçanti nga Direktiva 91/271 për trajtimin e ujërave të ndotura urbane. Masat e vendosura në Direktivën e ujërave të larjes janë të projektuara për të mbrojtur njerëzit në përgjithësi por edhe gjatë rasteve të ndotjeve të mëdha, të cilat ndikojnë në mënyrë akute në shëndetin e atyre që lahen në plazhe. Direktiva e ujërave të larjes gjithashtu ndihmon në mbrojtjen kundër kërcënimeve të tjera, të tilla si ato që rrjedhin nga lulëzimi i dëmshëm i algave, mbetjet e katranit, qelqi, plastika, goma dhe mbetje të tjera. Për të parandaluar ekspozimin e njerëzve ndaj ndotjes së ujërave në plazhe, është e nevojshme të jepen paralajmërime të përshtatshme gjatë sezonit të larjes. Ndaj edhe kuadri ligjor kërkon informimin e publikut rreth ndalimeve të larjes ose këshillave kundër larjes, paralajmërimet në lidhje me ndotje të ndryshme, kategorizimi i ujërave të larjes si dhe lloji apo kohëzgjatja e pritshme e rrethanave të jashtëzakonshme.[3]
Progres Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë ka konstatuar se për të siguruar përparim në *acquis communitare* për ujërat, Shqipëria duhet të rrisë ndjeshëm burimet buxhetore dhe kapacitetin zbatues të agjencive kryesore kombëtare të ujit dhe të miratojë një plan zhvillimi kapacitetesh. Përveç kësaj, monitorimi i cilësisë së ujërave është i pamjaftueshëm. Performanca e sektorit të shërbimeve të kanalizimeve mbetet përgjithësisht e ulët. Strategjia Kombëtare e Sektorit të Ujësjellës Kanalizimeve për periudhën 2023-2030 është miratuar nga Qeveria Shqiptare në korrik 2023. Ekziston gjithashtu nevoja që të sigurohet përafrim i plotë me Direktivën e trajtimit të ujërave të ndotura urbane, zgjerim i rrjeteve të kanalizimeve, licencimi dhe aplikimi i tarifave të përshtatshme për të gjitha impiantet e trajtimit të ujërave të zeza si dhe të ndërtohen impiante të reja, veçanërisht në zonat urbane dhe bregdetare me zhvillim të lartë turistik.[4]
Një nga arsyet kryesore të realizimit të këtij auditimi është gjendja jo e mirë e cilësisë së ujërave në plazhet e Shqipërisë në vitet e fundit. Raporti i Agjencisë Evropiane të Mjedisit bazuar në monitorimin e cilësisë së ujërave të larjes për vitin 2023 e vendos Shqipërinë në vend të fundit në Evropë. Ky raport mori një vëmendje të gjerë në median shqiptare verën e vitit 2024.[5] Në një kohë që Shqipëria po arrin rekorde[6] sa i përket numrit të turistëve në vitet e fundit, vendi ynë po ballafaqohet me një krizë të madhe mjedisore duke qenë vendi me përqindjen më të madhe të ujërave të larjes (plazheve) me cilësi të keqe. Ndaj nëse duam që ky trend dhe ky numër i madh turistësh të mos ulet në vitet pasuese duhet një reagim shumë i shpejtë nga të gjitha institucionet përgjegjëse me qëllim përmirësimin e cilësisë së ujërave në plazhe.

[1] Sqarim: Termi "ujëra të larjes" përcaktohet në terminologjinë e kuadrit ligjor kombëtar dhe evropian. Ky term ka të njëjtin kuptim me "ujëra në plazhe" i cili është përdorur për ta bërë më të qartë për lexuesin.
[2] https://www.eea.europa.eu/en/topics/in-depth/bathing-water
[3] European Environment Agency, European bathing water quality in 2023, fq 10.
[4] https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/ea0a4b05-683f-4b9c-b7ff-4615a5fffd0b_en?filename=SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf fq 121
[5] https://top-channel.tv/2024/06/12/inside-story-zbulohet-raporti-i-agjencise-europiane-te-mjedisit-shqiperia-e-fundit-per-cilesine-e-ujit2/
[6] https://shqiptarja.com/lajm/bumi-turistik-mbi-2-milione-turiste-vizituan-shqiperine-vetem-gjate-gushtit

1.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 3910 dhe 3920), Manuali i Auditimit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, eficienca dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit. KLSH nëpërmjet këtij auditimi synon të paraqesë situatën aktuale në lidhje me cilësinë e ujërave në plazhet e vendit tonë duke synuar që të adresojë shkaqet kryesore që çojnë në cilësi jo të mirë të këtyre ujërave.

1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë

Kontrolli i Lartë i Shtetit në veprimtarinë e tij audituese, gjatë viteve të fundit i ka kushtuar një rëndësi gjithmonë e më të madhe auditimit të veprimtarisë së institucioneve publike sa i përket cilësisë së ujërave detare pjesë e së cilave janë edhe ujërat e larjes në bashkitë subjekt të këtij auditimi si edhe menaxhimit të burimeve ujore. Lidhur me tematika të ngjashme, KLSH ka kryer:

- Auditimin e performancës me temë "Ndotja e menjëhershme e Jonit dhe Adriatikut" bazuar në programin e auditimit nr. 10/6 prot., datë 13.05.2020, i cili konkludoi me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 118, datë 30/10/2020. Ky auditim u ushtrua në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Bashkitë Shkodër, Fier si dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar. Një ndër gjetjet kryesore të këtij auditimi ishte mos hartimi i një strategjie për mbrojtjen civile si dokument bazë që përcakton politikat dhe objektivat për të zvogëluar risqet e fatkeqësive, me qëllim garantimin e mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore e të mjedisit, nëpërmjet forcimit të sistemit të mbrojtjes civile. Ky auditim ka vlerësuar gjithashtu, se shkaku i ndotjes së ujërave vjen nga mos trajtimi i ujërave të ndotura urbane.
- Auditimin e performancës me temë: "Menaxhimi i burimeve ujore" bazuar në programin e auditimit nr. 107/4 prot., datë 05.05.2022, i cili konkludoi me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 168, datë 19.09.2022. Ky auditim u ushtrua në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore si dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Një nga problematikat kryesore të evidentuara gjatë këtij auditimi është mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional, veçanërisht sa i përket kontrollit dhe inspektimit të përdoruesve të jashtëligjshëm të burimeve ujore, por dhe mungesa e burimeve njerëzore e logjistike në institucionet përgjegjëse, janë ndër arsyet kryesore të një menaxhimi jo efektiv të burimeve ujore në vend.

2. SUBJEKTET NËN AUDITIM

2.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Menaxhimi i cilësisë së ujërave në plazhe është një proces kompleks që kërkon bashkëpunimin dhe koordinimin e disa institucioneve dhe agjencive. Në Shqipëri, përgjegjësia për mbrojtjen dhe menaxhimin e cilësisë së ujërave larës ndahet mes disa enteve qendrore dhe lokale. Në këtë nënkapitull do të prezantohen subjektet e përfshira në auditimin e cilësisë së ujërave plazhe, duke përshkruar funksionin dhe rolin e tyre në këtë proces.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është përgjegjëse për formulimin dhe zbatimin e politikave mjedisore dhe të turizmit në Shqipëri. Ajo ka përgjegjësinë për të siguruar transpozimin e të gjitha aspekteve mjedisore kryesorë të ujit si dhe direktivave të BE-së. [7] Ajo luan një rol kyç në promovimin e praktikave të qëndrueshme që ndihmojnë në ruajtjen e cilësisë së ujërave larës dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka si mision hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore për zhvillimin e infrastrukturës, përfshirë transportin dhe rrjetin e ujësjellës-kanalizimeve. Ajo vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke drejtuar, mbikëqyrur dhe vendosur standarde teknike për infrastrukturën. Ministria monitoron gjithashtu zbatimin e këtyre standardeve për zhvillimin e rrjetit të ujësjellës-kanalizimeve, e cila ndikon direkt në mbajtjen e ujërave larës të pastra.[8]

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor. Kjo ministri është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti.[9] MSHMS është gjithashtu institucioni përgjegjës për drejtimin dhe koordinimin e zbatimit të rregullores higjieno-sanitare për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes, të miratuar me VKM nr. 797, datë 29.09.2010. Kjo rregullore është një instrument i rëndësishëm për menaxhimin e cilësisë së ujërave në plazhe dhe luan një rol kyç në mbrojtjen e shëndetit publik, nëpërmjet monitorimit të parametrave të ujit, inspektimeve të rregullta dhe informimit të vazhdueshëm të publikut mbi gjendjen e ujërave të larjes.

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor
Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor ka disa përgjegjësi ku ndër më kryesoret është bashkërendimi i punës për propozimin, përmirësimin dhe hartimin e projekt-akteve ligjore e nënligjore në fushën e decentralizimit e të qeverisjes vendore, si dhe jep mendim për projekt-aktet që kanë të bëjnë me çështje të lidhura me njësitë e vetëqeverisjes vendore.[10] Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor nuk ka një rol të drejtpërdrejtë mbi menaxhimin e cilësisë së ujërave në plazhe por, ndjek zbatimin e politikave të decentralizimit dhe monitorimin e funksioneve të deleguara, ku përfshihet transferimi i funksioneve për mbrojtjen e mjedisit dhe shërbimet publike nga bashkitë.

Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime (AKUK)
Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime menaxhon sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri, nën varësinë e Ministrisë së dhe Infrastrukturës dhe energjisë.[11] Ajo harton strategjinë për zhvillimin e sektorit dhe planifikon investimet për ndërtimin, rehabilitimin dhe zgjerimin e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve dhe impianteve të trajtimit të ujërave të

[7] VKM nr. 448, datë 26.7.2023 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023–2030", fq 9.
[8] Vendim nr. 111, datë 2.3.2022 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë".
[9] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 55
[10] Vendim nr. 557, datë 4.10.2023 "Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrit të Shtetit Për Pushtetin Vendor"
[11] VKM Nr. 617, date 1.11.2023, për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 431, datë 11.7.2018 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare Ujësjellës-Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve"

ndotura. AKUK mbikëqyr projektet që financohen nga buxheti i shtetit, bashkitë, shoqëritë e "Ujësjellës-Kanalizimeve" dhe institucionet ndërkombëtare, duke siguruar zbatimin e rregullave teknike dhe monitorimin e tyre.[12]

Instituti i Shëndetit Publik (ISHP)
ISHP është institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përgjegjës për marrjen e kampioneve dhe analizimin mikrobiologjik të ujërave larës, të marr nga stacionet e caktuara para, gjatë dhe pas sezonit të larjes. Instituti i Shëndetit publik së bashku me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit kanë bërë një kontratë shërbimi[13] mbi monitorimin mikrobiologjik të ujërave të larjes.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)
Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ka si funksion monitorimin e cilësisë së mjedisit në Shqipëri.[14] Rezultatet që ISHP gjeneron gjatë vlerësimit të cilësisë së ujërave të larjes i përcillen AKM-së. Këto rezultate AKM i pasqyron në Raportin e Gjendjes së Mjedisit i cili është një raport i përvitshëm ku krahas të dhënave të tjera mbi tregues të ndryshëm mjedisorë publikohen edhe të dhënat mbi cilësinë e ujërave të larjes.

Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH)
Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, në varësi të MSHMS-së, ka për mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik. ISHSH-ja është përgjegjëse për të gjitha funksionet e inspektimit[15] të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, me përjashtim të inspektimit të veprimtarive në fushën farmaceutike. ISHSH-ja organizohet në dy nivele: në nivel qendror dhe atë rajonal, për çdo qark të vendit. ISHSH përpara dhe gjatë sezonit turistik kryen inspektimin higjeno sanitar të plazheve, për të caktuar burimet e mundshme direkte dhe indirekte të ujërave të zeza.

Bashkitë
Bashkitë e përzgjedhura në këtë auditim janë:

- Bashkia Shkodër
- Bashkia Lezhë
- Bashkia Kavajë
- Bashkia Durrës
- Bashkia Lushnje
- Bashkia Rrogozhinë
- Bashkia Fier
- Bashkia Vlorë
- Bashkia Himarë

Vetëqeverisja Vendore ka një funksion të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit në tërësi por dhe marrjen e masave konkrete që kanë të bëjnë me njoftimin e publikut për cilësinë e keqe që rezulton nga monitorimi i ujërave të larjes e deri në kufizimin apo ndalimin për përdorim të këtyre plazheve. Para vitit 2022 shërbimi i kanalizimeve dhe trajtimeve të ujërave të ndotura ishte përgjegjësi direkte e Ujësjellës-Kanalizimeve të cilat ishin në varësi të bashkive. Me

[12] VKM nr. 431, datë 11.7.2018 "Për krijimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe të infrastrukturës së mbetjeve".
[13] Kontrata e Shërbimit Nr. 94/1 prot, datë 14.04.2021, Nr. 227/1 prot, datë 28.04.2022, Nr.74/2 prot, datë 07.04.2023 të lidhura ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Institutit të Shëndetit Publik.
[14] Rregullore e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit, Nr. 120 datë 12.01.2021, neni 5, pika f.
[15] Ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

reformën e 2022, [16] u ristrukturua i gjithë organizimi lidhur me shërbimin e ujësjellës kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane. Pas 2022 u krijuan shoqëritë aksionere të ujësjellës-kanalizime mbi baza "rajonale" ku përqindjen më të madhe të vlerës së aksioneve të çdo UK të krijuar e ka MIE me 51 %, ndërsa 49 % ndahet midis bashkive pjesëmarrëse në shoqërinë e re.

2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

Kritere politike:

- Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2019 – 2021;
- Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2023 – 2025[17];
- VKM nr. 448, datë 26.7.2023 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023–2030".

Kritere teknike:

- Ligji nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura";
- Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011,"Për lejet e mjedisit", i ndryshuar;
- Ligji nr.8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar;
- Ligji nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar;
- Ligji nr. 93/2015 "Për turizmin";
- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- VKM nr. 797, datë 29.09.2010 "Për miratimin e rregullores higjieno-sanitare për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes";
- VKM nr. 177, datë 31.03.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse";
- VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura";
- VKM nr. 171, datë 27.03.2019 "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" të ndryshuar;
- VKM nr. 83, datë 10.02.2021 "Për miratimin e rregullave teknike të projektimit e të ndërtimit për furnizimin me ujë dhe kanalizimin";
- VKM nr. 557, datë 04.10.2023 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor";
- VKM nr. 568, datë 17.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare Të Mjedisit";
- VKM nr. 431, datë 17.07.2018 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve", të ndryshuar;
- VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 "Për miratimin e modelit të rregullores për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve sh.a.";
- Akt Normativ nr. 8, datë 28.12.2023 "Për marrjen e masave urgjente, për mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës, për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse" ;
- Rregullorja e Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Mjedisit";
- Rregullorja e Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë";
- Rregullorja e Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe agjencive rajonale të mjedisit" ;

[16] VKM nr. 302, datë 11.5.2022 "Për Politikat Kombëtare Për riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura".
[17] Miratuar me Vendimin Nr. 122, datë 01.03.2023.

- Rregullore e Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve ";
- Urdhër nr. 20, datë 01.03.2023 "Për ngritjen e Task-Forcës Ndërinstitucionale të sezonit turistik veror 2023";
- Urdhër nr. 69, datë 30.04.2024 "Për ngritjen e Task-Forcës Ndërinstitucionale të sezonit turistik veror 2024";
- Udhëzim i përbashkët nr. 1, datë 01.02.2024, "Për miratimin e rregullores teknike mbi standardet për trajtimin e ujërave të ndotur për subjektet që shkarkojnë ujëra të ndotur dhe të pa trajtuara pranë ose në ujëra larës";
- Udhëzim nr. 2, datë 26.03.2024 "Për miratimin e metodologjisë, për kriteret dhe procedurat, për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore, për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, për vitin buxhetor 2024";

Raporte monitorimi dhe raportimi:

- Raporte vjetore të gjendjes së mjedisit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit
- Raporti i Agjencisë Evropiane të Mjedisit, 2023
- Raporte monitorimi për shkarkimet mbi normat e lejuara të ITUN nga UK- të rajonale

Praktikat e mira:

- Direktiva 2006/7/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian "Mbi menaxhimin e cilësisë së ujërave të larjes"
- Direktiva 91/271/EEC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian "Mbi trajtimin e ujërave të zeza urbane"
- Direktiva 86/278/EEC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian "Për mbrojtjen e mjedisit, dhe në veçanti të tokës, kur llumi i ujërave të zeza përdoret në bujqësi"
- National Audit Office of Latvia, Audit report on water supply and waste water managment, 2020;
- Performance Audit on Sewage Management in Chennai Metropolitan Area;
- National Audit Office of Poland, Organization and Maintenance of Bathing Areas and Places Used for Bathing, 2014;
- Hartimi i profileve të ujërave të larjes, Slloveni.[18]

2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit

Një ndër dokumentet kryesore të përgatitur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është Strategjia Kombëtare për zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023. Duhet kuptuar që cilësia e ujërave në plazhe ndikon drejtpërsëdrejti në turizmin bregdetar. Turizmi bregdetar i referohet aktiviteteve që zhvillohen në buzë të detit si noti, banjat e plazhit dhe aktiviteteve të tjera rekreative të lidhura me to. Plazhi, deti dhe dielli janë prej vitesh produkti kryesor që zënë peshën më të madhe në totalin e produkteve turistike.[19] Ky lloj turizmi në Shqipëri ka një karakter të theksuar sezonal dhe kjo shpjegohet edhe me fluksin e turistëve në muajt e verës.

Raporti i Gjendjes në Mjedis

Bazuar në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit përgatitet Raporti i Gjendjes së Mjedisit i cili është një dokument që përgatitet çdo vit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe ku paraqiten, komentohen dhe analizohen treguesit mjedisorë (përfshirë edhe ujërat e larjes), si dhe jepen rekomandimet për përmirësimin e tyre. Qëllimi kryesor i vlerësimit të gjendjes së mjedisit është që të kuptohen pasojat ose ndikimet në mjedis që vijnë nga sektorë të ndryshëm dhe të identifikojë mënyrat për të minimizuar ndikimet negative. Monitorimi i treguesve të

[18] https://www.gov.si/teme/kopalne-vode/
[19] Strategjia Kombëtare për zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023, fq 6.

cilësisë së ujërave të larjes kryhet nga Instituti i Shëndetit Publik i cili nënkontraktohet për këtë shërbim nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Të dhënat që rezultojnë nga procesi i monitorimit të cilësisë së ujërave të larjes publikohen çdo vit në Raportin e Gjendjes së Mjedisit, të dhëna këto që gjithashtu përcillen në Agjencinë Evropiane të Mjedisit. Duke qenë se një ndër fokusimet kryesore të këtij auditimi do to jetë edhe trajtimi i ujërave të ndotura urbane grupi i auditimit ka përmbledhur në vijim disa nga dokumentet kryesore politike lidhur me këtë çështje.

Strategjia Kombëtare e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve

Këshilli i Ministrave me anë të VKM-së nr. 448, datë 26.7.2023 ka miratuar Strategjinë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve (SKSFUK) 2023-2030. Në analizën e përgjithshme të faktorëve, të cilët kanë një ndikim domethënës në qasjen strategjike që do të synohet të implementohet në sektorin e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, grupi i punës është ndalur në mënyrë të veçantë në tre prej tyre:

- faktori demografik;
- faktori hidrologjik;
- faktori zhvillimor

Faktori i parë, i cili është marrë në shqyrtim për të analizuar skenarët e zhvillimit të sektorit, si dhe për të dakordësuar mbi qasjen për përmbushjen e vizionit dhe misionit të Strategjisë, është ai demografik. Arsyeja e analizimit të këtij faktori ka të bëjë drejtpërdrejtë me thelbin e kësaj Strategjie, e cila ka si qëllim përmbushjen e nevojave të të gjithë popullatës me kanalizime. Shqipëria ka rreth 476 km vijë bregdetare, nga të cilat 326 km në detin Adriatik dhe 150 km në detin Jon. Në zonën e ultësirës perëndimore të Shqipërisë ku shtrihet zona bregdetare (dhe territori administrative i 9 bashkive subjekt auditimi) është përqendruar edhe numri më i madh popullsisë të vendit tonë (rreth 70 %). Faktori i tretë i rëndësishëm për t'u mbajtur në konsideratë është dhe ai i zhvillimit social-ekonomik të vendit, ku kryesisht për efekt të këtij dokumenti strategjik, rëndësi të veçantë merr analiza e zhvillimit të sektorit të turizmit, duke u fokusuar më specifikisht në numrin e turistëve të huaj, të cilët do të duhet të merren në konsideratë si nevoja shtesë për të marrë masa për largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane me sasi të shtuara.[20]

Krahas shtjellimit dhe përshkrimit të kuadrit ligjor e rregullator, situatës aktuale sa i përket trajtimit të ujërave të ndotura urbane si dhe aspekteve financiare lidhur me to, Strategjia (SKSFUK) ka përcaktuar edhe dy objektiva kryesore që lidhur me kanalizimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura. Konkretisht këto dy objektiva janë:

- Rritja e aksesit të popullsisë të lidhur me sistemin e grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura urbane (55.5 % deri në 2025 dhe 65.5 % deri në 2030);
- Rritja e aksesit të popullsisë të lidhur me një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura urbane (16.5 % deri në 2025 dhe 26 % deri në 2030);

VKM nr. 302, datë 11.5.2022 "Për Politikat Kombëtare Për riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura

Qëllimi i riorganizimit të sektorit të largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura është të përmirësojë shërbimin e kanalizimeve në të gjithë territorin e vendit tonë duke plotësuar nevojat e një ekonomie në zhvillim, duke mbrojtur mjedisin, shëndetin e sigurinë e qytetarëve. Për kryerjen e trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe MIE për riorganizimin e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjellës kanalizimeve. Kjo VKM ka përcaktuar edhe formatin "tip" për krijimin e subjekteve me kompetenca të përbashkëta të ujësjellës-Kanalizimeve (SKP-UK) ose siç njihen ndryshe edhe shoqëritë rajonale të Ujësjellës-Kanalizimeve. Bazuar në këtë VKM në shoqëritë e reja të krijuara ose SKP-UK është gjithmonë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë që zotëron 51 % të aksioneve dhe 49 % ndahet midis bashkive pjesëmarrëse në këto

[20] Strategjia Kombëtare e furnizimit me ujë dhe e kanalizimeve 2023-2030, fq 5

shoqëri të reja. Kështu, të gjitha bashkitë subjekt i këtij auditimi janë dakordësuar, për themelimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës Kanalizimeve (SKP-UK), kanë nënshkruar, marrëveshjen dhe statutin tip, të cilat shërbejnë si akte themelore për krijimin e SKP-UK. Më datë 28.06.2022 është lidhur marrëveshja "Për krijimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a" midis bashkive Durrës, Kavajë dhe Rrogozhinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, pjesë e së cilës është edhe Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve, e protokolluar në AKUK me nr. 1567 prot. datë 25.07.2022. Edhe bashkitë e tjera kanë lidhur marrëveshje të ngjashme sipas formatit të përcaktuar në VKM nr. 302. Kështu, Bashkia Vlorë dhe Himarë bëjnë pjesë në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë sh.a e themeluar sipas marrëveshjes më datë 13.07.2023 e protokolluar në AKUK me nr. 1289 prot datë 14.07.2023. Bashkia Fier sipas marrëveshjes së lidhur me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë më datë 22.07.2022 bën pjesë në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a. Bashkia Lezhë sipas marrëveshjes së lidhur me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë më datë 22.07.2022 bën pjesë në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë sh.a. Bashkia Shkodër sipas marrëveshjes së lidhur me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë më datë 19.01.2023 bën pjesë në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a.

2.4 Pesha në buxhet

Agjencia Kombëtare Ujësjellës Kanalizime

AKUK është person juridik publik, buxhetor në varësi të ministrit përgjegjës për infrastrukturën. AKUK financohet nga buxheti i shtetit dhe çdo burim tjetër i ligjshëm financimi, sipas parashikimit të legjislacionit në fuqi për statusin që institucioni ka bazuar në VKM nr. 431 datë 11.07.2018, për ngritjen dhe funksionimin e saj.[21] Për periudhën 2019-2023, nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime rezultojnë të dhënat si më poshtë.

Tabela nr. 1 Fonde buxhetore AKUK për periudhën 2019-2023

Tavanet Buxhet Shteti e ndare në Komponent viti 2019-2023						
Emërtimi	**Monedha**	**Viti 2019**	**Viti 2020**	**Viti 2021**	**Viti 2022**	**Viti 2023**
Total Ujesjelles+ kanalizime + Impiante (Buxheti i Shtetit)	000/lek	**4,139,814**	**7,904,355**	**12,910,076**	**8,428,225**	**12,203,565**
Total Ujesjellësa		**2,532,078**	**6,320,704**	**11,520,434**	**6,656,035**	**10,247,290**
Buxheti i Shtetit	000/lek	2,532,078	6,320,704	11,520,434	6,656,035	10,247,290
Total Kanalizime		**616,402**	**686,241**	**866,795**	**934,381**	**1,167,204**
Buxheti i Shtetit	000/lek	616,402	686,241	866795	934,381	1,167,204
Total Impiante (ITUN)		**355,222**	**215,599**	**176,130**	**80,650**	**416,496**
Buxheti i Shtetit	000/lek	355,222	215,599	176130	80,650	416,496
Tvsh dhe Kosto Lokale		**636,112**	**681,811**	**346,717**	**757,159**	**372,576**

Burimi: AKUK

[21]Urdhër nr. 88 datë 24/02/2020 Për miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e AKUM, Neni 20.

Grafiku 1. Paraqitja grafike e ecurisë së fondeve buxhetore AKUK për periudhën 2019-2023.



Burimi: AKUK, Përpunoi: Grupi i auditimit

Graf. 2. Ecuria e fondeve buxhetore për Impiantet e Trajtimit të Ujërave të Ndotura. 2019-2023.



Burimi: AKUK, Përpunoi: Grupi i auditimit

Siç vihet re edhe nga grafikët e mësipërm fondet buxhetore të AKUK, pasqyrojnë një trend në rritje nga viti 2019 deri në vitin 2021 nga 4,139,814,000 lekë në 12,910,076,000 lekë. Ndërkohë për të njëjtën periudhë fondet e përdorura për ITUN shënojnë një rënie të ndjeshme, nga 355,222,000 lekë në vitin 2019 në 176,130,000 lekë. Në vitin 2022 fondet buxhetore shënojnë një rënie në raport me vitin 2021 nga 12,910,076.000 lekë në 8,428,225,000 lekë, në vlerë 4l481,851,000 lekë, ose në masën 34.7%. Ndërkohë për të njëjtën periudhë, viti 2022 shënon pikën më të ulët të fondeve të përdorura për ITUN gjatë periudhës 2019-2022. Përkundrejt vitit paraardhës 2021 shënohet rënie nga 176,130,000 lekë në 80,650,000, në vlerë 95,480,000 lekë ose rreth 54%. Në vitin 2023 shënohet përsëri një rritje e fondeve buxhetore në raport me vitin paraardhës, nga 8,428,225,000 lekë në 12,203,565,000 lekë, në vlerë 3,775,340,000 lekë ose në masën 30.9%. Sa i përket fondeve buxhetore për ITUN, ato shënojnë një rritje të ndjeshme gjatë vitit 2023, duke shkuar në përpjesëtim të drejtë me trendin e fondeve buxhetore të AKUK për të njëjtën periudhë. Në raport me vitin paraardhës fondet buxhetore të ITUN kanë shkuar nga 80,650,000 lekë në vitin 2022 në 416,496,000 lekë në vitin 2023, duke u rritur me 335,846,000 lekë ose ndryshe me 80.6%.

Tabela nr. 2 Pesha specifike (%) që zënë fondet për ITUN në totalin e fondeve buxhetore të AKUK.

Fonde buxhetore	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Buxheti total AKUK (në mijë lekë)	4,139,814	7,904,355	12,910,076	8,428,225	12,203,565
Buxheti për ITUN (në mijë lekë)	355,222	215,599	176,130	80,650	416,496
Pesha specifike (në %)	8.58	2.73	1.36	0.96	3.41

Burimi: AKUK, Përpunoi: Grupi i auditimit

Pesha specifike që zënë fondet buxhetore për Impiantet e Trajtimit të Ujërave të Ndotur në totalin e buxhetit të AKUK, varion nga 0.96-8.58 %, përgjatë periudhës 2019-2023. Shoqëritë aksionare ekzistuese të ujësjellës kanalizimeve funksionojnë në bazë të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, Vendimit Nr. 302 datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotur".

Agjencia Kombëtare e Mjedisit

AKM është person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit të MTM-së. AKM-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme.[22] Për periudhën 2019-2023, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, rezultojnë të dhënat si më poshtë:

Tabela nr. 3 Fonde buxhetore AKM për periudhën 2019-2023

Viti	Buxheti total	Fondi buxhetor për monitorimin e cilësisë së ujërave	Pesha specifike (%)
VITI 2019	69,883,295	4,047,550	5.8
VITI 2020	96,952,683	4,349,706	4.5
VITI 2021	137,321,902	2,701,564	2.0
VITI 2022	155,478,424	3,556,753	2.3
VITI 2023	184,696,131	6,754,000	3.7

Burimi: AKM, Përpunoi: Grupi i auditimit

Grafiku 3. Ecuria e fondeve buxhetore AKM për periudhën 2019-2023.



Burimi: AKM, Përpunoi: Grupi i auditimit

[22] Vendim Nr. 568, datë 17.7.2019 Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare Të Mjedisit, Kapitulli I, pika 1.

Grafiku 4. Ecuria e fondeve buxhetore për monitorimin e cilësisë së ujrave për periudhën 2019-2023.



Burimi: AKM, Përpunoi: Grupi i auditimit

Siç vihet re edhe nga grafikët e mësipërm, ecuria e fondeve buxhetore të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit paraqet trend në rritje gjatë gjithë periudhës 2019-2023. Në vitin 2021 fondet buxhetore 137.321.902 lekë, përkundrejt vitit 2019 69.883.295 lekë, shënojnë një rritje të ndjeshme në vlerë 67.438.607 lekë ose në masën rreth 49%. Ndërkohë krahasimisht me të njëjtën periudhë fondet e dedikuara për monitorimin e cilësisë së ujërave në vitin 2021 shënojnë pikën më të ulët të gjithë periudhës. Përkatësisht nga 4.047.550 lekë në vitin 2019 në 2.701.564 lekë në vitin 2021 duke shënuar një rënie në vlerë 1.345.986, ose në masën 33%. Në vitin 2022 fondet e dedikuara për monitorimin e cilësisë së ujërave janë 3.556.753 lekë përkundrejt 2.701.564 lekë në vitin 2021, duke shënuar një rritje në vlerën 855.189 lekë ose në masën 24%. Në vitin 2023 fondet e dedikuara për monitorimin e cilësisë së ujërave janë 6.754.000 lekë përkundrejt 3.556.753 lekë në vitin 2022, duke shënuar një rritje të ndjeshme në vlerën 3.197.247 lekë ose në masën 47%. Pesha specifike që zënë fondet buxhetore të dedikuara për monitorimin e cilësisë së ujërave në raport me buxhetin total të AKM, varion nga 2-5.8% përgjatë periudhës 2019-2023.

2.5 Përkufizimet dhe terminologjia

***Ujërat e larjes**:* çdo element i ujit sipërfaqësor ku autoriteti kompetent pret të ketë një numër të madh njerëzish për t'u larë dhe ku nuk ka vendosur ndalim të përhershëm për t'u larë apo rekomandim të përhershëm për të mos u larë.

***Ujërat bregdetare**:* ujërat sipërfaqësore, në anën nga toka të një vije, çdo pikë e së cilës është në një largësi prej një milje detare në anën nga deti prej pikës më të afërt të vijës bazë që shërben për të matur gjerësinë e ujërave territoriale, duke u zgjeruar sipas nevojës deri në kufirin e jashtëm të ujërave kalimtare.

***Trup ujor sipërfaqësor**:* një element i veçantë dhe i rëndësishëm i ujërave sipërfaqësore, si një liqen, rezervuar, rrëke, lum apo kanal, pjesë e një rrëkeje, lumi apo kanali, një ujë kalimtar ose një brez i ujit bregdetar.

***Pellgu ujëmbledhës**:* sipërfaqja e tokës prej së cilës e gjithë rrjedhja sipërfaqësore prej një serie përrenjsh, lumenjsh dhe ndoshta liqenesh, derdhet në det nga një grykë e vetme lumi, estuary ose deltë.

***Ndotje**:* prezenca e ndotjes mikrobiologjike apo organizmave të tjerë, e mbetjeve ose lëndëve kimike, siç përcaktohet në nenet 10 e 11 dhe në shtojcën I, kolona A, që ndikojnë në cilësinë e ujit të larjes dhe paraqesin një rrezik për shëndetin e njerëzve që lahen në to.

***Ndotje afatshkurtër**:* ndotje mikrobiologjike siç përcaktohet në shtojcën I, kolona A për shkaqe qartësisht të identifikuara dhe kur parashikohet që cilësia e ujërave të larjes të mos ndikohet për më shumë se 72 orë nga momenti i parë që është zbuluar ndotja dhe për të cilën IM-ja ka

përcaktuar procedurat e nevojshme për parashikimin dhe përballimin, siç përcaktohet në shtojcën II të VKM nr. 797 dt. 29.09.2010.
Vlerësimi i cilësisë së ujit të larjes*:* procesi i përvitshëm i vlerësimit të ujit të larjes, duke përdorur metodën vlerësuese të përcaktuar në shtojcën II të VKM nr. 797 dt 29.09.2010.
Ndalim i përhershëm për t'u larë ose rekomandim i përhershëm për të mos u larë*:* kur një ndalim ose rekomandim zgjat për të paktën një sezon të plotë larjeje.
Sezoni i larjes*:* periudha gjatë së cilës pritet të ketë një numër të madh të personave që lahen në ujërat e larjes.[23]
Incidente: ato që përshkruhen më poshtë:
a) situatë jonormale: një ngjarje ose kombinim i ngjarjeve që ndikojnë cilësinë e ujit të larjes në vendin në fjalë, që pritet të ndodhë jo më shumë se një herë në çdo katër vjet.
b) rrethanë e jashtëzakonshme: një situatë e papritur që ka ose mund të ketë efekt të dëmshëm në cilësinë e ujit të larjes dhe në shëndetin e personave që lahen në të.
"***Ujërat e ndotura urbane***" janë ujërat e përdorura që shkarkohen nga banesat dhe veprimtaritë e caktuara industriale, të cilat përmbajnë lëndë të tretura dhe lëndë në pezulli.
"***Ujërat e ndotura shtëpiake***" janë ujërat e përdorura të çdo lloji, me përbërje organike, të degradueshme, lëndë minerare në formë të tretur ose në pezulli, të shkarkuara nga instalimet hidraulike të çdo lloji.
"Ujërat e ndotura industriale" janë ujërat e përdorura nga veprimtaritë tregtare dhe industriale.
"***Mjedis pritës***" përfaqëson zonat e shkarkimit të ujërave të përdorura.
"Sistemi kolektor" është sistem kanalizimesh, unik ose i ndarë, që grumbullon dhe sistemon shkarkimet e ujërave të ndotura urbane dhe industriale.
"***Trajtim parësor***" është trajtimi i ujërave të përdorura, nëpërmjet procesit fizik me anë të dekantimit parësor, që mënjanon 60 për qind të lëndës në pezulli dhe 20 për qind të NBO5.
"***Trajtim dytësor***" është trajtimi i ujërave të ndotura nëpërmjet procesit biologjik, me shtrat bakterial, basen ajrimi, llum aktiv, duke u shoqëruar, në raste të veçanta, me trajtim tretës (dekantim/filtrim), për realizimin e denitrifikimit dhe defosfatimit.[24]
"***Trajtim i përshtatshëm***" është trajtimi i ujërave të ndotura urbane, nëpërmjet një procesi të dhënë, nga i cili rezulton që shkarkimet e lëngëta në ujërat pritëse nuk dëmtojnë cilësitë e këtyre ujërave, në përputhje me ligjin.
"***Llum***" është mbetja e ngurtë dhe gjysmë e ngurtë, që përftohet gjatë proceseve të trajtimit të ujërave të ndotura.
"***Eutrofikim***" është pasurimi i një ekosistemi ujor me lëndë ushqyese, veçanërisht, me përbërës azoti dhe fosfori dhe me prodhimtari të lartë biologjike, duke shkaktuar një rritje të vrullshme të algave dhe formave të larta të jetës bimore, të shoqëruara me ndryshime të cilësisë së ujit.
"***Estuar***" është zona kalimtare e ujërave sipërfaqësore në grykëderdhjen e lumit në det.
"***Ujëra bregdetare***" janë ujërat jashtë vijës së ujërave të ulëta ose ujërat jashtë kufijve të estuarit.
"***Nevoja biologjike për oksigjen NBO5***" është sasia e oksigjenit të konsumuar gjatë 5 ditëve nga bakteret aerobe në prani të ajrit. Ajo përfaqëson ndotjen organike të biodegradueshme.
"***Monitorimi***" është grumbullimi, vlerësimi dhe përgjithësimi i të dhënave mjedisore me anë të vëzhgimit të vazhdueshëm ose periodik të një grupi treguesish mjedisorë, cilësorë dhe sasiorë, që karakterizojnë përbërësit e mjedisit dhe ndryshimet e tyre nga ndikimi i faktorëve natyrorë ose njerëzorë.
"***Substancë***" është çdo element kimik dhe përbërjet e tij, me përjashtim të substancave radioaktive dhe të organizmave të modifikuar gjenetikisht, sipas përcaktimit të dhënë në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".
"***Shkarkim***" ka kuptimin e dhënë në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".

[23] VKM nr. 797 dt 29.09.2010 Për miratimin e rregullores higjieno-sanitare "Për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes", neni 3.
[24] Ligji nr.9115, datë 24.7.2003 Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura, neni 3.

"***Shkarkim në ujë***" janë shkarkimet në trupat ujorë, ku përfshihen shkarkimet në rrjetin e tubacioneve të ujërave të zeza e të bardha.[25]
"***Grumbullimi i ujit***" ka të bëjë me të gjitha ato veprimtari që nëpërmjet strukturave apo mekanizmave të tillë, si: diga, puse, depo uji, cisterna, kanale, ujësjellësa, tubacione, kanale kulluese dhe kanalizime të ujërave të zeza grumbullojnë, kanalizojnë, ndryshojnë drejtimin apo nxjerrin ujin për përfitim publik.
"***Shpërndarja e ujit***" ka të bëjë me të gjitha veprimtaritë me anë të të cilave uji pompohet, transportohet dhe shpërndahet nga një vend në tjetrin për përfitim publik.
"***Trajtimi i ujit***" ka të bëjë me të gjitha metodat dhe mjetet, qofshin këto kimike, mekanike, elektrike etj., që përdoren për pastrimin apo ndryshimin e gjendjes së ujit për përfitim publik.
"***Operatorë***" janë subjektet e licencuara, që operojnë në sistemet e furnizimit me ujë, kanalizimeve të ujërave të zeza dhe trajtimit të tyre. [26]

2.6 Skema e analizës së programit auditues

*Skema 1:*Modeli Input – Output



[25] Ligji nr.10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", neni 3
[26] Ligji nr.8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, neni 2.

2.7 Feedback-u i subjektit në fazën studimore

Në fazën e parë studimore institucionet e përfshira në auditim i janë përgjigjur përgjithësisht në kohë pyetësorëve të dërguar nga grupi i auditimit, ndërsa për plotësimin e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar që lidhet me vjeljen e të dhënave plotësuese mbi subjektet, kërkuan më shumë kohë në përgjigjet e tyre. Përjashtim nga kjo situatë bën Bashkia Kavajë. Ky institucion, pavarësisht se i është kërkuar dy herë me email (datë 27.06.2024 dhe 23.07.2024) nuk ka kthyer përgjigje grupit të auditimit mbi pyetësorin njohës, edhe pse deri tani kjo nuk ka ndikuar në ecurinë normale të procesit të auditimit.

3. DETAJET E AUDITIMIT

3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer analizën e riskut, jemi mbështetur në analizën SWOT duke marrë në konsideratë risqet e katër fushave në të cilat shtrihet kjo analizë e respektivisht termi SWOT është një akronim për (*Strengths, Weakness, Opportunities and Threats*) Fuqi, Dobësi, Mundësi dhe Kërcënime. Analiza SWOT është një mjet i rëndësishëm që ndihmon në identifikimin e faktorëve që ndikojnë në funksionimin e një institucioni apo procesi të caktuar. Ajo mundëson gjendjen aktuale të subjekteve nën auditim, për të diagnostikuar me saktësi problemet. Gjatë përdorimit të kësaj analize është e rëndësishme që faktorët që ndikojnë në funksionimin e procesit për të cilën kjo analizë kryhet, jo vetëm të identifikohen por edhe të vlerësohen aty ku është e mundur. Kjo analizë risku ka karakter paraprak dhe në vazhdimësi të auditimit, nëse do të jetë e nevojshme, do të kryhet një rivlerësim dhe/ose përditësim i risqeve të identifikuara. Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Duke iu referuar kësaj analize, grupi i auditimit ka bërë një ndarje dhe grupim të risqeve të veprimtarisë së institucioneve përkatëse, për të adresuar dhe ndarë faktorët e riskut sipas përkatësisë së tyre, brenda dhe jashtë kontrollit menaxherial.

Figura nr. 1 Analiza SWOT



3.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë "Cilësia e ujërave në plazhe" ka si objektiv kryesor vlerësimin e procesit të trajtimit të ujërave të ndotura urbane që çojnë në cilësi jo të mirë të ujërave në plazhe si dhe adresimin e masave që duhen marrë nga institucionet përgjegjëse në rast të ndotjes së tyre. Në këtë mënyrë do të synohet të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektiv mbi nismat dhe iniciativat të cilat institucionet përgjegjëse kanë marrë mbi monitorimin e cilësisë së ujërave të larjes, shkaqet që çojnë në cilësi jo të mirë të ujërave të larjes, minimizimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura në mjedis si dhe ekspozimit të popullsisë ndaj ndotjes së ujërave në plazhe. Me anë të këtij objektivi do të mund të konkludojmë se deri në çfarë mase ka qenë efektive dhe eficiente veprimtaria e institucioneve subjekt auditimi për periudhën 2019-2023.



3.3 Pyetjet e auditimit

3.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim ka pasur në fokus të tij cilësinë e ujërave të larjes (plazheve) në territoret administrative të Bashkive Shkodër, Lezhë, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Fier, Vlorë, Himarë të cilat janë vizituar të gjitha gjatë fazës studimore veçanërisht sa i përket mënyrës dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane (ato bashki që kanë impiante trajtimi). Gjithashtu janë vizituar edhe plazhet (veçanërisht ato që kanë rezultuar me ujëra me "cilësi te keqe" nga monitorimi i AKM/ISHP i vitit 2023) në drejtim të masave që do të duhej të ishin marrë nga institucionet përgjegjëse. Kështu më konkretisht në këtë auditim janë trajtuar si më poshtë:

- Procesi i monitorimit të cilësisë së ujërave të larjes me rezultatet e tij në vite;
- Identifikimi dhe përzgjedhja e pikave të monitorimit të ujërave të larjes;
- Hartimi dhe përditësimi i akteve ligjore/nënligjore të cilat për arsye të ndryshme nuk gjejnë zbatim;
- Masat sensibilizuese dhe kufizuese që duhen marrë në raste kur ujërave e larjes rezultojnë me cilësi të keqe;
- Gjendja e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane, kapacitetet e tyre, teknologjia dhe problematika të ndryshme që ata ballafaqojnë;
- Planifikimi, nevojat, investimet dhe projektet që janë planifikuar/zbatuar përgjatë periudhës objekt auditimi;
- Procesi i instalimit të sistemeve ose impianteve individuale të trajtimit të ujërave të ndotura nga ana e subjekteve që zhvillojnë veprimtari ekonomike pranë zonave bregdetare;
- Respektimi i normave dhe standardeve mjedisore gjatë procesit të trajtimit të ujërave të ndotura urbane nga ana e impianteve të trajtimit të këtyre ujërave.

Nuk ka qenë objekt auditimi menaxhimi dhe trajtimi i ujërave industriale apo aktiviteteve të tjera si bujqësi, blegtori etj. Qëllimi i fokusimit të auditimit vetëm në ujërave e ndotura urbane (ose ujërat e zeza siç njihen në përditshmëri) është sepse bazuar në dokumente zyrtare por edhe në raporte e studime të ndryshme evidentohet që shkaku kryesor që ndikon drejtpërsëdrejti në cilësinë e ujërave të plazheve janë ujërat e ndotura urbane. Periudha objekt auditimi siç është theksuar dhe më sipër ka qenë 2019-2023, megjithatë të dhëna historike jashtë kësaj periudhe janë mbajtur në konsideratë për të dhënë një panoramë më të qartë të ecurisë së treguesve të ndryshëm.

4. SHJTELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT

Pyetja kryesore: A ka qenë efektiv procesi i menaxhimit të cilësisë së ujërave të larjes?

MESAZHI I AUDITIMIT

Procesi i menaxhimit të cilësisë së ujërave të larjes nuk ka qenë efektiv. Cilësia e ujërave të larjes (plazheve) në Shqipëri ka ardhur duke u përkeqësuar në vitet e fundit dhe në vitin 2023 Shqipëria ka pasur cilësinë më të keqe se çdo shtet tjetër në Evropë. Monitorimi me qëllim vlerësimin e saktë të cilësisë së ujërave të larjes nuk ka ndjekur udhëzimet e përcaktuara në aktet nënligjore të vendit tonë si dhe direktivës përkatëse evropiane. Informimi i qytetarëve dhe turistëve mbi cilësinë e keqe të ujërave të larjes (kur kanë rezultuar si të tilla) nuk ka ndodhur në asnjë rast ashtu si edhe ndalimi i përdorimit të këtyre plazheve. Bashkitë Fier, Lushnje, Rrogozhinë nuk kanë impiant trajtimi të ujërave të ndotura urbane e për rrjedhojë të gjitha ujërat e zeza që gjenerohen nga këto bashki përfundojnë të pa trajtuara në lumenj ose kanale të cilat më pas derdhen në det. Ndërsa bashkitë e tjera, edhe pse kanë impiante të trajtimit të ujërve të ndotura urbane, nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për të trajtuar të gjitha ujërat e ndotura të gjeneruara në territorin e tyre. Për pasojë një pjesë e konsidrueshme e tyre përsëri përfundon e pa trajtuar në det, duke ndikuar kështu në përkeqësimin e cilësisë së ujërave në plazhe. Planifikimi dhe investimet në sektorin e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane vuajnë mungesën e koordinimit të institucioneve përgjegjëse duke qenë se shpërndarja, prioritizimi, përthithja e fondeve si dhe shkëmbimi i informacioneve nga projektet e zbatimit nuk bëhet siç duhet. Task-Forca e ngritur për përmirësimin e infrastrukturës për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse nuk ka arritur të përmbushë plotësisht detyrimet e përcaktuara në Aktin Normativ nr. 8 dt 28.12.2023. Megjithatë, pavarësisht situatës, inkurajohet ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në këtë raport me qëllim përmirësimin e mangësive dhe dobësive të konstatuara.

4.1 Pyetja e Auditimit: A ka qenë efektiv procesi i menaxhimit të cilësisë së ujërave të larjes?

Monitorimi i duhur i cilësisë së ujërave të larjes është thelbësor për të pasur të dhëna të sakta e të plota mbi gjendjen dhe cilësinë e tyre. Efektiviteti i monitorimit garantohet duke përcaktuar profilet e ujërave të larjes. Këto profile duhet të monitorohen çdo vit. Referuar kuadrit ligjor e rregullator kombëtar, por edhe Direktivës përkatëse evropiane, ujërat e larjes klasifikohen në katër kategori sa i përket cilësisë së tyre ("e keqe", "e mjaftueshme", "e mirë", "e shkëlqyer"). Institucionet përgjegjëse duhet të marrin masa të përshtatshme për rritjen e numrit të ujërave të larjes të klasifikuar si "të shkëlqyer" ose "të mirë". Megjithatë, në raste të klasifikimit të ujërave të larjes me cilësi "të keqe", institucionet përkatëse duhet të marrin masa të duhura për parandalimin dhe reduktimin e pasojave që mund të vijnë në shëndetin e njeriut.

4.1.1 Si ka qenë ecuria e cilësisë së ujërave të larjes përgjatë periudhës 2019-2023?

Cilësia e ujërave të larjes është përkeqësuar përgjatë periudhës 2019-2023.

Vlerësimi i cilësisë së ujit të larjes është një proces i përvitshëm që bëhet duke përdorur metodën vlerësuese të përcaktuar në shtojcën II të VKM-së 797 datë 29.9.2010 "Për miratimin e rregullores higjieno-sanitare "Për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes". Të dhënat që përftohen nga procesi i vlerësimit të cilësisë së ujërave të larjes publikohen nga AKM në Raportin e Gjendjes së Mjedisit. AKM çdo vit kontrakton Institutin e Shëndetit Publik për të kryer vlerësimin e cilësisë së ujërave të larjes i cili për të kryer këtë vlerësim bazohet në përmbajtjen e parametrave mikrobiologjik *Intestinal Enterococce* (IE) dhe *Escherichia Coli* (EC). Në këtë kontratë, AKM i përcakton ISHP-së edhe pikat apo stacionet e monitorimit

(referuar Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit), në të cilat ISHP do të marrë kampionet. Pra, përqendrimi i këtyre dy baktereve në ujërat e larjes (plazheve) është kushti kryesor për klasifikimin ose kategorizimin e cilësisë së ujërave të larjes. Procesi i monitorimit të cilësisë së ujërave të larjes bazohet në rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) dhe BE-së, ku kërkohet një ndjekje e vazhdueshme e cilësisë mikrobiologjike të ujërave të larjes. Ndaj, kërkohet sigurimi i një numri të caktuar të dhënash, të marra gjatë një periudhë kohe në vazhdimësi, për nxjerrjen e rezultateve të besueshme. Gjatë periudhës 15–31 Maj merret një seri kampionimi, para fillimit të sezonit turistik të larjes. Në periudhën 1 Qershor–15 Shtator, gjatë sezonit të larjes, merren 2 seri kampionimi në muaj (me frekuencë kohore çdo 2 javë). Gjatë periudhës 16 Shtator–30 Shtator merret një seri kampionimi, pas sezonit të larjes. Pra, në total, çdo vit merren 9 seri kampionimi për çdo stacion monitorimi (plazh) për të vlerësuar dhe klasifikuar me kategorinë përkatëse një plazh të caktuar. Në vijim të vlerësimit të cilësisë së ujërave të larjes, në përputhje me kriteret e përcaktuara në shtojcën II VKM-së 797 datë 29.9.2010, ujërat e larjes klasifikohen si ujëra të cilësisë:

a) “së keqe” ose kategoria D;
b) “të mjaftueshme” ose kategoria C;
c) “të mirë” ose kategoria B;
d) “të shkëlqyer” ose kategoria A.

Sipas konfirmimit të ISHP-së, kriteret dhe standardet për ujërat e larjes në vendet e Mesdheut (WHO/UNEP 2010); (janë të përcaktuara sipas tabelës së mëposhtme). Pra, në varësi të përqendrimit të dy baktereve të sipërpërmendura, bëhet edhe klasifikimi i ujërave të larjes me kategorinë përkatëse.

Tabela nr. 4 Vlerat kufi të kategorizimit të cilësisë së ujërave të larjes

Kategoria	**A**	**B**	**C**	**D**
Vlera limit	< 100*	101-200*	185**	>185** (1)
Cilësia e ujërave të larjes	Cilësi e shkëlqyer	Cilësi e mirë	Cilësi e mjaftueshme	Cilësi e keqe

Burimi: ISHP

Në tabelën nr. 5 paraqitet vlerësimi i cilësisë së ujërave të larjes për stacionet e monitoruara përgjatë viteve 2019-2023. Nga rezultatet e monitorimit të këtyre viteve kuptohet qartë që cilësia e ujërave të larjes është përkeqësuar me kalimin e viteve. Viti 2023 është viti me cilësinë më të keqe të ujërave të larjes përgjatë periudhës 2019-2023. Numri i stacioneve të monitorimit në vitet 2022 dhe 2023 është 123 (në rang kombëtar) nga 119 që ka qenë në 3 vitet e mëparshme. Numri i stacioneve me kategori D ose cilësi të keqe në vitin 2023 është 34, duke qenë disa herë më i lartë se numri i stacioneve me të njëjtën kategori për vitet e mëparshme. E shprehur në përqindje, për vitin 2023, ujërat e larjes me kategori D përbëjnë 30 % të të gjithë ujërave të larjes në rang kombëtar. Pra, duket qartë që kemi një shtim të plazheve apo ujërave të larjes me cilësi të keqe për të cilat do të duhet të merren masa në zbatim të kuadrit ligjor. Sa i përket numrit të plazheve me cilësi të shkëlqyer ose kategori A, ato janë ulur nga viti në vit. Kështu nga 106 plazhe me cilësi të shkëlqyer në vitin 2019, në vitin 2023 vetëm 34 plazhe kanë rezultuar me cilësi të shkëlqyer.

Tabela nr. 5 Klasifikimi i cilësisë së ujërave të larjes 2019 – 2023.[27]

Shqipëria	**2019**		**2020**		**2021**		**2022**		**2023**	
	Nr. i plazheve	%	Nr. i plazheve	%	Nr. i plazheve	%	Nr. i plazheve	%	Nr. i plazheve	%
A	106	89	107	90	60	50	83	70	34	28
B	3	3	6	5	38	32	24	20	40	32
C	7	6	1	1	10	8	5	4	15	12
D	3	3	5	4	11	9	11	9	34	28
Numri tot. i plazheve	119		119		119		123		123	

Burimi: AKM

Referuar monitorimit të 2023, në Bashkitë Durrës, Kavajë, Vlorë e Pogradec gjenden 34 plazhet më të ndotura në Shqipëri.

Siç theksuam edhe më sipër, nga monitorimi i cilësisë së ujërave të larjes të vitit 2023, në Shqipëri kanë rezultuar 34 plazhe me cilësi të keqe të cilat gjenden në territorin e bashkive Lezhë, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Vlorë, Sarandë e Pogradec.[28] Të gjitha këto plazhe bëjnë pjesë në kategorinë D ose ndryshe të klasifikuara me cilësi të keqe. Disa prej tyre ndodhen në këtë situatë prej të paktën 5 viteve të fundit si për shembull plazhi në Durrës i njohur ndryshe si "Plepa" me koordinata N 41,28461º E 019,50959º.

[27] Sqarim: Të dhënat e 2024 nuk janë përfshirë në këtë raport auditimi sepse gjatë kohës së realizimit të këtij raporti, ato ende nuk ishin publikuar zyrtarisht nga AKM.

[28] Janë vendosur në hartë si pika me ngjyrë të kuqe.

Harta nr. 1 Plazhet me kategorinë D (cilësi e keqe), sipas monitorimit të vitit 2023



Burimi: AKM Punoi hartën: Grupi i auditimit

Krahas 34 plazheve që kanë rezultuar me cilësi të keqe, të përmendura më sipër, nga shqyrtimi dhe krahasimi midis tyre sa i përket përmbajtjes së dy baktereve mikrobiologjikë *Intestinal Enterococce* (IE) dhe *Escherichia Coli* (EC) vihen re diferenca të mëdha. Pra, pavarësisht se ato janë në të njëjtën kategori, disa prej tyre janë disa herë më të ndotura se të tjerat. Konkretisht,

referuar tabelës në Aneksin 1, dhjetë plazhet më të ndotura që kanë rezultuar nga monitorimi i vitit 2023 në Shqipëri[29] janë si më poshtë:

- Durrës, "Plepa" (Pas kanalit), me koordinata N 41.28461º E 019.50959º
- Kavajë, "Vjena", me koordinata N 41.25677º E 019.51941º
- Kavajë, "Majami", me koordinata N 41.26021º E 019.51926º
- Kavajë, "Vapori i mbytur", me koordinata N 41.24401º E 019.51738º
- Kavajë, "Bar kafe Holiday", me koordinata N 41.21918º E 019.50575º
- Kavajë, "Kompleksi Bellavista", me koordinata N 41.219514 º E 019.504833º
- Vlora, "Shkolla e Marinës", me koordinata N 40.44537º E 019.49436º
- Pogradec, "Hotel Enkelana", Ish Turizmi i vjetër, me koordinata N 40.903217º E 20.658572º
- Pogradec "Hotel 1 Maj", me koordinata N 40,54082º E 20,39520º
- Pogradec, "Hotel Depo" (Kompleksi Ermano), me koordinata N 40.90 072º E 020.68 420º

Shqipëria ka plazhet me cilësinë më të keqe në Evropë.

Grupi i auditimit ka krahasuar të dhënat nga rezultatet e monitorimit të cilësisë së ujërave të larjes midis Shqipërisë dhe vendeve të BE-së. Krahasimi është bërë për vitin 2023 duke qenë se janë të dhënat më të fundit të bëra publike gjatë kohës së realizimit të këtij auditimi. Të dhënat janë shprehur si në numra absolute ashtu edhe relative (në përqindje) duke qenë se shtete të ndryshme kanë hapësira të ndryshme të plazheve dhe rrjedhimisht numër më të lartë të plazheve ose pikave të monitorimit. Për ta bërë sa më objektiv krahasimin, i jemi referuar përqindjes së ujërave të larjes që kanë rezultuar me cilësi të keqe ose ndryshe e quajtur kategoria D. Kështu, rreth 28 % e plazheve në Shqipëri janë me kategori D, vlerë shumë më e lartë se çdo vend tjetër i BE-së[30]. Disa vende të rajonit si Greqia, Kroacia, Bullgaria nuk kanë asnjë plazh me cilësi të keqe[31], ndryshe nga vendi ynë në të cilin në vitin 2023 kanë rezultuar 34 plazhe me cilësi të keqe. Kujtojmë këtu që Greqia ka 1,731 dhe Kroacia 936 plazhe ose ujëra të larjes (sipas përkufizimit ligjor) ndërsa Shqipëria ka 123 plazhe/ujëra të larjes ku kryhet edhe monitorimi i cilësisë së tyre.

Tabela nr. 6 Cilësia e ujërave të larjes të shteteve të BE-së dhe Shqipërisë. Viti 2023

Shteti	Numri total i ujërave larës	A*	B**	C***	D****
Spanjë	2,275	1,993	177	38	39
Portugali	667	575	57	11	3
Francë	3,361	2,517	521	137	99
Gjermani	2,291	2,069	136	37	7
Hollandë	746	539	127	31	32
Danimarkë	1,044	981	45	2	5
Suedi	468	341	56	21	24
Finlandë	304	265	21	9	5
Estoni	65	43	12	6	2
Letoni	59	44	9	2	1
Belgjikë	130	88	39	3	0
Poloni	739	406	106	33	21
Lituani	121	108	8	4	0
Itali	5,533	4,996	318	105	72
Greqi	1,731	1,659	17	4	0
Kroaci	936	905	22	5	0

[29] AKM, Raporti i Gjendjes në Mjedis për vitin 2023, f.
[30] AKM, Raporti i Gjendjes në Mjedis për vitin 2023.
[31] https://www.eea.europa.eu/publications/european-bathing-water-quality-in-2023/

Bullgari	96	91	5	0	0
Austria	260	252	7	1	0
Qipro	123	120	0	0	0
Çeki	153	121	21	2	0
Hungari	283	177	62	10	6
Malta	148	114	24	5	5
Luksemburg	17	15	2	0	0
Rumania	50	35	15	0	0
Sllovenia	47	37	8	1	0
Sllovakia	32	23	6	1	0
Zvicër	196	146	19	4	5
Shqipëri[32]	123	34	40	15	34

Burimi: Agjencia Evropiane e Mjedisit[33] për vendet e BE-së dhe AKM për Shqipërinë

Grafik nr. 5 Cilësia e ujërave larës sipas kategorive në përqindje



Burimi: Agjencia Evropiane e Mjedisit për vendet e BE-së & AKM për Shqipërinë

Sic mund të vërehet edhe në grafikun e mësipërm, Shqipëria ka përqindjen më të lartë të plazheve me cilësi të keqe, ndërsa Qipro është shteti që ka plazhet me cilësinë më të mirë në Evropë.

[32] Për Shqipërinë janë përdorur të dhënat e RGJM 2023, duke qenë se të dhënat e publikuara në Agjencinë Evropiane të Mjedisit për Shqipërinë nuk janë të sakta.
[33] https://www.eea.europa.eu/publications/european-bathing-water-quality-in-2023/

Të dhënat e Agjencisë Evropiane të Mjedisit nuk përputhen me ato të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit sa i përket cilësisë së ujërave të larjes në Shqipëri.

Ekziston një mos përputhje midis të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Agjencisë Evropiane të Mjedisit me ato të publikuara nga AKM në Raportin e Gjendjes në Mjedis për vitin 2023. Çdo vit Agjencia Kombëtare e Mjedisit raporton në Agjencinë Evropiane të Mjedisit për tregues të ndryshëm mjedisorë ku përfshihen edhe të dhënat që rezultojnë nga monitorimi i cilësisë së ujërave të larjes në rang kombëtar.

Nga krahasimi i të dhënave të cilësinë së ujërave të larjes të publikuara në Raportin e Gjendjes në Mjedis për vitin 2023 nga AKM[34] rezulton se monitorimi i cilësisë së ujërave të larjes është bërë në 123 pika monitorimi në të cilat ka rezultuar 34 pika monitorimi me kategori A, 40 me kategori B, 15 me kategori C dhe 34 me kategori D. Ndërkohë, referuar të dhënat zyrtare të publikuara nga Agjencia Evropiane e Mjedisit[35] rezulton që procesi i monitorimit është bërë në 119 pika monitorimi nga ku pasqyrohen 49 pika monitorimi me kategori A, 44 me kategori B, 8 me kategori C dhe 18 me kategori D.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se cilësia e ujërave të larjes në rang kombëtar përgjatë periudhës 2019-2023 ka ardhur duke u përkeqësuar. Numri i plazheve të kategorizuara me cilësi të shkëlqyer (kategoria A) ka pësuar rënie të konsiderueshme, nga 106 plazhe në vitin 2019, në vetëm 34 plazhe në vitin 2023. Ndërkohë, numri i plazheve të klasifikuara me cilësi të keqe është rritur ndjeshëm, nga 3 plazhe në vitin 2019, në 34 plazhe në vitin 2023.

2. Gjetje nga auditimi: Nga krahasimi i vendit tonë me vendet e BE-së rezulton se vendi ynë ka plazhet me cilësinë më të keqe në Evropë. Referuar monitorimit të vitit 2023, rreth 28 % e plazheve të Shqipërisë janë me cilësi të keqe. Ndërkohë, vende të rajonit si Greqia, Kroacia, Bullgaria kanë 0 % të plazheve me cilësi të keqe. Sa i përket plazheve me cilësi të shkëlqyer, Shqipëria mban vendin e fundit krahasuar me vendet e BE-së duke pasur vetëm 28 % të plazheve me cilësie të shkëlqyer.

3. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit në Shqipëri, ashtu si të gjitha shtetet e tjera të BE-së, raporton çdo vit në Agjencinë Evropiane të Mjedisit lidhur me cilësinë e ujërave të larjes. Rezultatet e publikuara nga Agjencia Evropiane e Mjedisit (për Shqipërinë për vitin 2023) nuk janë të njëjta me ato të publikuara në Raportin e Gjendjes së Mjedisit (nga AKM për vitin 2023). Numri i plazheve me cilësi të keqe referuar të dhënave të Agjencisë Evropiane të Mjedisit për Shqipërinë për vitin 2023 është më i ulët se numri i plazheve me cilësi të keqe që ka rezultuar nga monitorimi i bërë nga AKM (nëpërmjet ISHP-së). Konkretisht sipas të dhënave të AKM-së rezultojnë 34 plazhe (ujëra të larjes) me cilësi të keqe, ndërsa sipas AEM-së rezultojnë 18. Veç këtyre, edhe numri i plazheve me cilësi të shkëlqyer, referuar të dhënave të Agjencisë Evropiane të Mjedisit (AEM) për Shqipërinë për vitin 2023 rezulton të jetë më i lartë nga sa ka rezultuar në të vërtetë. Nga të dhënat e AEM-së rezultojnë 49 plazhe me cilësi të shkëlqyer, ndërkohë sipas AKM-së rezultojnë 34 plazhe. Gjithashtu, edhe numri total i ujërave të larjes (plazheve ose pikave të monitorimit ku merren kampionet) nuk përkon midis të dhënave të publikuara nga AKM, ku për vitin 2023 rezultojnë 123 pika monitorimi dhe të dhënave të publikuara nga AEM, ku për vitin 2023 rezultojnë 119 pika monitorimi. E gjithë kjo situatë cenon saktësinë mbi të dhënat e cilësisë së ujërave të larjes në Shqipëri duke qenë se burime të ndryshme referojnë të dhëna të ndryshme.

Konkluzion 1: Cilësia e ujërave të larjes në Shqipëri është përkeqësuar përgjatë periudhës 2019-2023 duke u shtuar numri i plazheve me kategori D ose cilësi "të keqe" dhe duke u ulur numri i plazheve me kategori A ose cilësi "të shkëlqyer". Në vitin 2023, Shqipëria ka pasur cilësinë më

[34] https://akm.gov.al/ova_doc/raporti-per-gjendjen-e-mjedisit-2023/ tab. nr. 4, fq 80
[35] https://www.eea.europa.eu/publications/european-bathing-water-quality-in-2023/

të keqe të ujërave të larjes krahasuar me të gjitha vendet e BE-së. Nga krahasimi i të dhënave midis Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencisë Evropiane të Mjedisit nuk përputhen numri total i pikave të monitorimit të plazheve si dhe kategorive përkatëse sa i përket vlerësimit të cilësisë së ujërave të larjes.

3.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa për të saktësuar rezultatet e publikuara nga Agjencia Evropiane e Mjedisit me rezultatet e publikuara në Raportin e Gjendjes në Mjedis lidhur me vlerësimin e cilësisë së ujërave të larjes.

Në vijimësi

4.1.2 A kanë marrë institucionet përgjegjëse masat e duhura për monitorimin e cilësisë së ujërave të larjes?

Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 797, datë 29.09.2010 "Për miratimin e rregullores higjieno-sanitare për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes". Në nenin 1 të kësaj rregulloreje citohet objekti i saj i cili është:
1. Vendosja e kritereve shëndetësore që duhet të plotësojnë ujërat e larjes për të siguruar cilësinë e tyre, me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik nga efektet negative të çdo lloj ndotjeje.
2. Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit në plotësim të direktivës 2000/60/KE.
3. Vendosja e dispozitave për monitorimin, klasifikimin dhe menaxhimin e cilësisë së ujërave të larjes dhe informimin e publikut mbi të.

Në nenin 3 pika 13 të rregullores së mësipërme, lidhur me ujërat e larjes janë parashikuar masat administruese si më poshtë:
a) krijimi dhe ruajtja e një profili të ujërave të larjes;
b) krijimi i një kalendari monitorimi;
c) monitorimi i ujërave të larjes;
d) vlerësimi i cilësisë së ujërave të larjes;
e) klasifikimi i ujërave të larjes;
f) identifikimi dhe vlerësimi i shkaqeve të ndotjes që mund të ndikojnë mbi ujërat e larjes dhe dëmtojnë shëndetin e njerëzve që lahen;
g) informimi i publikut sipas nenit 14;
h) marrja e masave për të parandaluar ekspozimin ndaj ndotjes të njerëzve që lahen;
i) marrja e masave për të reduktuar rrezikun e ndotjes;
j) marrja e masave për të eliminuar shkaqet e ndotjes dhe për të përmirësuar cilësinë e ujërave të larjes.

Profilet e ujërave të larjes në Shqipëri nuk janë përcaktuar.
VKM nr. 797 përcakton se profilet e ujit të larjes duhet të rishikohen dhe përditësohen çdo vit përpara fillimit të sezonit të larjes. Përcaktimi i profileve të ujërave të larjes është shumë i rëndësishëm sa i përket përshtatshmërisë dhe besueshmërisë së rezultateve cilësisë së ujërave të larjes. Nga auditimi është konstatuar se në Shqipëri nuk janë përcaktuar profilet e ujërave të larjes.
Bazuar në VKM nr. 797[36], përcaktimi dhe përditësimi i profilit të ujërave të larjes është përgjegjësi e ish Inspektoratit Sanitar Shtetëror ISS. Ish ISSH është riorganizuar në vitin 2013. Inspektorati i ri (që pas vitit 2013) i cili quhet Inspektorati Shëndetësor Shtetëror – ISHSH funksionon në bazë të VKM-së nr 241.[37] VKM nr. 241 nuk e përcakton hartimin e profileve të ujërave të larjes si një detyrë apo përgjegjësi për ISHSH-në.

[36] VKM nr 797 datë 29.09.2010 "Për miratimin e rregullores higjieno-sanitare "Për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes", neni 4 pika 2 "III"
[37] VKM nr. 241, datë 27.3.2013 "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor

Shkaqet dhe arsyet e mospërcaktimit të profileve të ujërave të larjes janë disi kontradiktore siç mund të kuptohet edhe nga përgjigjet e subjekteve nën auditim. Arsyetimi apo argumenti që ISHSH jep për arsyet e mospërcaktimit të profileve të ujërave të larjes është riorganizimi i institucionit. Por, në vlerësimin e grupit të auditimit, ky argument nuk qëndron, pasi ky institucion edhe para riorganizimit në vitin 2013, nuk e ka përmbushur këtë detyrim. Vendimi nr. 797 është ende në fuqi, por është e paqartë se cila agjenci është përgjegjëse për zbatimin e tij pas riorganizimit të Inspektoratit Sanitar Shtetëror.

Fact box

Profili i ujërave të larjes sipas nenit 8 përmban:
a) përshkrimin e karakteristikave fizike, gjeografike dhe hidrologjike të ujërave të larjes dhe të ujërave të tjera sipërfaqësore në pellgun ujëmbledhës të ujërave në fjalë, të cilat mund të jenë burim ndotje, karakteristika që lidhen me qëllimin e kësaj rregulloreje dhe siç parashikohet në direktivën 2000/60/KE;
b) identifikimin dhe vlerësimin e shkaqeve të ndotjes, të cilat mund të ndikojnë mbi ujërat e larjes dhe dëmtojnë shëndetin e personave që lahen në to;
c) vlerësimin e mundësisë për shumëzimin e cianobakterieve;
d) vlerësimin e mundësisë për shumëzimin e makro-algave dhe/ose fitoplanktonit;
e) në rast se vlerësimi sipas pikës "b" tregon prezencën e rrezikut të ndotjes afatshkurtër, të dhënat e mëposhtme:
- natyra, shpeshtësia dhe kohëzgjatja e pritshme e ndotjes afatshkurtër të parashikuar;
- informacion i detajuar mbi çdo shkak të mbetur të ndotjes, përfshirë masat administruese të marra dhe afatet kohore të eliminimit të këtyre shkaqeve;
- masat administruese të marra gjatë ndotjes afatshkurtër, si dhe identiteti dhe adresa e organeve përgjegjëse për marrjen e këtyre masave;
f) vendndodhja e pikës së monitorimit.
Nëse ujërat e larjes janë klasifikuar si ujëra të cilësisë "e mirë", "e mjaftueshme" ose "e dobët", profili i ujërave duhet të rishikohet periodikisht, për të vlerësuar nëse ndonjë nga aspektet e renditura në pikën 1 ka ndryshuar, dhe nëse po, duhet të përditësohen të dhënat. Shpeshtësia dhe shtrirja e rishikimit varen nga natyra dhe serioziteti i ndotjes. Megjithatë, rishikimi duhet të pajtohet të paktën me dispozitat e tabelës së mëposhtme dhe të kryhet me shpeshtësinë e treguar në të.

Klasifikimi i ujërave të larjes Cilësia	"e mirë"	"e mjaftueshme"	"e dobët"
Rishikimet do të kryhen të paktën çdo	4 vjet	3 vjet	2 vjet
Çështjet për t'u rishikuar(germat e pikës 1)	nga "a" në "f"	nga "a" në "f"	nga "a" në "f"

Në rastin e ujërave të larjes të klasifikuar më parë të "cilësisë së shkëlqyer", profili i ujërave të larjes duhet të rishikohet dhe të përditësohet nëse është e nevojshme, vetëm nëse klasifikimi ka ndryshuar në "i mirë", "i mjaftueshëm" ose "i dobët". Rishikimi duhet të mbulojë të gjitha aspektet e përmendura në pikën 1.
Burimi: VKM 797 neni 8 dhe Aneksi 3.

Profilet e ujërave të larjes në shtete të tjera evropiane
Një sërë shtetesh të ndryshme evropiane kanë përcaktuar prej vitesh profilet e tyre të ujërave të larjes. Regjistri i profileve të ujërave të larjes së Greqisë, i cili është krijuar për herë të parë në vitin 2012, është përditësuar çdo vit, nën mbikëqyrjen e Sekretariatit të Përgjithshëm për Mjedisin Natyror dhe Ujërat, me qëllim që të merren parasysh modifikimet e mundshme në rrjetin e monitorimit të cilësisë së ujërave të larjes, si dhe masat ndaj presionit të ndotjes nga

burime të ndryshme. Qëllimi i Regjistrit të Profileve të ujërave të larjes është të përshkruajë dhe të paraqesë karakteristikat kryesore të ujërave të larjes, të identifikojë burimet e ndotjes që mund të ndikojnë në cilësinë e ujit dhe të vlerësojë madhësinë e efekteve. Regjistri shërben gjithashtu si një udhëzues për zgjedhjen e masave të përshtatshme për të minimizuar ndikimin e presioneve në ujërat e larjes si dhe për një menaxhim më eficient të tyre.[38]
Edhe Sllovenia ka përcaktuar profilet e ujërave të larjes në respektim të Direktivës së BE-së. Aktualisht janë 48 ujëra të larjes, nga të cilat 21 janë në trupat ujorë detarë dhe 27 janë në trupat ujorë të brendshëm. Profili i ujërave të larjes përmban karakteristikat fizike, gjeografike dhe hidrologjike të ujërave të larjes dhe ujërave të tjera sipërfaqësore në zonën ujëmbledhëse të ujërave të larjes në fjalë, që mund të jenë burim ndotjeje. Gjithashtu identifikohen dhe vlerësohen shkaqet e ndotjes që mund të ndikojnë ujërat e larjes dhe të ndikon në rritjen e baktereve, makroalgave ose fitoplanktoneve. Kur profili tregon se ka një mundësi të dukshme të ndotjes afatshkurtër, parashikohet natyra e kësaj ndotjeje afatshkurtër dhe mënyra e veprimit. Çdo vit para fillimit të vitit, Sllovenia publikon një listë të ujërave të larjes për vitin aktual dhe ia dërgon Komisionit Evropian.[39]

Përzgjedhja e pikave të monitorimit për vlerësimin e cilësisë së ujërave të larjes nuk është bërë në mënyrën e duhur.
Përcaktimi i profilit të ujërave të larjes ka një rëndësi të veçantë sa i përket procesit të monitorimit dhe rezultateve të cilësisë së ujërave të larjes. Siç përshkruam më sipër për disa shtete të ndryshme evropiane në kuadër të Direktivës së Këshillit Evropian 2006/7, pikat e monitorimit të cilësisë së ujërave të larjes duhet të përzgjidhen sipas përcaktimit të profileve të ujërave të larjes. Pra, profilet e ujërave të larjes duhet të shërbejnë si pika monitorimi ku institucioni monitorues do të duhet të marrë kampione të ujit të larjes. Edhe në VKM nr. 797[40] (e cila siç thamë më sipër ka transpozuar Direktivën e KE-së 2006/7) citohet se pikë monitorimi është *vendi i caktuar nga ISSH-ja për marrjen e kampionëve me qëllim monitorimin e cilësisë së ujit të larjes, e lokalizuar në brendësi të ujit të larjes, aty ku parashikohet numri më i madh i personave që lahen në të ose rreziku më i lartë i ndotjes në bazë të profilit të ujit të larjes.* Duke qenë se në Shqipëri nuk janë përcaktuar profilet e ujërave të larjes atëherë nuk është zbatuar metodologjia e përcaktuar në VKM-në nr. 797 dhe në Direktivën e KE-së sa i përket procesit të përzgjedhjes dhe monitorimit të ujërave të larjes.
Gjatë periudhës objekt auditimi por edhe më parë, përcaktimi i pikave të monitorimit është bërë bazuar në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit pa marrë në konsideratë VKM-në nr. 797. Grupi i auditimit ka pyetur më tej AKM-në në cilësinë e institucionit që harton Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit mbi metodikën që përdor për përcaktimin apo pikave të monitorimit (*lokacioneve*) ku do të merren kampionet nga ISHP. Referuar përgjigjes së AKM-së[41], pikat e monitorimit janë përzgjedhur nga një projekt CEMSA i realizuar në 2011 pa dhënë përgjigje të tjera shteruese dhe argumentuese. Në mungesë të përcaktimit të profileve të ujërave të larjes nuk ka garanci të plotë që pikat e përzgjedhura për monitorim janë të duhurat.

Aktet nënligjore lidhur me monitorimin e cilësisë së ujërave të larjes nuk janë të harmonizuara me njëra-tjetrën.
Monitorimi i cilësisë së ujërave të larjes është parashikuar në dy akte nënligjore të ndryshme.

1- VKM nr. 797 dt 29.09.2010 "Për miratimin e rregullores higjieno-sanitare "Për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes", neni 5 dhe neni 6 pika 1 dhe 2,

[38] https://ypen.gov.gr/wp-content/uploads/2024/06/REPORT_EN_2023.pdf fq. 7
[39] https://www.gov.si/teme/kopalne-vode/ Shënim: Në këtë link janë të publikuar studimet për secilin prej 47 profileve të ujërave të larjes së Sllovenisë.
[40] VKM nr. 797, dt 29.09.2010 Për miratimin e rregullores higjieno-sanitare "Për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes", neni 3 pika 19.
[41] Email AKM.

2- VKM nr. 1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit".

Referuar VKM-së nr. 797 institucioni përgjegjës për monitorimin mikrobiologjik të cilësisë së ujërave të larjes si dhe vlerësimin dhe klasifikimin e tyre është Inspektorati Sanitar Shtetëror (sot Inspektorati Shtetëror Shëndetësor). Përcaktimi i kalendarit të monitorimit (sipas së cilit duhet monitoruar çdo profil i ujërave të larjes) është gjithashtu përgjegjësi e ish ISSH. Referuar VKM-së 797, ISSH-ja duhet të kryejë një vlerësim vjetor të cilësisë së ujërave të larjes për çdo pikë monitorimi të ujit të larjes pas çdo përfundimi të sezonit të larjes.[42] Gjithashtu, referuar po kësaj VKM-je, në vijim të vlerësimit të cilësisë së ujërave të larjes, ISSH-ja, në përputhje me kriteret e përcaktuara në shtojcën II, duhet të klasifikojë[43] ujërat e larjes si ujëra të cilësisë:
a) "së keqe";
b) "të mjaftueshme";
c) "të mirë";
d) "të shkëlqyer".
Nga auditimi ka rezultuar se VKM 797 nuk respektohet sa i përket monitorimit të cilësisë së ujërave të larjes duke qenë se në këtë proces nuk përfshihet institucioni i përcaktuar në këtë VKM dhe për më tepër ende nuk janë përcaktuar profilet e ujërave të larjes.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit referuar VKM-së nr. 1189 harton programin kombëtar të monitorimit të mjedisit dhe koordinon punën për zbatimin e tij në bashkëpunim me ministri të ndryshme. Instituti i Shëndetit Publik, është përgjegjëse për monitorimin e parametrave mikrobiologjikë për ujërat detare dhe plazhet, në përputhje me VKM-në nr. 1189.[44] Përzgjedhja e pikave të monitorimit ku kryhen matjet e ujërave të larjes bëhet sipas përcaktimit të bërë në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit.

Për periudhën objekt auditimi, por edhe gjatë viteve përpara saj, pavarësisht se dy VKM-të e sipërcituara (VKM nr. 797 dhe VKM nr. 1189) nuk janë të harmonizuara me njëra-tjetrën, ka gjetur zbatim VKM nr. 1189 sa i përket institucionit që duhet të bëjë monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së ujërave të larjes. Pra, është Instituti i Shëndetit Publik institucioni që kontraktohet nga Agjencia e Kombëtare e Mjedisit për të monitoruar dhe vlerësuar cilësinë e ujërave të larjes. Instituti i Shëndetit Publik i vendos në dispozicion AKM-së rezultatet e procesit të monitorimit të cilësisë së ujërave të larjes e cila i publikon në Raportin e Gjendjen në Mjedis. Instituti i Shëndetit Publik kryen monitorimet e cilësisë së ujërave të larjes sipas pikave të monitorimit (plazheve) të përcaktuara në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit (i cili mbështetet në VKM-në nr. 1189) duke anashkaluar kështu VKM nr. 797 e cila është ende në fuqi dhe sanksionon se si duhet të përzgjidhen (dhe kush[45] duhet t'i përzgjedhë) pikat e monitorimit të ujërave të larjes. Sa i përket, klasifikimit të kategorive të cilësisë së ujërave të larjes, Instituti i Shëndetit Publik bazohet në VKM-në nr 797 duke i klasifikuar në kategori të ndryshme cilësitë e ujërave të larjes në varësi të rezultateve mikrobiologjike të marra gjatë kampionimeve. Si përfundim, i gjithë procesi i monitorimit, vlerësimit dhe klasifikimit të cilësisë së ujërave të larjes "de facto" bëhet duke u bazuar në dy VKM të cilat kundërshtojnë njëra-tjetrën. VKM nr. 1189 nuk përfshin asnjë kërkesë në lidhje me vlerësimin dhe klasifikimin e cilësisë së ujërave të larjes. ISHP, lidhur me vlerësimin dhe klasifikimin e cilësisë së ujërave të larjes bazohet në VKM-në

[42] VKM nr. 797 dt 29.09.2010 **"**Për miratimin e rregullores higjieno-sanitare "Për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes", neni 6, pika 2 "a" dhe "b".
[43] VKM nr. 797 dt 29.09.2010 **"**Për miratimin e rregullores higjieno-sanitare "Për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes", neni 7, pika 1.
[44] VKM nr. 1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit", Kreu III, pika 2.
[45] Sipas VKM-së nr 797 është Inspektorati Sanitar Shtetëror (ish ISSH, sot ISHSH) që duhet të bëjë përzgjedhjen e pikave të monitorimit për vlerësimin e cilësisë së ujërave të larjes.

nr. 797. Kjo do të thotë se Instituti zbaton kërkesat e vendosura nga VKM nr. 1189 për monitorimin dhe kërkesat e VKM-së nr. 797 sa i përket klasifikimit dhe vlerësimit të cilësisë.

4. Gjetje nga auditimi: Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 797, datë 29.09.2010 "Për Administrimin e Cilësisë së Ujërave të Larjes", parashikohet detyrimi për përcaktimin e profileve të ujërave të larjes, një përgjegjësi që më parë i takonte Inspektoratit Sanitar Shtetëror. Megjithatë, deri më sot, në Shqipëri, këto profile nuk janë hartuar apo përcaktuar asnjëherë. Pas ristrukturimit institucional, Ish Inspektorati Sanitar Shtetëror (sot Inspektorati Shtetëror Shëndetësor) nuk e ka më të përcaktuar në mënyrë eksplicite këtë detyrim në funksionet e tij, ndonëse VKM nr. 797, mbetet ende në fuqi. Edhe institucionet e tjera që marrin pjesë në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së ujërave të larjes nuk kanë të parashikuar si detyrim ligjor përcaktimin e profileve të këtyre ujërave. Mungesa e përcaktimit të profileve të ujërave të larjes ndikon drejtpërdrejt në saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave mbi cilësinë e tyre. I gjithë ky proces është në mos përputhje me metodologjinë e përcaktuar në Direktivën e Këshillit të Evropës (e përfshirë në legjislacionin shqiptar përmes VKM nr. 797), sipas së cilës profilet e ujërave të larjes duhet të hartohen, monitorohen dhe vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme për të garantuar sigurinë mjedisore dhe shëndetin publik.

5. Gjetje nga auditimi: Në VKM nr. 1189, datë 18.11.2009 dhe VKM nr. 797, datë 29.09.2010, të dy ende në fuqi, nuk janë të harmonizuar dhe përmbajnë dispozita që bien në kundërshtim me njëra-tjetrën. Konkretisht, VKM nr. 1189, përcakton se Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) është përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së ujërave të larjes, ndërkohë që VKM nr. 797, ia atribuon këtë përgjegjësi Inspektoratit Sanitar Shtetëror (ish ISSH, sot ISHSH). Kjo situatë kontradiktore krijon paqartësi në lidhje me ndarjen e përgjegjësive dhe rolin e secilit institucion në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të ujërave të larjes. VKM nr. 797, përfaqëson aktin nënligjor që ka integruar në legjislacionin shqiptar Direktivën 2006/7/KE të Këshillit të Evropës, e cila rregullon menaxhimin e cilësisë së ujërave të larjes. Si e tillë, kjo VKM siguron një kuadër më të përditësuar dhe të harmonizuar me *acquis communautaire,* duke përcaktuar në mënyrë më të qartë dhe të saktë procedurat për monitorimin, vlerësimin dhe kategorizimin e cilësisë së ujërave të larjes.

Konkluzion 2: Institucionet përgjegjëse nuk kanë marrë masat e duhura sa i përket monitorimit të cilësuesi së ujërave të larjes duke qenë se nuk janë përcaktuar profilet e ujërave të larjes. Përcaktimi i tyre është parakushti kryesor për të përzgjedhur plazhet që do të duhet të monitorohen dhe rrjedhimisht për të pasur të dhëna të sakta dhe gjithëpërfshirëse.

5.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, të marrin masa për rishikimin dhe harmonizimin e VKM nr. 1189 dhe VKM nr. 797, duke marrë në konsideratë veçanërisht, përcaktimin e institucionit/ve përgjegjës për menaxhimin e cilësisë së ujërave të larjes, përfshirë monitorimin, vlerësimin dhe kategorizimin e tyre. Gjithashtu, në kuadër të këtij përditësimi, duhet të specifikohet qartë institucioni përgjegjës për hartimin dhe përcaktimin e profileve të ujërave të larjes.

Qershor 2026

4.1.3 Pse nuk janë marrë masat e duhura për të mos ekspozuar popullsinë ndaj ujërave të larjes me cilësi të keqe?

Informimi i publikut mbi cilësinë e ujërave të larjes, si dhe marrja e masave për ndalimin e ekspozimit në raste ndotjeje, është i rregulluar nga Rregullorja për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes.[46]. Në këtë rregullore përcaktohet se, në rastet kur ujërat e larjes klasifikohen me

[46] VKM 797, datë 29.09.2010 "Për miratimin e rregullores higjieno-sanitare "Për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes".

cilësi "të keqe" për pesë vite të njëpasnjëshme, ish ISSH duhet të vendosë masa më të rrepta, përfshirë ndalimin e përhershëm të larjes ose dhënien e një rekomandimi të përhershëm kundër larjes në këto ujëra[47]. Në këtë rregullore përcaktohen qartë kompetencat e ish ISSH-së në procesin e informimit të publikut dhe mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve.

Tabela nr. 7 Kompetencat e institucioneve sipas rregullores.

Kompetenca	**Organi përgjegjës**	**Ndikimi në publik**
Informimi në rast ndotjeje (Neni 7/4/a/iv)	ISSH + pushteti vendor	Sinjalistikë + shpjegime për ndotjen
Ndalimi i larjes (Neni 7/4/b)	ISSH	Ruajtje e shëndetit publik, ndalesë e përhershme e larjes ose rekomandim
Zbatimi i Nenit 14 (informimi publik)	ISSH + pushteti vendor	Transparencë, sinjalizim, akses në të dhëna

Burimi: VKM 797 Përpunoi: Grupi i auditimit

Nuk është marrë asnjë masë për mos ekspozimin e popullsisë në plazhet me cilësi të keqe.

Pas ndryshimeve ligjore, Inspektorati Sanitar Shtetëror është zëvendësuar me "struktura përgjegjëse për inspektimin në shëndetësi" [48], ndërsa funksionet e tij janë ndarë ndërmjet disa institucioneve shëndetësore dhe konkretisht ato inspektuese i kanë kaluar Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor. Megjithatë, VKM-ja nr. 797, datë 29.09.2010 nuk është përditësuar dhe mbetet ende në fuqi. Grupi i auditimit i është drejtuar Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) si institucioni përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, nga ku i është bërë me dije se:

Ky institucion ka nisur funksionimin mbi bazën e VKM-së nr. 241, datë 27.03.2013 dhe ka trashëguar vetëm funksionet inspektuese të mëparshme të Inspektoratit Sanitar Shtetëror (ISSH). Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nxjerr çdo vit një urdhër të posaçëm për marrjen e masave për sezonin turistik, në të cilin përcaktohen detyrat specifike për secilin institucion. Në secilin urdhër të çdo viti, nuk përcaktohet asnjë detyrë lidhur me njoftimin e publikut apo ndalimin e larjes në rast se ujërat e plazheve kanë rezultuar me cilësi të keqe për pesë vite të njëpasnjëshme. Pra, nuk është qartësuar se cilit institucion i kanë kaluar përgjegjësitë që do të duhej të kryheshin nga ish ISSH (në përputhje me VKM-në 797). Si pasojë, nuk është kryer njoftimi i publikut dhe ndalimi i përhershëm në ujërat larës të klasifikuar me cilësinë "e keqe" për pesë vite të njëpasnjëshme në dy raste (plazhi "pas kanalit të plepave" në Durrës dhe plazhi "shkolla e Marinës" në Vlorë).

[47] VKM nr. 797, datë 29.09.2010, neni 7, pika 4, shkronja "b".

[48] Ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7643, datë 2.12.1992 "Për shëndetin publik dhe inspektoratin sanitar shtetëror", me përditësimin e fundit me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024 "Për Inspektimin Sanitar", neni 2.

Figura nr. 2 Raportimi mbi cilësinë e ujërave në plazhe deri në njoftimin të publikut, kryhet si më poshtë:



Punoi: Grupi i auditimit

AKM nuk ka informuar në mënyrë të rregullt të gjitha bashkitë, të cilat nga procesi i monitorimit kanë rezultuar si plazhe me cilësi të keqe.

VKM nr. 797, datë 29.09.2010,[49] parashikon detyrimin e bashkive për të ndërmarrë masa të menjëhershme në informimin e publikut mbi ujërat e larjes, bazuar në sugjerimet nga ISSH. Siç është theksuar dhe më sipër, aktualisht ISSH nuk është përfshirë në procesin e monitorimit të cilësisë së ujërave të larjes. Ky proces kryhet nga AKM e cila nënkontrakton ISHP.[50] Në këtë kontratë përcaktohen detyrimet midis palëve, nga ku pala porositëse gëzon të drejtën e pronësisë mbi të dhënat e monitorimit deri në përfundim të afatit kohor të kontratës. Pra, AKM është i vetmi institucion zotërues i drejtpërdrejtë i të dhënave të monitorimit nga ISHP. Kontrata e shërbimit[51] midis AKM-së dhe ISHP-së kryhet çdo vit dhe ka për qëllim, ndër të tjera të:

- kryejë vlerësimin e faktorëve ekspozues të ndotjeve të plazheve, me qëllim sigurimin e cilësisë dhe mbrojtjen e shëndetit publik nga efektet negative të ndotjes në plazhe;
- evidentojë zonat me rrezikshmëri të lartë për shëndetin e popullatës;
- të bëjë interpretim shkencor të të dhënave të grumbulluara nga monitorimi që t'u shërbej autoriteteve kompetente qendrore e vendore vendim marrëse, për menaxhimin dhe planifikimin e zonave bregdetare me synim nxitjen e turizmit bregdetar.

Pra, me anë të të dhënave që ISHP i siguron AKM-së, kjo e fundit bën njoftimin e bashkive lidhur cilësinë e ujërave të larjes, veçanërisht në rastet kur ato klasifikohen me cilësi të keqe.

Mbi raportimin e pjesshëm teknik të rezultateve të monitorimit, gjatë sezonit turistik.

ISHP i dërgon AKM-së raportime të pjesshme teknike në datat 5 Qershor, 5 Gusht dhe 15 Tetor. Në raportimet e pjesshme teknike përfshihen rezultatet për secilën pikë monitorimi. Rezultatet e monitorimeve të pjesshsme duhet ti transmetohen bashkive në mënyrë që të ndëmarrin masa në kohë reale në rast konstatimi ndotjeje mbi normën e lejuar. Raportet teknike të pjesshme dhe përfundimtare të dorëzuara nga Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) tek Agjencia Kombëtare e

[49] Neni 14 pika 2 e VKM-së 797, datë 29.09.2010 "Për miratimin e rregullores higjieno-sanitare "Për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes".
[50] Në përgjigje të pyetësorit të nisur me e-mailit datë 04.10.2024.
[51] Kontratë shërbimi "Për realizimin e monitorimit të mjedisit", nr. prot., 2712/3 AKM, datë 17.04.2024, nr. prot., 283/2 ISHP, datë 12.04.2024

Mjedisit (AKM) për periudhën 2019–2023 përfshijnë rekomandime të qarta për bashkitë, ndër të cilat më e rëndësishmja është vendosja e tabelave të informacionit në kohë reale në çdo pikë monitorimi për të informuar qytetarët mbi cilësinë e ujërave bregdetare të larjes.

Grupi i auditimit ka konstatuar se, AKM nuk ka informuar në mënyrë të rregullt dhe në kohë reale të gjitha bashkitë mbi cilësinë e ujërave të larjes pas marrjes së raportimeve të pjesshme nga ISHP. Konkretisht, gjatë sezonit turistik në gusht të vitit 2023, AKM nuk ka njoftuar bashkitë Vlorë, Durrës dhe Pogradec në lidhje me rezultatet e monitorimeve të pjesshme.
Nga të dhënat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit, rezulton se vetëm në dy raste (gjatë sezoneve turistike të viteve 2020 dhe 2022), AKM ka njoftuar bashkitë Durrës dhe Vlorë pas raportimeve të para të pjesshme nga ISHP, ku janë evidentuar pika monitorimi me përmbajtje mikrobike mbi normat e lejuara. Konkretisht, gjatë sezonit turistik, AKM ka njoftuar:

- Në qershor 2020, bashkitë Vlorë dhe Durrës.
- Në qershor 2022, bashkinë Vlorë.

Mbi raportimin e përfundimtar të rezultateve të monitorimit, pas sezonit turistik.
Raportimet përfundimtare të ISHP-së drejtuar AKM-së, për vitet 2019-2023, janë gjithashtu të shoqëruara me rekomandime përkatëse për bashkitë.[52] Këto raportime përfundimtare i përcillen AKM-së në fund të vitit. Siç u përmend edhe më sipër, AKM, pas marrjes së raportit përfundimtar nga ISHP, në rastet kur nga monitorimi rezultojnë plazhe me cilësi të keqe duhet të njoftojë bashkitë përkatëse edhe pas marrjes së raportit përfundimtar në fund të vitit. Pra, bashkitë duhet të njoftohen dhe mbi rezultatet e monitorimit të sezonit të kaluar. Sa i përket periudhës objekt auditimi (2019-2023), nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, AKM nuk ka kryer asnjë njoftim për bashkitë mbi monitorimin e vitit 2021, përgjatë vitit 2022, nga ku kanë rezultuar tre pika me cilësi të keqe në plazhin e Vlorës, dy pika në plazhin e Durrësit dhe një pikë në plazhin e Kajavës.[53] Gjithashtu, përgjatë vitit 2024 nuk ka njoftuar Bashkitë Lezhë dhe Rrogozhinë, plazhet e të cilave nga monitorimi i 2023 kanë rezultuar me cilësi të keqe.[54]

Ndërsa, për vitet 2021, 2023, 2024, bashkitë janë njoftuar nga AKM mbi monitorimin përfundimtar. Konkretisht njoftimet janë kryer:

- Në shkurt të vitit 2020, AKM ka njoftuar mbi monitorimin e cilësisë së ujërave larës të realizuar për vitin 2019 bashkitë Durrës, Vlorë dhe Pogradec.
- Në mars të vitit 2021, AKM ka njoftuar sërish bashkitë e Durrësit dhe Vlorës mbi monitorimin e cilësisë së ujërave larës të realizuar për vitin 2020.
- Në mars të vitit 2023, AKM ka njoftuar bashkitë e Durrësit, Vlorës dhe Sarandës mbi monitorimin e cilësisë së plazheve për vitin 2022.
- Në prill të vitit 2024, AKM ka njoftuar bashkitë Durrës, Kavajë, Vlorë dhe Pogradec mbi monitorimin mikrobiologjik të ujërave larës të realizuar për vitin 2023.

Për sa më sipër, është konstatuar se AKM nuk ka zbatuar një praktikë të rregullt dhe në kohë për njoftimin e bashkive mbi cilësinë e ujërave të larjes. Mosnjoftimi i rregullt dhe në kohë kufizon mundësinë për marrjen e masave të menjëhershme nga pushteti vendor dhe cënon mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve.

Informimi i publikut dhe vendosja e sinjalistikave në plazhet me cilësi të keqe nuk është kryer.
Bashkitë, pas marrjes së njoftimit nga AKM mbi cilësinë e ujërave në plazhe,[55] duhet të ndërmarrin disa masa, ku një ndër to është edhe vendosja e tabelave informuese pranë plazheve

[52] Raportet teknike përfundimtare nga ISHP drejtuar AKM-së, datë 14.12.2021, 27.12.2022 dhe 07.12.2023
[53] Raporti i Gjendjes në Mjedis 2021.
[54] Raporti i Gjendjes në Mjedis 2023.
[55] VKM Nr. 797 për miratimin e rregullores higjieno-sanitare "Për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes", neni 4, pika 2, "vi" dhe neni 7 pika 4 gërma "a", iv.

me cilësi të keqe. Informacioni që duhet ti përcillet qytetarëve duhet të jetë dhe mbi klasifikimin e fundit të ujërave larës. Vendosja e tabelave pranë plazheve ka për qëllim informimin e publikut mbi cilësinë e ujërave të larjes, parandalimin e ekspozimit ndaj ndotjes. Pikat e monitorimit në stacionet e plazheve të bashkive Vlorë, Durrës, Lezhë dhe Rrogozhinë janë kategorizuar me cilësi "të keqe" sipas rezultateve të monitorimit për vitin 2023. Megjithatë, AKM ka njoftuar në vitin 2024 vetëm bashkitë Vlorë dhe Durrës, për rezultatet e monitorimit të vitit 2023[56], duke theksuar nevojën për marrjen e masave të menjëhershme dhe për përmirësimin e situatës duke qenë se nis sezoni tjetër turistik. Grupi i auditimit, nga verifikimet në terren[57] në korrik të vitit 2024, ka konstatuar mungesën e informimit të publikut dhe sinjalistikës e cila duhej të ishte vendosur nga bashkia Vlorë. Konkretisht, në plazhet që kanë rezultuar të ndotura (nga monitorimi i 2023), si Plazhi e Kabinave, Plazhi i Kampit të Pionierëve dhe Shkolla e Marinës, mungonte sinjalistika për të paralajmëruar pushuesit mbi cilësinë "e keqe" të këtyre plazheve.

Grupi i auditimit, së bashku me përfaqësues të bashkisë Durrës, kreu verifikime[58] edhe në plazhet e Durrësit, duke përfshirë Plazhin "Ura e Dajlanit", Plazhin Benilva, Shkëmbin e Kavajës, Kanalin pas Plepave dhe Plazhin e Zhironit. Po ashtu, edhe pse bashkia Durrës është njoftuar nga AKM mbi cilësinë "e keqe" të ujërave të larjes, nga verifikimet në terren të grupit të auditimit në korrik të vitit 2024, u konstatua se bashkia Durrës nuk ka marrë masat e nevojshme për të informuar dhe mbrojtur popullsinë nëpërmjet vendosjes së sinjalistikës së nevojshme pranë këtyre plazheve.

Në Raportin e Gjendjes në Mjedis 2023, kanë rezultuar dhe tre plazhe me cilësi të keqe në bashkinë Lezhë. Grupi i auditimit kreu verifikime së bashku me përfaqësues të bashkisë Lezhë[59] pranë këtyre plazheve, nga ku u konstatua se bashkia Lezhë nuk kishte marr masa për vendosjen e tabelave informuese për publikun mbi cilësinë e ujërave. Megjithatë, bashkia Lezhë nuk ka marr njoftim me shkrim për cilësinë e tyre nga AKM.

Foto nr. 1 Mungesa e sinjalistikës në plazhet me cilësi të keqe sipas RGJM 2023.

Plazhi i Durrësit, Restorant Tirona.

Plazhi i plepave Durrës.

[56] Shkresat e AKM-së, nr. 4233 prot., datë 16.04.2024, drejtuar bashkisë Durrës, nr. 4232 prot., datë 16.04.2024, drejtuar bashkisë Vlorë.
[57] Akt-verifikimet e mbajtura nga grupi i auditimit, datë 10.07.2024, nr. Prot., 10917 Bashkia Vlorë.
[58] Akt Verifikim datë 18.07.2024, nr. Prot., 5724/3 Bashkia Durrës.
[59] Akt Verifiki datë 24.07.2024, nr. Prot., 12884 Bashkia Lezhë.

Foto nr 2. Plazhi i Spilles

6. Gjetje nga auditimi: Në VKM-në nr. 797 parashikohet ndalimi i përhershëm i larjes ose rekomandimi për mos t'u larë në ujëra me cilësi të keqe të kategorizuara si të tilla për pesë vite të njëpasnjëshme, veprimet këto që duhen bërë nga ish Inspektorati Sanitar Shtetëror (ISSH). Megjithatë, nga auditimi ka rezultuar se nuk ka asnjë institucion shëndetësor që ushtron këto funksione. Përkatësisht, në dy plazhe në bashkinë Vlorë dhe Durrës, të cilat kanë rezultuar me cilësi të keqe për pesë vite të njëpasnjëshme, nuk është ndërmarrë asnjë masë për ndalimin e larjes ose për dhënien e një rekomandimi për ndalim të saj. VKM nr. 797, datë ... nuk është përditësuar për të reflektuar ndryshimet ligjore që pasuan me riorganizimit të ISSH-së. Kjo situatë ka krijuar paqartësi lidhur me institucionin shëndetësor që ka aktualisht përgjegjësinë për ndalimin e larjes në ujërat e ndotura dhe paraqet një risk të vazhdueshëm për shëndetin publik, për shkak të ekspozimit të popullsisë ndaj ujërave të ndotura.

7. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit duhet të njoftojë bashkitë në rastet kur nga procesi i monitorimit rezultojnë ujëra larjes (plazhe) me cilësi të keqe. Rezultatet e procesit të monitorimit raportohen nga Instituti i Shëndetit Publik te AKM nëpërmjet 3 raportimeve të pjesshme teknike, një draft raport përfundimtar dhe raportim përfundimtar (të shoqëruara me rekomandime përkatëse). AKM nuk ka zbatuar një praktikë të rregullt dhe në kohë për njoftimin e bashkive. Ndryshe nga viti 2020 dhe 2022, në gusht të vitit 2023 pas raportimit të pjesshëm teknik nga ISHP, nuk ka njoftuar bashkitë Vlorë, Durrës dhe Pogradec, edhe pse ISHP ka rekomanduar njoftimin me shkrim për bashkitë dhe vendosjen e tabelave të informacionit në kohë reale në çdo pikë monitorimi për të informuar qytetarët mbi cilësinë e ujërave bregdetare të larjes. Sa i përket raportimeve përfundimtare, AKM nuk ka kryer asnjë njoftim për bashkitë mbi monitorimin e vitit 2021, përgjatë vitit 2022, nga ku kanë rezultuar tre pika me cilësi të keqe në plazhin e Vlorës, dy pika në plazhin e Durrësit dhe një pikë në plazhin e Kavajës. AKM, gjatë vitit 2024, nuk ka njoftuar Bashkinë Lezhë dhe Rrogozhinë mbi rezultatet përfundimtare të monitorimit të cilësisë së ujërave të larjes për vitin 2023. Mos njoftimi i rregullt dhe në kohë ndikon në mos marrjen e masave në kohë nga bashkitë, si dhe cënon mbrojtjen e shëndetit publik.

8. Gjetje nga auditimi: Në rregulloren për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes, përcaktohet se bashkitë duhet të informojnë publikun me anë të tabelave informuese në rast se ujërat e larjes klasifikohen me cilësi të keqe. Bashkitë Vlorë dhe Durrës nuk kanë vendosur sinjalistikë për informimin e publikut edhe pse ato janë njoftuar nga AKM për plazhet me cilësi të keqe që kanë rezultuar nga monitorimi i vitit 2023. Mungesa e sinjalistikave informuese ekspozon pushuesit ndaj rreziqeve të ndotjes mikrobike me nivele më të larta se normat e lejuara, pa qenë të informuar.

Konkluzion 3: Nuk është marrë asnjë masë mbi ndalimin e larjes në ujërat me cilësi të keqe ose dhënies së rekomandimit për të mos u larë në to nga një institucion shëndetësor, pasi rregullorja mbi administrimin e ujërave larës nuk është përditësuar dhe nuk ka një përcaktim se cilit institucion i kanë kaluar këto funksione. Nga ana tjetër, AKM nuk ka raportuar periodikisht dhe

në kohë në bashkitë të cilat kanë plazhe me cilësi të keqe. Bashkitë Vlorë dhe Durrës edhe kur janë njoftuar, nuk kanë vendosur sinjalistikë/tabela, pranë plazheve me cilësi të keqe me qëllim njoftimin e qytetarëve mbi cilësinë e ujërave.

6.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrë masa për rishikimin dhe përditësimin e VKM nr. 797, datë 29.9.2010 "Për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes", me qëllim përcaktimin e qartë të kompetencave të çdo institucioni përgjegjës në funksion të mbrojtjes së qytetarëve nga ekspozimi ndaj ujërave të larjes me cilësi të keqe.

Qershor 2026

7.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit, deri në përditësimin e VKM-së nr. 797, datë 29.9.2010 të marrë masa të njoftojë bashkitë të cilat rezultojnë me plazhe me cilësi të keqe, bazuar në procesin e monitorimit të ujërave të larjes. Ky njoftim duhet të përfshijë jo vetëm rezultatet përfundimtare të monitorimit, por edhe të dhënat e përkohshme që dalin nga raportimet teknike të pjesshme. Njoftimi duhet kryer jo vetëm për sa i përket rezultateve përfundimtare të procesit të monitorimit të cilësisë së ujërave të larjes, por edhe pas rezultateve të raportimeve të pjesshme teknike.

Në vijimësi

8.1 Rekomandimi: Të gjitha bashkitë, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, të marrin masa të menjëhershme për vendosjen e sinjalistikës informuese në plazhet që janë klasifikuar me cilësi të keqe të ujërave të larjes, bazuar në rezultatet e monitorimit vjetor apo raportimeve teknike të pjesshme, me qëllim informimin e publikut dhe mbrojtjen e shëndetit të pushuesve.

Menjëherë e në vijimësi

4.2 Pyetja audituese: A ka qenë efektiv procesi i trajtimit të ujërave të ndotura urbane nga institucionet përgjegjëse?

Trajtimi i ujërave të përdorura, nëpërmjet procesit fizik me anë të dekantimit parësor, që mënjanon 60% të lëndës pezull dhe 20% të NBO5, në kuptim të ligjit në fuqi quhet "Trajtim parësor". Ndërsa trajtimi i ujërave të ndotura nëpërmjet procesit biologjik, me shtrat bakterial, basen ajrimi, llum aktiv, duke u shoqëruar, në raste të veçanta, me trajtim tretës (dekantim/filtrim), për realizimin e denitrifikimit dhe defosfatimit e të veçanta, me trajtim tretës (dekantim/filtrim), për realizimin e denitrifikimit dhe defosfatimit është "Trajtim dytësor.[60] Referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga AKUK impiantet në vendin tonë me përjashtim të qytetit të Vlorës e cila kryen trajtim parësor, impiantet e tjera në bashkitë subjekt auditimi (Himarë, Shkodër, Lezhë, Durrës, Kavajë), kryejnë trajtim dytësor. Referuar kuadrit ligjor kombëtar[61], por edhe Direktivës së Këshillit të Evropës 91/271, përpunimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura duhet të bëhet me anë të trajtimit sekondar ose dytësor.[62]

4.2.1 A ofrohet shërbimi i duhur i trajtimit të ujërave të ndotura urbane për popullsinë e bashkive subjekt auditimi?

Të dhënat mbi kapacitetet e ITUN-eve nuk përputhen.

Përgjegjësia për ofrimin e shërbimit të largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane shtrihet në të dyja dimensionet e qeverisjes, asaj qendrore dhe asaj vendore. Qeverisja qendrore është përgjegjëse për përcaktimin e vizionit strategjik të sektorit dhe hartimin dhe monitorimin e kuadrit rregullator mbi të cilin mbështetet gjithë sektori, ndërsa qeverisja vendore është

[60] Ligji nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura, neni 3, pika 8 dhe 9.
[61] Ligji 9115, "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura, neni 12.
[62] Council Directive of 21 May 1991, Concerning urban waste water treatment, Article 4 point 1.

përgjegjëse për ofrimin e këtij shërbimi. Në kuadër të mbrojtjes së mjedisit, zhvillimit të turizmit dhe procesit të integrimit në Bashkimin Evropian, një ndër prioritetet e Qeverisë Shqiptare është ndërtimi i infrastrukturës të trajtimit të ujërave të ndotura urbane, me fokus të veçantë në zonat turistike. Referuar Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve (SKRSFUK) 2023–2030, janë ndërtuar dhe janë në funksionim 12 impiante në zonat urbane dhe turistike, si dhe janë në proces ndërtimi 3 impiante të reja. Gjithashtu, janë planifikuar për t'u ndërtuar 2 impiante në zona urbane me potencial të lartë zhvillimi turistik. Në këtë strategji citohet gjithashtu ofrimi i shërbimit të pastrimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura për një numër të konsiderueshëm të konsumatorëve që kanë gropa septike[63]. Ndërkohë, nga të dhënat e grumbulluara nga grupi i auditimit, në bashkitë subjekt auditimi janë ndërtuar prej vitesh impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane të Velipojës, Shirokës, Lezhës, Durrësit, Lalëzit, Kavajës, Vlorës, Palasë, Dhralë-Dhërmi, pra në total 9 impiante. Qëllimi i impianteve është përmirësimi i cilësisë së ujërave të ndotura që shkojnë për t'u trajtuar në to. Në këtë mënyrë bëhet e mundur reduktimi i elementëve ndotës të ujërave të ndotura urbane që në fund, pas trajtimit në ITUN-e, shkarkohen në mjedisin pritës. Në tabelën më poshtë paraqiten të dhënat mbi kapacitetin e ITUN-ve në m^3/në ditë, (në territorin e bashkive subjekt auditimi).

Tabela nr. 8 Të dhëna mbi kapacitetet e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane[64]

Bashkitë	**Impianti i trajtimit të ujërave te ndotura urbane**	**Kapaciteti m^3/në ditë referuar:**		
		AKUK	**UK**	**Lejeve Mjedisore**
Shkodër	Shirokë	350	-	320[65]
	Velipojë	15,800	10,800	-
Lezhë	Kune, Shëngjin	12,240	1,920	1,920[66]
Durrës	Durrës	60,000		23,000[67]
	Lalëz	2,500		30
Kavajë		4,500		-
Rrogozhinë		0	0	0
Lushnje		0	0	0
Fier		0	0	0
Vlorë		42,000		-
Himarë	Dhrale, Palasë	450	7,500	1,500 [68]
	Dhërmi	S ka info	-	-

Burimi: AKUK, UK-të respektive Përpunoi: Grupi i auditimit

Për sa më sipër, vihet re se të dhënat mbi kapacitetet e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane nuk paraqiten në vlerë të njëjtë nga burime të ndryshme informacioni. Të dhënat e paraqitura nga AKUK, UK-të rajonale dhe ato në Lejet Mjedisore nuk përputhen, fakt i cili tregon për një mungesë koordinimi dhe rakordimi ndërmjet institucioneve. Për sa më sipër, grupi i auditimit gjatë diskutimeve me zyrtarët e AKUK, parashtroi problematikat e konstatuara në lidhje me mos rakordimin e të dhënave. Nga ana e tyre nuk u paraqitën dokumente zyrtare justifikuese për të saktësuar këto të dhëna.

Shërbimi i trajtimit të ujërave të ndotura nga ITUN-et nuk ofrohet në të gjithë territorin e bashkive subjekt auditimi.

Nga 9 bashkitë subjekt auditimi vetëm 6 prej tyre kanë impiant të trajtimit të ujërave të ndotura, me konkretisht: Durrës (2 impiante), Vlorë (1 impiant), Shkodër (2 impiante), Lezhë (1 impiant),

[63] Vendim Nr. 448, datë 26.7.2023 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023–2030".
[64] Të dhënat paraqitura bazohen në përgjigjet e AKUK, UK rajonale dhe Lejeve Mjedisore;
[65] Leje e mjedisi Tipi B, nr. 8761 prot., datë 21.08.2014
[66] Leje e mjedisi Tipi B, nr. 4600 prot., datë 18.07.2023
[67] Leje e mjedisi Tipi B, nr. 391 3prot., datë 16.06.2023
[68] Leje e mjedisit nr. 469 prot., datë 23.01.2017, Kushti 1, pika 1.1.

Kavajë (1 impiant) dhe Himarë (2 impiante). Pra në total, siç është paraqitur edhe më sipër, në këto 9 bashki janë 9 impiante të trajtimit të ujërave të ndotura nga të cilat 1 prej tyre (Kavaja) nuk është në gjendje pune.
Më konkretisht, ITUN-et e Shirokës, Velipojës, Lezhës, Lalzit, Durrësit, Palasës dhe Dhrales-Dhërmi kryejnë trajtim dytësor. ITUN-i i Vlorës kryen trajtim parësor, ndërsa për bashkitë Fier,, Lushnje dhe Rrogozhinë nuk ka ITUN-e dhe për rrjedhojë nuk kryhet trajtimi i ujërave të ndotura urbane. Në tabelën më poshtë, për secilin impiant funksional paraqitet sasia e trajtuar (në m^3) e ujërave të ndotura urbane. Bazuar në sasinë (në m^3) që gjenerohet nga 1 banor/ditë[69], grupi i auditimit ka përllogaritur numrin e popullsisë që mbulohet me shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura urbane për çdo bashki në auditim. Raporti i këtij numri me numrin total të bashkisë përkatëse tregon përqindjen e popullsisë të çdo bashkie së cilës i mundësohet trajtimi i ujërave të ndotura urbane.

Tabela nr. 9 Të dhëna mbi kapacitetet e trajtimit të ujërave

Bashkitë	**Impianti i trajtimit të ujërave te ndotura urbane**	**Sasia e trajtuar m^3/ne dite (nr. faktik) (a)**	**Numri faktik i popullsisë i mbuluar me shërbim (b) = (a/0.2)**	**Numri i popullsisë për bashki[70] (c)**	**% e popullsisë e mbuluar me shërbim (d) = (b/c)**
Shkodër	Shirokë	90	450	102,434	4,8%
	Velipojë	900	4500		
Lezhë		1920	9600	51,354	19%
Durrës		23,000	115,000	153,614	75%
	Lalëz	30	150		
Kavajë		0	0	30,012	0%
Rrogozhinë		0	0	12,567	0%
Lushnje		0	0	63,135	0%
Fier		0	0	101,963	0%
Vlorë		0	0	83,683	0%
Himarë	Palasë	1500	0	8,328	0%
	Dhralë-Dhërmi				
Total		27,440	129,700	607,090	21.3%

Të dhëna nga AKUK

*Sasia e trajtuar m^3/ditë është përllogaritur sipas koeficientit të dhënë 1 banorë = 0.2 m^3/ditë.

Impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane duhet të kenë kapacitete të tilla që të arrihet trajtimi i ujërave të ndotura të gjeneruara nga e gjithë popullsia. Në zonat turistike, planifikimi dhe projektimi i impianteve, krahas popullsisë vendase duhet të marrë në konsideratë edhe turistët sezonalë, veçanërisht kur subjektet që operojnë në sektorin e hoteleri-turizëm nuk kanë impiante individuale të trajtimit të ujërave të ndotura.
Siç paraqitet edhe në tabelën e mësipërme, në disa raste kapacitetet e projektuara të impianteve janë të pamjaftueshme për të përballuar sasinë e projektuar të gjeneruar nga popullsia vendase. Ndërsa, sa i përket situatës faktike, nuk arrihet të mbulohet 100 % me trajtim të ujërave të ndotura urbane popullsia në secilën prej bashkive subjekt auditimi. Volumi (i përafërt) i trajtuar i ujërave të ndotura urbane në 9 bashkitë subjekt auditimi është **27,440** m^3/ditë. Kjo sasi gjenerohet nga rreth **129,000** banorë. Referuar INSTAT-it, popullsia e 9 bashkive të mësipërme është **607,090**

[69] Sipas AKUK, sasia që gjenerohet përafërsisht nga 1 banor/ditë nga këto impiante përllogaritet bazuar në VKM nr. 83/2021 "Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe të ndërtimit për furnizimin me ujë dhe kanalizime", si dhe në Direktivën e Bashkimit Evropian Nr. 91/271.EEC për Trajtimit të Ujërave të Ndotura, ku përcaktohet se 1 PE = 200 litra ujë (0.2 m^3) të ndotur urban/ditë.
[70] INSTAT

banorë. Pra, shërbimi i trajtimit të ujërave të ndotura urbane me një impiant trajtimi sigurohet përafërsisht për **21.3%** të popullsisë të këtyre bashkive.
Nëse i referohemi një praktike të mirë siç është Lituania, në raportin e auditimit të kryer në vitin 2020 nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Lituanisë[71], evidentohet se shërbimi i trajtimit të ujërave të ndotura urbane (ujërat e zeza) i sigurohet 2.1 milionë banorëve ose 76.5% të popullsisë totale të Lituanisë. Çdo vit, në Lituani, trajtohen nëpërmjet impianteve rreth 164.6 milionë m^3 ujëra të ndotura urbane.
Kjo hartë tregon mbulimin në përqindje të popullsisë rezidente në bashkitë subjekt auditimi, pa përfshirë numrin e turistëve gjatë sezonit turistik. Kjo për arsye të mungesës së të dhënave të detajuara të numrit të turistëve për çdo bashki.

Harta nr. 2 Mbulimi i popullsisë me shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotur urban



Burimi: AKUK, përpunoi grupi i auditimit

[71] Summary of Audit Report of Lithuania SAI, Summary Water Supply and Waste-Water Management, 19 November 2020, pg. 1&2.

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime *Lezhë* është përgjegjës për largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane të gjeneruara në territorin e Bashkisë Lezhë. Ky proces kryhet nëpërmjet impiantit të përpunimit të ujërave të ndotura, i cili mbulon një sipërfaqe të vogël (vetëm zonën urbane) të qytetit të Lezhës për trajtimin e ujërave të ndotura. ITUN Lezhë është funksional dhe kryen procesin e trajtimit të plotë, parësor dhe dytësor, por niveli i përpunimit të ujërave të ndotura në këto lloje impiantesh është i limituar. Kapaciteti i projektuar për ITUN është 1920 m^3/ditë. Pika e shkarkimit të impiantit të Lezhës është me këto koordinata 41°47'44.3"N 19°36'51.4"E.
ITUN Lezhë mbulon një territor afërsisht 6 km^2 të Bashkisë Lezhë. Sipas UK Lezhë, popullsia së cilës i ofrohet shërbimi i trajtimit të ujërave të ndotura nga ky impiant është rreth 35.000 banorë. Ky impiant funksionon tërësisht me ngritje mekanike. Çdo litër ujë transportohet dhe përpunohet me energji elektrike, e cila ka kosto të lartë. ITUN Lezhë është projektuar në vitet 2003-2004. Referuar UK Lezhë, ky ITUN, bazuar në ndryshimet e mëdha ndërtimore e demografike, shumëfishimi i fuqisë akomoduese dhe lëvizjes ditore, sidomos gjatë sezonit veror turistik në qytetin e Shëngjinit dhe të Lezhës, paraqet nevojën për rritjen e kapacitetit volumetrik dhe përmirësimin e teknologjisë ekzistuese.

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime *Shkodër* është përgjegjës për largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane të gjeneruara në territorin e Bashkisë Shkodër. Në këtë bashki, ky proces kryhet nëpërmjet dy impianteve të pozicionuara në Shirokë dhe Velipojë, të cilët kanë kapacitete shumë të vogla krahasuar me numrin e popullsisë të kësaj bashkie. Shiroka, me kapacitet trajtimi për rreth 350 m^3/ditë dhe Velipoja me kapacitet trajtimi rreth 10,800 m^3/ditë, aktualisht trajtojnë respektivisht rreth 90m^3/ditë dhe rreth 900 m^3/ditë. Bazuar në volumin në $m/^3$ ditë të trajtuar, numri i popullsisë së shërbyer nga këto impiante është respektivisht 450 dhe 4500. Këto janë vlera të përafërta të raportuara nga UK Shkodër, duke qenë se instrumenti matës për përllogaritjen e sasisë së trajtuar të ujërave të ndotura “Flaumetri”, nuk është në gjendje pune prej kohësh, pra jashtë funksioni. ITUN Shirokë mbulon vetëm territorin e Shirokës në Shkodër. Ndërsa ITUN Velipojë mbulon territorin e Velipojës.

Foto nr. 2 Pamje nga Impiantet e Velipojës dhe Shirokës.

Burimi: Grupi i auditimit

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime *Durrës* është përgjegjës për largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane të gjeneruara në territorin e Bashkisë Durrës. Ky proces kryhet nëpërmjet dy impianteve (Vrrin për qytetin e Durrësit dhe Shijakut dhe Gjiri i Lalëzit).
Në zonën e plazhit nga Ura e Dajlanit deri te Përroi Agait janë 11 stacione pompimi që shërbejnë për grumbullimin e ujërave të ndotura, të cilat e grumbullojnë ujin për në impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura në Vrrin. Në zonat e qytetit ka rrjet kanalizimi të kohës së Italisë dhe është sistem miks, ujëra të ndotura dhe ujëra shiu, të cilat shkarkohen në ITUN me anën e 3 stacioneve të pompimit. Ndërkohë që ka zona në qytet si Shkozet, ish Këneta, Spitalla apo Porto Romano, të cilat janë pjesërisht të lidhura me Impiantin. ITUN Vrrin, me kapacitet maksimal rreth 60,000 m^3/ditë aktualisht trajton rreth 23,000 m^3/ditë. Ky volum i korrespondon ose mbulon me shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura urbane rreth 115,000 banorë
Nga të dhënat e siguruara nga UK Durrës ITUN Gjiri i Lalzit, me kapacitet rreth 2500m^3/ditë, përpunon dhe trajton ujërat e ndotura të zonës turistike Gjiri i Lalzit të cilat grumbullohen me 4 stacione pompimi.

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime *Kavajë* është përgjegjës për largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane të gjeneruara në territorin e Bashkisë Kavajë. Aktualisht ITUN-i i Kavajës prej 3-4 vitesh është jashtë funksionit që nënkupton që i gjithë territori i Bashkisë Kavajë është i pa mbuluar me shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura urbane. Pavarësisht kësaj, ai ka një kapacitet trajtimi rreth 18,000 - 20,000m^3/ditë. Nga korrespondenca me UK Durrës, ky impiant ka nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme rutinë apo për investime kapitale, pasi rrjeti dhe pajisjet e impiantit janë totalisht të amortizuara.

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime *Vlorë* është përgjegjës për largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane të gjeneruara në territorin e Bashkisë Vlorë. Ky proces për qytetin e Vlorës kryhet nëpërmjet një impianti për trajtimin e ujërave të ndotura, i cili aktualisht ofron vetëm trajtim mekanik (trajtim primar) dhe nuk kryen trajtim sekondar në përputhje me kërkesat ligjore.[72] Trajtimi primar përfshin vetëm largimin e pjesëve të ngurta. Gjendja e impiantit është e keqe dhe ka nevojë për përmirësime të konsiderueshme. Ujërat që dalin nga ky impiant janë të trajtuara vetëm rreth 35% dhe këto bashkohen me ujëra të pa trajtuara që vijnë nga hidrovori (i cili gjithashtu mbledh ujëra të ndotura të qytetit) dhe në fund përfundojnë në det. Sasia e ujërave të ndotura që hyjnë në impiant janë rreth 2990 m^3/ditë.

Foto nr. 3 Pika ku shkarkohen ujërat pas trajtimit nga ITUN Vlorë.[73]

Burimi: Grupi i auditimit, Korrik 2024

[72] Ligji nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura, neni 12.
[73] Koordinata 40.47080° N, 19.45880° E

Foto nr 4. Pamje nga ITUN-i i Vlorës

Burimi: Grupi i auditimit, Korrik 2024

Harta nr. 3 Vendndodhja[74] e shkarkimeve të ujërave të ndotura urbane në plazhin shkolla e Marinës në Vlorë



Burimi: Grupi i auditimit

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime *Vlorë* është përgjegjës për largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane të gjeneruara në territorin e Bashkisë Himarë. Në territorin e kësaj bashkie janë ndërtuar dhe funksionojnë dy ITUN-e. ITUN-i Palasë është ndërtuar në vitin 2017. Ky impiant trajton ujërat e ndotura që gjenerohen nga kompleksi turistik "G. C." në Palasë. Ky impiant nuk përfshin trajtimin e ujërave të ndotura të gjeneruara nga fshati Palasë apo dhe fshatra të tjerë përreth. Ai është nën administrimin e Bashkisë Himarë dhe nuk ka kaluar akoma në pronësi të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime. Shkarkimet e këtij impianti me ujëra të trajtuara nga depuratori derdhen në Përroin e Thatë dhe në Detin Jon.

Në territorin e Bashkisë Himarë vetëm disa qindra metra nga ITUN-i "Dhralë-Dhërmi" gjendet një tjetër impiant i cili mbulon trajtimin e ujërave të ndotura të gjeneruara nga fshatrat Drimadhë dhe Dhërmi. Kapaciteti i trajtimit është rreth 600 m^3/ditë. Ky impiant është projektuar për të bërë

[74] Akt Verifikimi i mbajtur më datë 09.07.2024 protokolluar në SHRUK Vlorë me nr. 01/11 me koordinata gjeografike 40°26'51.7"N 19°29'32.8"E

trajtim biologjik me llum aktiv (sekondar). Në zonën e Jalës, Qeparosë dhe Borshit, nuk kryhet trajtim i ujërave të ndotura urbane. Grupi i auditimit gjatë verifikimeve në terren (korrik 2024), konstatoi në plazhin e Borshit shkarkimet në det të ujërave potencialisht të ndotura.

Harta nr. 4 Vendndodhja[75] e shkarkimeve në plazhin e Borshit

Burimi: Grupi i auditimit

Foto nr. 5 Shkarkimi i ujërave të ndotura në det, Borsh[76]

Burimi: Grupi i auditimit, Korrik 2024

Bashkitë Fier, Lushnje dhe Rrogozhinë nuk kanë impiante për trajtimin e ujërave të ndotura urbane.

Një problematikë tjetër e konstatuar gjatë auditimit është se disa bashki, si Rrogozhina, Lushnja dhe Fieri, nuk kanë impiante të trajtimit të ujërave të ndotura, fakt i cili sjell rrezik të madh për shkarkimin në dete të ujërave të ndotura urbane të pa trajtuara.

Në qytetin e Fierit, të gjitha ujërat e zeza të qytetit mblidhen nga kanalizimi dhe derdhen në një kanal të quajtur "Vija e Ngjalës". Kjo pikë shkarkimi derdhet në plazhin e Semanit.

[75]Akt Verifikimi i mbajtur më datë 09.07.2024 protokolluar në SHRUK Vlorë me nr. 01/11 me koordinata gjeografike Koordinata: 40°03'00.8"N 19°50'21.6"E

[76] Koordinata: 40°03'00.8"N 19°50'21.6"E

Harta nr. 5 Pika e shkarkimit[77] të ujërave të ndotura urbane në plazhin e Semanit



Burimi: Grupi i auditimit

Foto nr. Vija e ngjalës ku shkarkohen ujërat e ndotura.

Burimi: Grupi i auditimit, Korrik 2024

Gjithashtu edhe qyteti i Lushnjës nuk ka një impiant trajtimi të ujërave të ndotura. Qyteti ka kanalizime dhe kanale kulluese (ujërat e bardha) të cilat derdhen në pjesë të ndryshme të grumbullueseve që më pas derdhen në kanalin e "Perrio" që përshkon qytetin, dhe në fund përfundojnë në Seman.

[77] Akt Verifikimi i mbajtur më datë 10.07.2024 me specialistin e SHRUK Fier me koordinata gjeografike 40.75524° N, 19.37115° E

Ujërat kimikë, industrialë, bujqësorë, etj, bëhen problem për funksionimin normal të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane, duke qenë se këto impiante nuk janë projektuar për trajtimin e këtyre ujërave, por vetëm për trajtimin e ujërave të ndotura urbane.

Impiantet e përshkruara më sipër janë teknologji të projektuara për të përpunuar dhe trajtuar ujërat e ndotura urbane (ujërat e zeza), ndërkohë që në këto impiante përfundojnë edhe ujëra nga aktivitete industriale, bujqësore, blegtorale etj. Kjo gjë ndodh sepse këto aktivitete shkarkojnë direkt në rrjetin e kanalizimeve (urbane) pa trajtuar më parë këto ujëra. Këto ujëra industriale, bujqësore, me kimikate të ndryshme, etj., kthehen në problematikë për funksionimin normal të ITUN-eve duke çuar në bllokimin dhe funksionimin normal të tyre dhe rrjedhimisht në amortizimin e tyre.

Referuar shkresave zyrtare nga Drejtoria e Trajtimit të Ujërave të Ndotura në UK-Durrës, për periudhën Shkurt-Maj 2023, evidentohet një situatë problematike në impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura. Sipas këtyre komunikimeve më 28 mars 2023 dhe më pas në datat 3 maj 2023 është njoftuar Administratori i UK-Durrës për shkarkimet që kanë tejkaluar normat e lejuara të ujërave të ndotura. Më datë 11-13 shkurt 2023 është konstatuar se në hyrje të ITUN Vrrin në Durrës ka pasur prurje anormale të ujërave të ndotura. Uji ka pasur një aromë të papërshtatshme dhe të ndryshme nga ajo që është karakteristike për ujërat e zeza. Laboratori ka pasur vështirësi në përcaktimin e llojit të ujërave që kanë hyrë në impiant, por dy parametra të rëndësishëm si azoti dhe amoniaku kanë kaluar normat e lejuara. Azoti ka shënuar vlera nga 41 mg/l deri në 43 mg/l, kur norma e lejuar është jo më e lartë se 40 mg/l, ndërsa amoniaku ka pasur vlera nga 39.1 mg/l deri në 41 mg/l, kur norma është 38.5 mg/l. Ky është një tregues se ujërat që kanë hyrë në impiant janë ujëra industriale, të cilat nuk përmbushin kriteret për t'u trajtuar në ITUN. Situata është përsëritur edhe në muajt pasardhës, me shkarkime anormale të ujërave industriale që kanë vazhduar të tejkalojnë kapacitetet e impiantit. Më 14 qershor dhe 25 korrik 2023, janë konstatuar po ashtu prurje të ujërave të ndotura me parametra të lartë të azotit dhe amoniakut, duke ngarkuar impiantin mbi kapacitetin e tij.[78]

Për sa më sipër, si dhe nga verifikimet e takimet e grupit të auditimit me strukturat e UK Durrës, rezultoi se ITUN Vrrin (Durrës) ka pasur vështirësi në trajtimin e ujërave industriale që janë derdhur në rrjetin e kanalizimeve. Ujërat e ndotura industriale kanë tejkaluar kapacitetin e mundshëm të impiantit, duke shkaktuar një ngarkesë të paplanifikuar dhe duke rritur rrezikun për mjedisin dhe shëndetin publik. Kjo situatë tregon se në këtë impiant përveç prurjeve të ujërave të ndotura urbane vijnë dhe ujëra industriale duke ngarkuar punën e impiantit mbi kapacitetin e mundshëm të tij. Edhe nga verifikimet në terren dhe takimet e grupit te auditimit me subjektin UK Durrës, u konfirmua se ka prurje të ujërave të cilat janë industrial dhe për të cilat impianti nuk ka kapacitet për ti trajtuar.

9. Gjetje nga auditimi: Të dhënat e paraqitura nga AKUK dhe Shoqëritë Rajonale të Ujësjellës Kanalizimeve Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë dhe ato të deklaruara në lejet mjedisore mbi kapacitetet e ITUN-eve si dhe sasinë e trajtimit të tyre nuk përputhen me njëra-tjetrën. Grupit të auditimit nuk i janë vendosur në dispozicion dokumente lidhur me projektimin e këtyre impianteve me qëllim saktësimin e kapaciteteve të tyre. Ndërsa sa i përket trajtimit aktual nga këto ITUN-e, të dhënat janë të përafërta duke qenë se mungojnë pajisje specifike (flaumetri) që përllogarisin sasinë e trajtuar të ujërave të ndotura urbane. Ky fakt tregon edhe për një mungesë bashkëpunimi dhe rakordimi ndërmjet institucioneve. Mungesa e të dhënave të tilla cenon planifikimin e saktë në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës së këtyre impianteve si dhe

[78] Shkresa zyrtare e Drejtorisë së Trajtimit të Ujërave të Ndotura, UK-Durrës me nr., prot 1922, datë 28.03.2023, drejtuar Administratorit të UK Durrës dhe Drejtorit të Drejtorisë së Trajtimit të Ujërave të Ndotura me lëndë "Raport mbi shkarkimet mbi normë të ujërave të ndotura në ITUND, Shkurt 2023".

ndjekjen dhe realizimin e objektivit "Rritja e aksesit të popullsisë me trajtim të ujërave të ndotura" të SKSFUK-së.

10. Gjetje nga auditimi. Kuadri ligjor në Shqipëri përcakton Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve së bashku me Shoqëritë Rajonale të Ujësjellës Kanalizimeve si përgjegjës për largimin dhe trajtimin sekondar të ujërave të ndotura urbane. Nga auditimi ka rezultuar se në bashkitë subjekt auditimi nuk kryhet i plotë trajtimi i ujërave të ndotura urbane. Konkretisht, trajtimi sekondar në Bashkinë Durrës kryhet për rreth 75 % të popullsisë, në Bashkinë Lezhë për rreth 19 % të popullsisë, në Bashkinë Shkodër për rreth 4.8 % të popullsisë, ndërsa në bashkitë e tjera mungon totalisht trajtimi i ujërave të ndotura urbane për popullsinë rezidente. Ujërat e ndotura urbane të pa trajtuara të bashkive Kavajë, Rrogozhinë, Lushnje, Fier, Vlorë dhe Himarë, të cilat nuk kanë impiante trajtimi (sekondarë) shkarkohen drejtpërsëdrejti në det duke ndikuar direkt në përkeqësimin e cilësisë së ujërave të larjes.

11. Gjetje nga auditimi: ITUN-et janë projektuar për të trajtuar vetëm ujërat e ndotura urbane (ujërat e zeza). Nga auditimi ka rezultuar se në këto impiante shkarkohen nëpërmjet rrjetit të kanalizimeve edhe ujëra nga aktivitete industriale, bujqësore, blegtorale etj. Aktivitete të tilla nuk duhet të shkarkojnë ujërat e tyre të ndotura në rrjetin qendror të kanalizimeve pa i trajtuar ato më parë me anë të impianteve individuale. Shkarkimi i ujërave të ndotura të pa trajtuara nga aktivitete industriale, bujqësore, blegtorale etj., direkt në ITUN-e ndikon në funksionimin normal të tyre duke i amortizuar më shpejt ose edhe duke i nxjerrë jashtë funksionit.

Konkluzioni 4: Aktualisht, impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura në bashkitë subjekt auditimi nuk arrijnë të mbulojnë trajtimin e ujërave të ndotura urbane të gjeneruara nga popullsia e këtyre bashkive. Krahas bashkive që nuk kanë fare impiant trajtimit të ujërave të ndotura, edhe në bashkitë e tjera nevojiten përmirësime në drejtim të rritjes së kapacitetit trajtues të impianteve, si dhe mos shkarkimin e ujërave të ndotura jo urbane.

9.1 Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve në bashkëpunim me Shoqëritë Rajonale të Ujësjellës Kanalizimeve Shkodër, Lezhë, Durrës e Vlorë të marrin masa të saktësojnë dhe përditësojnë të dhënat mbi kapacitetet e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane, si dhe të evidentojnë periodikisht mbulimin e popullsisë me shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura me qëllim arritjen e objektivit "Rritja e aksesit të popullsisë me trajtim të ujërave të ndotura" të SKSFUK-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.1 Rekomandim: Shoqëritë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë të kërkojnë nga AKM dhe IKMT (në cilësinë e strukturave inspektuese në çështjet e mjedisit dhe ujërave) identifikimin dhe ndalimin e aktiviteteve industriale, bujqësore, blegtorale etj., të cilat shkarkojnë ujëra të pa trajtuara në sistemin e kanalizimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.2.2 A janë planifikuar dhe realizuar projekte dhe investime lidhur me trajtimin e ujërave të ndotura urbane në bashkitë subjekt auditimi?

Në projektin DSIP "Mbështetje për Planifikimin e Investimeve dhe Negociatave për Ujin" parashikohen rreth 4 miliardë euro për të arritur përputhshmërinë me Direktivën 91/271 të Këshillit të Komunitetit Evropian "Për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane"

Në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian (BE) për kushtet e anëtarësimit në BE, ku Planet e Zbatimit Specifik të Direktivave (DSIP-ve) përbëjnë një nëngrup të rëndësishëm të marrëveshjeve që Shqipëria do të vendosë, në vitin 2022 është zhvilluar Projekti "Negociatat e Ujit dhe Mbështetja e Planifikimit të Investimeve", financuar nga SIDA (Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar), përfitues Agjencia Kombëtare e Ujësjellës

Kanalizimeve. Në kuadër të zbatimit të projektit Water NIPS të financuar nga Qeveria Suedeze nëpërmjet SIDA, është përgatitur Dokumenti Strategjik i "Planit Specifik për zbatimin e Direktivës së Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane (91/271/EEC)", në vijim (UWWT DSIP), për të identifikuar masat e nevojshme ligjore, institucionale dhe teknike, për të siguruar përputhshmërinë me Direktivën 91/271/EEC. Objektivi specifik i projektit të mësipërm është të ofrojë një propozim për DSIP e Direktivës 91/271/EEC në lidhje me trajtimin e ujërave të ndotura urbane, në mënyrë që t'i mundësojë autoriteteve shqiptare të identifikojnë masat ligjore, institucionale dhe teknike për të siguruar përputhjen me Direktivën. Kërkesa kryesore është që të gjitha qendrat e banuara me një ngarkesë të ujërave të ndotur mbi 2,000 PE [79]të pajisen me një sistem grumbullimi të ujërave të ndotur dhe me një impiant për trajtimin e ujërave të ndotur (ITUN).[80]

Sipas Raportit, në Shqipëri janë identifikuar 165 qendra të banuara në të cilat aktualisht jetojnë rreth dy të tretat e popullsisë (2.1 milionë). Ngarkesa totale e gjeneruar e ujërave të ndotur prej rreth 3.5 milion PE në 2020 parashikohet të rritet në 3.7 milion PE në 2050.**[81]**

Ngarkesa e ujërave të ndotur sipas kategorisë së madhësisë së ngarkesës (në PE) përmblidhet si më poshtë:

• Tetë (8) qendra te banuara (5 %) kanë një ngarkesë maksimale në periudhën e projektimit mbi 100,000 PE (Tiranë, Durrës, Vlorë, Kavajë, Shkodër, Sarandë, Elbasan dhe Velipojë), me një ngarkesë totale prej 2.6 milionë PE,

• Në kategorinë tjetër ndërmjet 10,000 dhe 100,000 PE ka 26 qendra te banuara (16 %) që korrespondon me 68 % e ngarkesës totale të ujërave të ndotur në vend gjenerojnë një ngarkesë prej rreth 0.8 milion PE (20 % e ngarkesës totale).

• Në kategorinë midis 2,000 dhe 10,000 PE ka 94 qendra te banuara (57 %) që gjenerojnë një ngarkesë prej rreth 0.38 milion PE (10 %).

Së fundi, në kategorinë nën 2,000 PE ka 37 qendra te banuara (23 %) që gjenerojnë një ngarkesë prej rreth 0.05 milion PE (1 %).

Sipas vlerësimit të kostove të investimeve në infrastrukturën e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur, nga raporti rezultojnë investime totale të vlerësuara kapitale të kërkuara për të arritur përputhshmërinë me DTUZU [82] janë vlerësuar në 1.868 miliardë euro (neto) dhe 2.335 miliardë euro duke përfshirë kostot Inxhinierike dhe të Paparashikuara.

Nga investimi i përgjithshëm kapital (grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të ndotur):

- rreth 77 % e investimeve kanë të bëjnë me zgjerimin ose investime të reja;
- rreth 23 % i referohen rehabilitimit të infrastrukturës ekzistuese;
- Sigurimi i pajisjeve laboratorike për monitorim paraqet një pjesë të papërfillshme të investimit të përgjithshëm kapital të vlerësuar (0.1%).

DTUZU është një nga direktivat e BE-së e cila kërkon më shumë investime.[83] Për rrjedhojë, programimi i investimeve, planifikimi financiar dhe aftësia e menaxhimit të programit janë kërkesat kryesore në përmbushjen e angazhimeve të pajtueshmërisë. Për këtë arsye nevojiten investime financiarisht të qëndrueshme dhe disponueshmëri fondesh. Në kushtet e situatës së vështirë financiare të sistemit të Ujësjellës Kanalizimeve, është pothuajse e pamundur të ketë një menaxhim të mirë të fondeve për zbatimin e programeve të investimeve të mëdha kapitale.

---

[79] Kapaciteti i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura përcaktohet në bazë të ngarkesës së ndotjes që trajton dhe shprehet në PE ose "NJP, njëvlerës për popullsinë". 1 PE = 200 litra ujë i ndotur urban në ditë ose 1 PE = 1 person.
Udhëzim i Përbashkët(MIE dhe MTM) Nr. 1, datë 1.2.2024, neni 10.

[80] Raporti Plani Specifik i Zbatimit të Direktivës (PSZD) për Direktivën e Këshillit të datës 21 maj 1991 në lidhje me Trajtimin e Ujërave të Ndotur Urban (91/271/KEE).

[81] Rritja e ngarkesës nga viti 2020 në 2050, pavarësisht nga zvogëlimi i popullsisë, shpjegohet me supozimin se ngarkesa e ujërave të ndotur turistike parashikohet të rritet me 32 % (0.35 milion PE) midis 2020 dhe 2050.

[82] Dispozita e Trajtimit të Ujërave të Ndotur Urbane, fq. 10 Raporti Plani Specifik i Zbatimit të Direktivës (PSZD) për Direktivën e Këshillit të datës 21 maj 1991 në lidhje me Trajtimin e Ujërave të Ndotur Urban (91/271/KEE)

[83] Raporti Plani Specifik i Zbatimit të Direktivës (PSZD) për Direktivën e Këshillit të datës 21 maj 1991 në lidhje me Trajtimin e Ujërave të Ndotur Urban (91/271/KEE)

Raporti DSIP, përshkruan situatën aktuale në sektorin e ujërave të ndotur në Shqipëri, identifikon boshllëqet ligjore, institucionale dhe teknike, specifikon zbatimin e masave, bën vlerësimin e kostos dhe identifikon burimet e mundshme financiare për të mbyllur boshllëqet, si dhe paraqet rekomandime për planin e investimeve dhe periudhën e tranzicionit për zbatimin e Direktivës.
Plani Specifik i Zbatimit të Direktivës (PSZD) për Direktivën e Këshillit të datës 21 maj 1991 në lidhje me Trajtimin e Ujërave të Ndotur Urban (91/271/KEE), *i vitit 2022, i paraprin hartimit të Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë e Kanalizime (SKSFUK) 2023-2030*, e cila është miratuar me Vendimin 448, datë 26.07.2023.

Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime (SKSFUK) 2023–2030

SKSFUK 2023-2030 ka si mision garantimin e ofrimit të një shërbimi gjithëpërfshirës, të qëndrueshëm dhe cilësor në furnizimin me ujë, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotur me tarifa të përballueshme në respektim të shëndetit publik, mirëqenies, mjedisit dhe në përmbushje të angazhimeve të marra për përmbushjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Qeveria shqiptare, në kuadër të mbrojtjes së mjedisit, zhvillimit të turizmit dhe procesit të integrimit në Bashkimin Evropian, ka në prioritetet e saj dhe ndërtimin e infrastrukturës të trajtimit të ujërave të ndotura urbane, ku fokus të veçantë janë zonat turistike. Referuar të dhënave nga AKUK-i, aktualisht janë ndërtuar dhe janë në funksionim 12 impiante në zonat urbane dhe turistike për gjithë territorin, si dhe janë në proces ndërtimi 3 impiante të reja. Gjithashtu, janë planifikuar për t'u ndërtuar 2 impiante në zona urbane me potencial të lartë zhvillimi turistik.
Qeverisja qendrore është përgjegjëse për përcaktimin e vizionit strategjik të sektorit dhe hartimin dhe monitorimin e kuadrit rregullator mbi të cilin mbështetet gjithë sektori, ndërsa qeverisja vendore është përgjegjëse për ofrimin e këtij shërbimi.[84]
Në SKFSUK 2023-2030 është përcaktuar kuadri institucional përgjegjës për të organizuar dhe për të rregulluar shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri, sipas të cilit institucionet e përfshira janë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Operatorët e shërbimit Shoqëritë UK.

AKUK nuk ka hartuar planin e detajuar të zbatimit të objektivit specifik 2.2 të SKSFUK 2023-2030.

Objektivat kryesorë të synuar të SKFSUK-së 2023-2030 janë bazuar në përmbushje të OZHQ nr. 6 dhe kanë si synim që deri në vitin 2030 të arrihet akses në kanalizime dhe higjienë të përshtatshme. Për përmbushjen e objektivave të SKFSUK-së janë përcaktuar "6 Qëllime të Politikës" të cilat janë specifike, të matshme dhe me afate kohore të përcaktuara. Qëllimi i Politikës 2 (i cili është objekt i këtij auditimi) është zgjerimi dhe përmirësimi i aksesit në sistemet për grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura për popullsinë. Referuar Strategjisë, Politika 2 është përkthyer në masa prioritare, të cilat zbërthehen në Planin e Veprimit. Njëra nga masat prioritare për arritjen e objektivit të Politikës 2 është "Rritja e aksesit të popullsisë së lidhur me një ITUN" dhe rezultatet e parashikuara në të janë si më poshtë:

- Mbulimi i 16.5 % të popullsisë me sistemin e trajtimit të ujërave të ndotura deri në 2025:
- Mbulimi i 26 % të popullsisë me sistemin e trajtimit të ujërave të ndotura deri në 2030.

Treguesit e parashikuar për këtë masë prioritare janë elementët kryesorë për të monitoruar, vlerësuar dhe raportuar progresin në zbatimin e Strategjisë në termat kohore 2023-2025 dhe 2026-2030.[85] Pra çdo objektiv strategjik detajohet në masa prioritare dhe për çdo masë prioriate përcaktohen planet e veprimit. Institucioni përgjegjës (udhëheqës) për realizimin e objektivit 2

[84] Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2023–2030, 2.3 Kuadri Institucional.
[85] Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2023–2030, Qëllimet e politikës dhe rezultatet.

të Qëllimit të Politikës nr. 2 është AKUK, ndërsa institucione kontribuese janë Shoqëritë Rajonale UK, Bashkitë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH).
Sipas SKSFUK-së 2023-2030, AKUK në cilësinë e Institucionit Përgjegjës kryesor duhet të hartojë një plan zbatimi të detajuar për secilën prej Masave Prioritare të përcaktuara, ku do të përshkruhet në mënyrë të plotë si do të realizohet arritja e rezultateve të parashikuar. Këto plane duhet të përpunohen brenda tre muajve pas miratimit të këtij dokumenti dhe do të konsultohen në vijim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Në përgjigje të kërkesës të grupit të auditimit nëse është hartuar plani i detajuar për objektivin specifik 2.2.1 *Impiante të trajtimit të ujërave të ndotur për aglomerime > se 2000 pe,* AKUK referon përsëri UËËT DSIP,[86] duke lënë të kuptohet se nuk janë hartuar plane zbatimi të detajuara sikundër përcaktohet në SKSFUK 2023-2030.

Kostot indikative të Planit të Veprimit të SKFSUK 2023-2030 nuk janë mbështetur në burime të qëndrueshme financimi.
Kostot indikative për arritjen e objektivave të Planit të Veprimit mund të financohen përmes tarifave, taksave dhe transfertave.
• *Taksat:* fonde të mbledhura nga taksat kombëtare (buxheti i shtetit) që përdoren për të financuar sektorin UK. Për shkak të kufizimeve domethënëse fiskale, fondet e disponueshme që vijnë nga taksat për të financuar sektorin UK janë gjithnjë e më të reduktuara.
• *Tarifat:* tarifat e konsumatorit ose pagesat (shërbimi i furnizimit me ujë - tarifa për lidhje dhe shërbimin e ofruar – tarifa aforfe / volumetrike) përdoren për të financuar sektorin UK. Ky është burimi më i qëndrueshëm i financimit të sektorit. Megjithatë, duhet të merren në konsideratë çështja e përballueshmërisë dhe përqasja politike e tarifave.
• *Transfertat:* grantet nga burime të huaja, asistenca teknike për zhvillim mund të sigurojnë fonde për sektorin e UK-së. Kryesisht këto transferta bëhen përmes programeve dypalëshe dhe përmes Instrumentit të Bashkimit Evropian për Programin e Para-aderimit II (IPA II). Transferta të tilla mund të financojnë një pjesë të shpenzimeve kapitale, por nuk mund të përdoren për të financuar shpenzimet operacionale. *Vlen të theksohet se kreditë shërbejnë vetëm për të zhvendosur pagesat e parave në kohë. Përfundimisht kreditë duhet të paguhen nga taksat ose tarifat. Kreditë nuk përbëjnë një burim përfundimtar financimi, por janë më tepër një marrëveshje për të shtyrë pagesat nga taksat ose tarifat.*[87]
Objektivi 2.2.1 i strategjisë parashikon ndërhyrjet në gjithë territorin për impiante të trajtimit të ujërave të ndotur më të mëdha se 2000pe.
Më poshtë është paraqitur kostimi dhe burimi i mbulimit të financimit për objektivin specifik "2.2.1 Impiante të trajtimit të ujërave të ndotur për aglomerime > se 2000 pe".

Tabela nr. 10 Mbulimi në % i kostove indikative të objektivit specifik 2.2.1

Emertimi	Kosto indikative Objektivi specifik 2.2.1	Buxheti shtetit	Financime te huaja	Hendeku financiar
Kosto korrente	956,947,143	206,435,722	324,994,580	425,516,841
Kosto kapitale	15,988,962,863	1,857,921,500	2,924,951,220	11,206,090,143
Total Kosto	16,945,910,006	2,064,357,222	3,249,945,800	11,631,606,984
Mbulimi ne %		12	19	69

Burimi: SKSFUK 2023-2030, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

[86] "Dokumenti bashkangjitur DSIP është plani i detajuar që përfshin të gjitha nevojat për objektivin specifik *2.2.1 Impiante të trajtimit të ujërave të ndotur për aglomerime > se 2000 pe"*- Përgjigje AKUK, për Pyetësorin e fazës së terrenit, email-i i datës 02.04.2025
[87] Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2023–2030, 5.5 Burimi i Financimit.

Sikundër shihet Kosto totale e objektivit specifik 2.2.1 "Impiante të trajtimit të ujërave të ndotur për aglomerime > se 2000 pe" është 16,945,911,006 lekë.
Total i kostos korrente në vlerën 956,948,143 lekë do të mbulohet nga:

- Buxheti i shtetit PBA 2023-2025 në vlerën prej 206,453,722 lekë;
- Financime të huaja PBA 2023-2025 në vlerën prej 324,994,580 lekë;
- Hendeku financiar pa zbritur tavanet buxhetore 2026-2030 në vlerën prej 425,516,841 lekë.

Total Kosto kapitale në vlerën 15,988,962,863 lekë do të mbulohet:

- Buxheti i shtetit PBA 2023-2025 në vlerën prej 1,857,921,500 lekë;
- Financime të huaja PBA 2023-2025 në vlerën prej 2,924,951,220 lekë.
- Hendeku financiar pa zbritur tavanet buxhetore 2026-2030 në vlerën prej 11,206,090,143 lekë.

Hendeku financiar (në Lekë) pa zbritur tavanet buxhetore 2026-2030 në total për këtë nën objektiv të Strategjisë është në vlerën 11,631,606,984 lekë.

Në aneksin 3 formati i planit të veprimit të kostuar dhe detajuar, Qëllimi i Politikës II: Zgjerimi dhe përmirësimi i aksesit në sistemet për grumbullimin, largimin dhe përmirësimi i aksesit në sistemet për grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura për popullsinë, janë detajuar për secilin nën objektiv kostot indikative dhe burimet e mbulimit të tyre.
Kostot indikative për arritjen e objektivit specifik 2.2.1 "Impiante të trajtimit të ujërave të ndotur për aglomerate > se 2000 pe", janë parashikuar të mbulohen në masën 12% nga Buxheti i shtetit, 19% nga Financimet e huaja dhe 69% është hendeku financiar.
Referuar Strategjisë, buxheti i Shtetit (në Lekë) PBA 2023-2025 dhe Financim i Huaj (ne Lekë) PBA 2023-2025 parashikon 0 lekë për nën objektivat e mëposhtëm:

- 2.2.1.1 Vlerësimi i gjendjes aktuale të sistemeve të grumbullimit e trajtimit të ujërave të ndotura si dhe adresimi i nevojave për zgjerim dhe/ose për nivele më të avancuara trajtimi me kosto indikative prej 75.000.000 lekë.
- 2.2.1.2 Përcaktimi i nevojave për kolektorë/stacione pompimi shtesë me kosto indikative prej 37.500.000 lekë.
- 2.2.1.3 Përgatitja e inventarit të qendrave të banuara me më shumë se 1000 p.e. si bazë për identifikimin dhe përzgjedhjen e aglomerateve me kosto indikative prej 22.500.000 lekë.
- 2.2.1.4 Përgatitja e një liste të të gjitha industrive që prodhojnë ujëra të ndotur të biodegradueshëm me ngarkesë ≥ 4,000 p. me kosto indikative prej 22.500.000 lekë.

Parashikohen fonde vetëm për nën objektivin e mëposhtëm:
2.2.1.5 Projektimi, Zbatimi dhe Mbikëqyrja e Projekteve të Infrastrukturës për rritjen e mbulimit me impiante trajtimi të ujërave të ndotur.
Gjatë periudhës së auditimit është pyetur AKUK mbi burimet e financimit për arritjen e objektivit specifik 2.2.1*1 Impiante të trajtimit të ujërave të ndotur për aglomerime > se 2000 pe. Sipas AKUK "*Identifikimi i burimeve të financimit është pjesë e procesit të negociatave dhe në të ardhmen planifikimi i nevojave të investimeve për sektorin e ujësjellës kanalizimeve si pjesë e Kapitullit 27 Mjedisi do të jetë pjesë e kërkesave për financim që do të koordinohen në nivel kombëtar së bashku me kapitujt e tjerë. Referuar edhe eksperiencave të vendeve të tjera që janë bërë pjesë e BE pas anëtarësimit, do te rritet aksesi për fondet strukturore të BE. Sipas AKUK, si konkluzion burimi kryesor i financimit për të mbuluar nevojat e larta në sektorin UK do të jenë fondet e BE por pa lënë mënjanë edhe fondet e Qeverisë Shqiptare."[88]

[88] Përgjigje AKUK, për Pyetësorin e fazës së terrenit, email-i i datës 02.04.2025

Zbatimi i Planit të Veprimit të SKFSUK 2023-2030 nuk është raportuar dhe monitoruar.
Monitorimi luan një rol kyç në vlerësimin dhe raportimin e progresit në zbatimin e një strategjie. Për më tepër, ai u ofron palëve të interesuara, në të gjitha nivelet, informacion kyç në lidhje me përparimin e zbatimit dhe sfidat e mundshme, duke bërë të mundur ndërmarrjen e veprime korrigjuese sa herë që është e nevojshme.
Procesi i monitorimit të Strategjisë duhet të jetë i vazhdueshëm, i qëndrueshëm, i fokusuar dhe i disiplinuar. Qëllimi përfundimtar i procesit të monitorimit dhe raportimit të Strategjisë është që të sigurohet se zbatimi i Strategjisë dhe përmirësimet e arritura janë realizuar në mënyrë efektive. Gjithashtu monitorimi shërben edhe për të identifikuar dhe më pas reflektuar deviacionet e mundshme. Analiza e progresit dhe propozimi i veprimeve korrigjuese përgatiten nga AKUK në cilësinë e institucionit përgjegjës kryesor dhe më pas rishikohet dhe vlerësohet me MIE.
Në fund të çdo viti MIE do të konsolidojë raportin e bërë nga institucionet përgjegjëse për të zhvilluar një dokument operacionale. Ky dokument do të shërbejë në vlerësimin e efektivitetit të planeve të veprimit për arritjen e rezultateve të parashikuara dhe do të përdoret për të hartuar çdo vit një version të përditësuar të SK.[89]

Në kuadër të nismës së qeverisë shqiptare për reformimin e sektorit, AKUK-ja është aktori përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e reformës sektoriale. Procesi i rajonalizmit të shoqërive UK kërkon angazhim të konsiderueshëm të të gjithë strukturave aktuale të AKUK-së, por edhe të strukturave të reja qeveritare.
Referuar zhvillimeve të fundit në sektor, AKUK-ja është pjesë integrale aktive e subjektit të kompetencave të përbashkëta dhe ka rolin kryesor për të planifikuar dhe për të zbatuar siç duhet procesin e agregimit në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët e tjerë kryesorë pjesëmarrës në këtë proces.[90]

Lidhur me ecurinë e monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2023-2030, i jemi drejtuar MIE dhe AKUK. Sipas MIE, përgjegjësia për monitorimin e SKSFUK 2023-2030 është e AKUK. Në përgjigjen e pyetësorit drejtuar MIE citohet:" "jemi në pritje të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve, bazuar në pikën 13.C, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 617, datë 01.11.2023, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 431, datë 11.07.2018, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve", Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve ka në Strukturën dhe Organigramën e miratuar drejtoritë përgjegjëse për koordinimin dhe analizën e informacionit, monitorimit dhe mbikëqyrjes, etj."[91]
Vendimi Nr. 448, datë 26.7.2023 për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023–2030, pika 3 shprehet qartë: Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kësaj strategjie, në bashkëpunim me institucionet e përcaktuara në planet e veprimit të saj.
Gjatë periudhës së auditimit është pyetur AKUK lidhur me dërgimin të MIE dhe vënien në dispozicion të grupit të auditimit të raportit mbi ecurinë e zbatimit të planit të veprimit për vitin 2024. Në përgjigjen e tij AKUK citon se raporton rregullisht tek MIE mbi ecurinë e institucionit dhe veçanërisht planit të investimeve por pa vënë në dispozicion raportin e dërguar për vitin 2024.[92]
Gjithashtu në lidhje me monitorimin e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023–2030 AKUK shprehet se nuk është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të SKSFUK.[93]

[89] Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2023–2030, 4.3 Përditësimi i Strategjisë.
[90] Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2023–2030, fq. 8.
[91] Përgjigje MIE datë 20.12.2024 mbi Pyetësorin.
[92] Përgjigje AKUK, për Pyetësorin e fazës së terrenit, email-i i datës 02.04.2025
[93] Përgjigje AKUK, pyetësori i fazës terrenit, email-i i dt. 01.04.2025

Sponsorizimi Sektorial është një tregues i situatës jo të qëndrueshme financiare të Shoqërive Rajonale të Ujësjellës Kanalizimeve.

Udhëzimi Nr. 8, datë 11.10.2024, "Për miratimin e metodologjisë, kritereve dhe procedurat, për vlerësimin dhe prioritizimin e fondeve buxhetore të investimeve publike, për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve", përcakton kriteret teknike që duhet të përmbushin projektet.

Këshilli Teknik i AKUK merr në shqyrtim projektet teknike sipas planit të investimeve vjetore apo PBA-së. Planifikimi i investimeve synon kryesisht zona me prioritet dhe potencial turistik që ndikojnë direkt në zhvillimin e ekonomisë si dhe zona urbane të ndërtuara rishtazi, ku nuk ekziston rrjet kanalizimesh. Prioritet kanë edhe zona të caktuara ku ka amortizim të rrjeteve ekzistuese si dhe zona ku nevojitet rrjet i ri si pasojë e rritjes së dendësisë së banorëve.[94]

AKUK projekton, ndërton dhe administron një sistem të integruar informacioni për planifikimin e investimeve që bën secila shoqëri UK, si edhe kërkesat për financime.[95] Për periudhën 2019-2024, numri i aplikimeve për projekte ITUN nga shoqëritë UK, subjekt auditimi paraqitet si më poshtë:

Tab. nr 11 Aplikimet për projekte grumbullim/trajtim ujëra të ndotura nga SHRUK-të, 2019-2024.

		2019		2020		2021		2022		2023		2024		Total aplikime 2019-2024	Total i miratuar 2019-2024
		A	M	A	M	A	M	A	M	A	M	A	M		
1	Himare	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	**1**	**1**
2	Vlore	1	1	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	**2**	**2**
3	Fier	0	0	0	0	1	1	1	1	0	0	0	1	**2**	**3**
4	Lushnje	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	**1**	**0**
5	Durres	0	0	1	0	0	1	1	1	0	0	1	2	**3**	**4**
6	Lezhe	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	**0**	**0**
7	Shkoder	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	**0**	**0**
8	Rrogozhine	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	**1**	**1**
9	Kavaje	1	1	1	1	1	0	0	0	0	0	0	0	**3**	**2**
	Totali	**4**	**3**	**4**	**3**	**2**	**2**	**2**	**2**	**0**	**0**	**1**	**3**	**13**	**13**

Burimi: AKUK, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Siç shihet nga të dhënat e mësipërme numri i aplikimeve nga 9 SHRUK subjekt auditimi, për periudhën 2019-2024 është shumë i ulët. Në total përgjatë periudhës 2019-2024 janë aplikuar 13 projekte për ITUN dhe janë miratuar 13.

Gjatë vitit 2023, sektori i ujësjellës-kanalizimeve është karakterizuar nga ndryshime thelbësore sa i përket riorganizimit dhe operimit të tij, në vijim të VKM-së nr. 302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të FU dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i cili në përfundim agregon sektorin UK në 15 shoqëri UK rajonale si Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta nga 58 shoqëri UK që ofronin më parë shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime në 61 bashki të vendit. Objektivi kryesor i reformës është që nëpërmjet ekonomisë së shkallës të përmirësojë cilësinë e shërbimit, të rrisë efikasitetin dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve UK.[96]

SKP-UK sh.a. të krijuara deri më sot i janë transferuar të gjitha të drejtat, detyrimet, si dhe veprimtaria ekonomike e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi

[94] Përgjigje e AKUK për pyetësorin e datës 20.01.2025.
[95] VKM nr. 617 pika 13/g
[96] Raport vjetor 2023 ERRU

të njësive të vetëqeverisjes vendore në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për transferimin e aktivitetit të shoqërive ekzistuese te sh.a. [97]

Ndërkohë situata financiare e SHRUK-ve paraqitet e dobët edhe pas reformës për riorganizimin e sektorit të FU dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura.
Shumica e shoqërive UK nuk janë në gjendje të mbulojnë kostot totale të operimit, për shkak të kombinimit të disa faktorëve, si tarifa të ulëta shërbimi, nivel i ulët të arkëtimeve dhe niveleve të larta të ujit pa të ardhura.
Referuar vlerës totale të subvencioneve që ju jepen Shoqërive UK nga Buxheti i Shtetit, për vitin 2023 në nivel kombëtar, rezulton se 90.8% e subvencioneve janë shpërndarë për kostot e energjisë elektrike, 4.6% janë shpërndarë për sigurime shoqërore dhe shëndetësore të papaguara, 4.5% janë shpërndarë për paga të papaguara dhe 0.1% për tatime e taksa të papaguara.
AKUK është institucioni përgjegjës për përgatitjen e metodologjisë dhe realizimin e shpërndarjes së subvencioneve të planifikuara në buxhetin e shtetit në sektorin e UK-së.[98]
Përgjatë periudhës 2019-2024 shpërndarja e subvencioneve në Shoqëritë UK, subjekt auditimi paraqitet si më poshtë.

Tabela nr. 12 Shpërndarja e subvencioneve për periudhën 2019-2024

		2019	2020	2021	2022	2023	2024
Nr	**Emërtimi**	**Totali në lekë 2019**	**Totali në lekë 2020**	**Totali në lekë 2021**	**Totali në lekë 2022**	**Drejtori Rajonale Totali në lekë**	**Drejtori Rajonale Totali në lekë**
1	Shkodër UK Sh. A	29,615,709	82,749,042	4,228,000	0	30,000,000	61,208,055
2	Lezhe UK Sh. A	6,764,860	0		0	47,992,330	1,412,476
3	Kavaje UK Sh. A	36,960,211	20,357,312	17,612,000	17,814,942		
4	Rrogozhine UK Sh. A	8,091,748	8,934,473	5,449,000	4,888,216		
5	Durrës UK Sh. A	62,299,825	30,175,200	98,250,000	0	104,604,254	75,026,351
6	Fier UK Sh. A	11,964,765	0		0	28,913,516	46,701,667
7	Lushnje (Q) UK Sh. A	28,418,113	5,698,100	12,458,000	15,056,236		495,878
8	Vlore U Sh. A	98,003,552	30,849,000	52,515,000	0	30,000,000	72,142,508
9	Himare UK Sh. A	3,115,999	0		0		
	Totali	**282,118,784**	**178,763,127**	**190,512,000**	**37,759,394**	**241,510,100**	**256,986,935**

Burimi: AKUK, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Në kushtet e vështirësisë financiare që kanë SHRUK të cilat subvenciohen për mbulimin e shpenzimeve është e pamundur që këto të fundit të planifikojnë apo aplikojnë në projekte për mbulimin e territorit të tyre me ITUN. Sipas udhëzimeve të reja, vetëm shoqëritë që kanë përmbushur të paktën 50% të objektivave të performancës mund të aplikojnë për fonde nga buxheti i shtetit. Kjo do të thotë që ato që janë në vështirësi financiare dhe rrjedhimisht me performancë të dobët përjashtohen automatikisht nga mundësia për të përmirësuar situatën përmes investimeve.[99]

AKUK nuk ka planifikuar dhe investuar projekte nëpërmjet financimeve të huaja.
Njësia e Projekteve me Financim të Huaj, në bashkëpunim me donatorët ose financuesit e huaj, pranë AKUK, ka përgjegjësinë për planifikimin e buxheteve vjetore dhe afatmesme për financim të huaj.[100] Nga auditimi rezulton se nga Njësia e Projekteve me Financim të Huaj, nuk janë

[97] Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2023–2030, fq. 9.
[98] Rregullore e Brendshme AKUK neni 8, pika f.
[99] https://monitor.al/aplikimet-per-fonde-buxheti-nga-1-janari-vetem-nga-ujesjellesit-qe-realizuan-50-te-objektivave/
[100] Rregullore e Brendshme AKUK neni 17, zbatimi i projekteve.

planifikuar buxhete vjetore dhe afatmesme specifike për ITUN gjatë periudhës 2019-2024, duke krijuar një boshllëk në strukturimin financiar të projekteve të kësaj fushe.
Për vitin 2025, me financim të huaj, janë parashikuar disa projekte kyçe:

- Ndërtimi i kolektorit dhe ITUN Shkodër, me kapacitet rreth 80,000 PE;
- Ndërtimi i kolektorit dhe ITUN Berat, me kapacitet rreth 45,000 PE;
- Përmirësimi i nivelit të trajtimit primar të ITUN ekzistues Lezhë – Shëngjin.

Megjithatë, për projektet e ndërtimit të kolektorëve dhe ITUN në Shkodër dhe Berat, nuk janë hartuar projekt-preventivat[101], çka pengon përcaktimin e vlerës së investimit dhe vështirëson procesin e planifikimit të fondeve. Sipas AKUK, këto projekte do të kenë një shtrirje kohore në zbatim deri në fund të vitit 2027. Mos finalizimi i projekt-preventivave për dy nga projektet e vitit 2025, ndikon në qartësinë e nevojave financiare dhe në garancinë e një zbatimi të suksesshëm të investimeve.
Ndërkohë, për projektin e përmirësimit të trajtimit primar të ITUN ekzistues në Lezhë – Shëngjin, vlera e parashikuar e investimit është 2,401,704-euro, duke ofruar një përllogaritje më të qartë financiare për këtë investim.
Gjithashtu, për vitin 2025, Njësia e Projekteve me Financim të Huaj parashikon të përfundojë hartimin e projektit teknik për rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura në zonën qendrore të qytetit Durrës, si dhe zgjerimin e ITUN ekzistues në këtë qytet. Sipas AKUK, brenda vitit 2025 do të aplikohet për financim të investimit tek mekanizmi i financimit të Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor (WBIF).

Në periudhën afatmesme synohet të përgatiten projektet teknike dhe të aplikohet për financim të huaj për projektet:

- Zgjerimi i kapacitetit të ITUN Lezhë – Shëngjin, Sarandë – Ksamil, Vlorë;
- Rehabilitimi dhe zgjerimi i sistemit të kanalizimeve të zonave informale të Durrësit – zonat e Shkozetit 13, 14;
- Rehabilitimi dhe zgjerimi i sistemit të kanalizimeve të zonave informale të Durrësit – zonat Portoromano dhe Spitallë 15, 18.

Mungesa e planifikimit afatgjatë të fondeve për ITUN gjatë viteve 2019-2024 tregon një problematikë të theksuar në strukturimin e investimeve të sektorit. Kjo mangësi është reflektuar edhe në vitin 2025, ku për disa projekte madhore ende nuk janë hartuar projekt-preventivat për përcaktimin e vlerës së investimit.

AKUK nuk është përfshirë në projektet e zbatuara nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
AKUK është njësia ligjore, individuale dhe buxhetore nën MIE. Kjo Agjenci përfaqëson të vetmin institucion teknik të specializuar të Qeverisë në sektorin kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Detyrat dhe përgjegjësitë e saj kryesore përfshijnë analizën, identifikimin dhe hartimin e politikave, strategjive dhe planeve të veprimit për shërbimet e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Në kuadër të nismës së Qeverisë Shqiptare për Reformimin e sektorit të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura, AKUK ka autoritetin *si aktori më i rëndësishëm përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e reformës dhe strategjisë sektoriale.* Duke qenë pjesë integrale aktive e Shoqërive Rajonale të Ujësjellës-Kanalizimeve, AKUK ka rolin primar për të planifikuar dhe zbatuar siç duhet procesin e agregimit në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët kryesore pjesëmarrës në këtë proces.[102] AKUK, në bashkëpunim me SHRUK-të, si dhe me njësitë e qeverisjes vendore, ushtron autoritetin e saj ligjor për të koordinuar dhe monitoruar aktivitetet e shërbimeve në drejtim të shërbimeve të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura për të gjithë popullsinë e vendit si:
• Përgatitja e strategjive sektoriale dhe ndjekja e zbatimit të tyre;

[101] Përgjigje pyetsori AKUK dt. 06.02.2025
[102] Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2023–2030, Kuadri institucional.

• Planifikimi i buxhetit dhe financimit të sektorit në Shqipëri – nga buxheti i shtetit dhe donatorët;
• Menaxhimi dhe shpërndarja e subvencioneve nga buxheti kombëtar;
• Monitorimi i Performancës së Sektorit.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FZHSH) është një organizatë zhvillimore e themeluar në vitin 1993, për të mbështetur zhvillimin e infrastrukturës, urbanizimit, turizmit dhe ndërveprimit ndërkufitar. Nga të dhënat e burimeve të financimit dhe destinacionit të investimeve, sipas SKSFUK-së, financimi i huaj grant ka qenë i fokusuar kryesisht në drejtim të ujërave të ndotura. Gjithashtu disa projekte janë financuar edhe nga donatorë të huaj dhe kryesisht nga qeveria gjermane, të zbatuara përmes Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Grupi i auditimi i është drejtuar AKUK me kërkesë për informacion për ITUN Palasë, ITUN Dhrale dhe ITUN Himarë lidhur me:

- Vlerën e investimit;
- Origjinën e investimit, (buxheti i shtetit, vet UK rajonale apo donacione të huaja;
- Kapacitetin e impiantit, numrin e popullsisë që do të mbulojë, teknologjinë etj.

Nga përgjigjet e AKUK rezulton se ITUN Dhralë Palasë është një financim i buxhetit të shtetit me vlerë 138,305,992 lekë. Kapaciteti i tij është 5,000 PE dhe kryen trajtim sekondar të ujërave të ndotura urbane. Qëllimi i këtij projekti ka qenë grumbullimi, largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura vetëm për Resortin turistik "G. C." pa përfshirë fshatra apo zona të tjera përreth.
ITUN Dhrale Drymadhë është një projekt i financuar nga buxheti i shtetit me vlerë 400,304,509 lekë. Kapaciteti 6,000 PE dhe kryen trajtim sekondar të ujërave të ndotura urbane. Ky impiant do të grumbullojë, përpunojë dhe trajtojë ujërat e ndotura të zonës së Dhërmiut dhe Drymadhës. Sa i përket ITUN-it të Himarës i cili është ende në proces ndërtimi, AKUK nuk ka pasur informacion të plotë dhe të detajuar lidhur me projektin ITUN Himarë, duke qenë se ky projekt po realizohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.[103]

Nga kjo situatë, një sfidë shtesë identifikohet në kuadrin ligjor, i cili nuk parashikon në mënyrë të qartë përfshirjen e AKUK në të gjitha projektet e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve, pavarësisht burimit të financimit. Kjo mangësi kufizon rolin e AKUK në procesin e planifikimit dhe monitorimit të investimeve, duke ndikuar potencialisht në harmonizimin e politikave të zhvillimit dhe në garantimin e cilësisë së projekteve të zbatuara. Mospërfshirja e AKUK në planifikimin e investimeve të realizuara nga FSHZH kufizon mundësinë për një monitorim dhe mbikëqyrje efektive, gjë që mund të ndikojë në cilësinë dhe eficiencën e projekteve të zbatuara.

Prioritizimi i investimeve në ITUN-e ka shkaktuar pabarazi të theksuara në shpërndarjen e fondeve në bashkitë subjekt auditimi.
Udhëzimi Nr. 8, datë 11.10.2024, "Për miratimin e metodologjisë, kritereve dhe procedurat, për vlerësimin dhe prioritizimin e fondeve buxhetore të investimeve publike, për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve", përcakton kriteret teknike që duhet të përmbushin projektet. Këshilli Teknik i AKUK merr në shqyrtim projektet teknike sipas planit të investimeve vjetore apo Planeve Buxhetore Afat-mesme (PBA). Planifikimi i investimeve sipas AKUK, synon kryesisht zona me prioritet dhe potencial turistik që ndikojnë direkt në zhvillimin e ekonomisë si dhe zona urbane të ndërtuara rishtazi, ku nuk ekziston rrjet kanalizimesh. Gjithashtu prioritet kanë edhe zona të caktuara ku ka amortizim të rrjeteve ekzistuese si dhe zona ku nevojitet rrjet i ri si pasojë e rritjes së dendësisë së banorëve.[104] Sipas të dhënave të raportuara nga AKUK për periudhën 2019-2024 vlera e projekteve për ITUN është

[103] "ITUN Himarë, të dhënat i përkasin FSHZH"- Përgjigje e AKUK për pyetësorin e datës 20.01.2025.
[104] Përgjigje e AKUK për pyetësorin e datës 20.01.2025.

financuar vetëm nga Buxheti i Shtetit, ndërkohë që Njësia e Projekteve me Financim të Huaj pranë AKUK nuk ka planifikuar buxhetet vjetore për financim të huaj në projekte të këtij lloji.[105]

Tabela nr. 13 Vlerat e projekteve ITUN për periudhën 2019-2024.

Nr	Emërtimi	2019	2020	2021	2022	2023	2024	
		Vlera e projekteve (leke)	Totali ne leke 2020	Totali ne leke 2021	Totali ne leke 2022	Totali ne leke Drejtori Rajonale	Totali ne leke Drejtori Rajonale	Totali periudhës 2019-2024
1	Himarë	72,927,482	15,284,579	161,552,370	20,250,000	7,291,063	0	277,305,494
2	Vlorë	98,118,406	30,000,000	110,324,234	100,600,000	0	0	339,042,640
3	Fier	44,722,663	1,000,000	5,033,181	19,124,116	0	0	69,879,960
4	Lushnje	0	0	0	0	0	0	0
5	Durrës	383,280,688	328,903,630	112,918,672	20,300,000	327,000,000	0	1,172,402,990
6	Lezhë	0	0	0	0	0	0	0
7	Shkodër	0	0	0	0	0	0	0
8	Rrogozhinë	0	0	6,050,146	8,076,659	15,787,789	0	29,914,594
9	Kavajë	289,478,000	289,126,012	73,419,976	15,300,000	20,000,000	111,429,929	798,753,917
	Totali	**888,527,239**	**664,314,221**	**469,298,579**	**183,650,775**	**370,078,852**	**111,429,929**	**2,687,299,595**

Burimi: AKUK, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Sikundër shihet edhe nga të dhënat e mësipërme vlera e projekteve ITUN (në total) për periudhën 2019-2024 është 2,687,299,595 lekë. Sipas viteve, pesha specifike në raport me totalin e investimeve paraqitet si më poshtë:

Tab. nr. 14 Pesha specifike e investimeve në projektet e ITUN-eve kundrejt totalit, 2019-2024.

	2019	2020	2021	2022	2023	2024	Totali
Vlerat e investimeve te kryera ne ITUN (leke)	888,527,239	664,314,221	469,298,579	183,650,775	370,078,852	111,429,929	2,687,299,595
Përqindja e investimeve të kryera kundrejt totalit (%)	33	25	17	7	14	4	100

Burimi: AKUK, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Në vitin 2019 investimet në ITUN-e janë 888,527,239 lekë kundrejt totalit 2,687,299,595 lekë, duke zënë rreth 33% të totalit të investimeve të kryera për periudhën 2019-2024. Ndërkohë që ecuria e investimeve në projektet e ITUN-eve paraqitet në rënie përgjatë periudhës 2019-2024. Në vitin 2022, vlera e investimeve në projektet e ITUN-eve është në masën 183,650,775 lekë nga 888,527,239 lekë që janë investuar në vitin 2019. Pra, investimet në vitin 2022 kanë rënë në masën 704,876,464 lekë në raport me vitin 2019. Vlera më e ulët e investimeve në projektet e ITUN-eve paraqitet në vitin 2024 në masën 111,429,929 lekë. Pra, gjatë vitit 2024 janë investuar 777,097,310 lekë më pak se viti 2019.

[105] Rregullore e Brendshme AKUK neni 17, zbatimi i projekteve.

Grafiku nr. 6 Paraqitja grafike e ecurisë së investimeve në ITUN për periudhën 2019-2024.



Burimi: AKUK, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Në përgjigje të pyetjes se cilat kanë qenë arsyet e mungesës së investimeve në bashkitë Lezhë, Shkodër, Lushnje, AKUK sqaron se ITUN Lezhë (projekt përmirësimi) dhe ITUN Shkodër (ndërtim i ri) janë pjesë e financimeve të huaja nga KFË, BE, SECO. Inicimi fillestar i programit ku përfshihen këto investime është viti 2019, ndaj këto nuk kanë qenë pjesë e ndonjë financimi tjetër.[106]

Investimet e kryera në ITUN-e për periudhën 2019-2024, sipas raportimit nga AKUK përfshijnë vetëm fonde buxhetore, jo investime të huaja dhe donatorë. Më poshtë janë paraqitur të dhëna mbi shpërndarjen e investimeve me fonde buxhetore në raport me popullsinë për bashkitë që kanë qenë subjekt auditimi.

Tabela nr. 15 Raporti fonde buxhetore të investuara në ITUN për periudhën 2019-2024, me popullsinë totale me lidhje në sistemin e kanalizimeve.

Nr	Bashkia	Vlera e projekteve (ne leke)	Popullsia totale me lidhje ne sistemin e kanalizimeve (banore)	Leke/banor
1	Himarë	206,276,397	5,620	36,704
2	Vlorë	339,042,640	150,822	2,248
3	Fier	69,879,960	99,012	706
4	Lushnje	-	43,596	-
5	Durrës	1,172,402,990	231,334	5,068
6	Lezhë	-	64,996	-
7	Shkodër	-	98,790	-
8	Rrogozhinë	29,914,594	3,924	7,623
9	Kavajë	798,753,917	59,965	13,320
	Totali	2,616,270,498		

Burimi: AKUK, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Vlerës së projekteve për Bashkinë Himarë i është zbritur shuma prej 71,029,097 lekë e cila i takon Projektit Dhralë Palasë, i cili është në funksion të Resortit "G. C.".
Sipas të dhënave, Bashkia Himarë ka marrë vlerën më të lartë të investimeve për banorë me 36,704 lekë/banorë, ndërkohë që Bashkitë Lushnje, Lezhë dhe Shkodër nuk kanë përfituar asnjë fond nga investimet në impiante trajtimi të ujërave të ndotura. Bashkia Kavajë ka përfituar një

[106] Përgjigje AKUK, për Pyetësorin e fazës së terrenit, email-i i datës 02.04.2025.

nivel të lartë investimesh me 13,320 lekë/banorë, ndërsa Bashkia Fier është në nivelin më të ulët nga bashkitë me investime, me vetëm 706 lekë/banor.

12. Gjetje nga auditimi: Në Strategjinë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2023-2030 është parashikuar që Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve do të ketë rolin e institucionit përgjegjës kryesor për hartimin e një plani të detajuar zbatimi, me qëllim realizimin dhe përmbushjen e objektivit specifik 2.2: "Mbulimi me trajtim i ujërave të përdorura". Nga auditimi ka rezultuar se Agjencia nuk ka hartuar një plan të tillë, i cili duhet të përshkruajë në mënyrë të qartë dhe të plotë hapat konkretë për arritjen e rezultateve të parashikuara në këtë objektiv. Si argument për mungesën e këtij dokumenti, Agjencia sjell faktin se ekziston Projekti DSIP ("Negociatat e Ujit dhe Mbështetja e Planifikimit të Investimeve"), të cilit i atribuohet funksioni i një plani të detajuar zbatimi për këtë objektiv. Projekti DSIP është dakordësuar në vitin 2022, përpara hartimit dhe miratimit të Strategjisë Kombëtare për periudhën 2023–2030. Për më tepër, Strategjia vetë parashikon në mënyrë të qartë nevojën për një plan zbatimi specifik për çdo objektiv, përfshirë objektivin 2.2, si një hap të domosdoshëm për të mundësuar realizimin e tij. Në këtë kuadër, mungesa e një plani të dedikuar nga ana e Agjencisë përbën një mospërputhje me kërkesat e Strategjisë dhe riskon të ndikojë negativisht në ecurinë dhe arritjen e objektivit të parashikuar.

13. Gjetje nga auditimi: Plani i veprimit për SKFSUK 2023-2030 nuk është bazuar në burime të qëndrueshme financimi. Transpozimi i Direktivës së Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane kërkon një ndërhyrje të thellë si në aspektin ligjor, institucional ashtu edhe në burimet e shumta financiare të nevojshme për të ndërtuar infrastrukturën e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane. Hendeku i lartë financiar (69%) për arritjen e objektivit specifik 2.2.1 *"Impiante të trajtimit të ujërave të ndotur për aglomerime > se 2000 pe",* krijon rrezik për realizimin e objektivave të SKFSUK-së. Mungesa e financimit për disa nën-objektiva të rëndësishëm, si vlerësimi i gjendjes së sistemit aktual të trajtimit, identifikimi i industrive me ndikim të madh në ndotje, etj. mund të çojë që investimet e ardhshme nuk do të mund të jenë të strukturuara dhe të orientuara drejt nevojave reale. Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve citon fondet e BE-së, si burimin kryesor të financimit, por nuk ekziston një plan konkret strategjik i mirëpërcaktuar për aplikimin, menaxhimin dhe përthithjen sa më efektive të këtyre financimeve.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka realizuar monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2023–2030 dhe nuk ka hartuar raportin e konsoliduar për vitin 2024, ashtu siç parashikohet. Po ashtu, edhe Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve nuk ka raportuar mbi progresin e zbatimit të planit të veprimit për vitin 2024. Këto veprime janë në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara në nënkapitullin 4.2 të Strategjisë, ku Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë i ngarkohet përgjegjësia për monitorimin dhe raportimin periodik të zbatimit të saj.

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se investimet për ITUN-e për periudhën 2019-2024, janë mbështetur vetëm nga Financimi ekskluziv nga Buxheti i Shtetit, ndërkohë që Njësia e Projekteve me Financim të Huaj pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve nuk ka planifikuar fonde për financim të huaj në këtë sektor. Mungesa e shumëllojshmërisë së burimeve financiare kufizon mundësitë për zgjerimin e investimeve dhe rrit peshën financiare mbi buxhetin e shtetit.

Mungesa e strukturimit të investimeve në sektorin ITUN është reflektuar edhe në planifikimin e investimeve për vitin 2025. Për dy nga projektet e këtij viti "Ndërtimi i kolektorëve dhe ITUN në Shkodër dhe Berat", nuk janë hartuar ende projekt-preventivat për përcaktimin e vlerës së investimit. Pavarësisht përpjekjeve për aplikime në skema ndërkombëtare financimi si WBIF,

mungesa e një qasjeje të strukturuar në planifikimin buxhetor dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik vë në rrezik koordinimin dhe realizimin optimal të investimeve.

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve, si institucioni i specializuar në fushën e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, nuk disponon informacion të plotë dhe të detajuar mbi investimet dhe projektet e zbatuara nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Kuadri ligjor aktual nuk përcakton në mënyrë të qartë përfshirjen e Agjencisë në të gjitha projektet, pavarësisht nga entiteti që i realizon, të cilat zhvillohen në fushën e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

17. Gjetje nga auditimi: Investimet nëpërmjet fondeve buxhetore në ITUN-e për periudhën 2019-2024 kanë pësuar një rënie të vazhdueshme, duke kaluar nga 888,527,239 lekë në vitin 2019 në 111,429,929 lekë në vitin 2024, pra një reduktim në vlerën prej 777,097,310 lekë. Ndonëse investimet teorikisht mund të bazohen në prioritete teknike dhe zonat me nevoja të larta, shpërndarja faktike e fondeve ka krijuar pabarazi të theksuara në aksesin ndaj investimeve. Mungesa e fondeve në disa bashki dhe financimi i lartë në të tjera tregon një mangësi në një strategji të balancuar të investimeve. Bashkia Himarë ka vlerën e investimit më të lartë për banorë. Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura Dhralë Palasë është një financim i buxhetit të shtetit me vlerë 138,305,992 lekë, i nisur para vitit 2019. Kapaciteti i tij është 5,000 PE (1 pe = 1 person) dhe kryen trajtim sekondar të ujërave të ndotura urbane. Qëllimi i këtij projekti ka qenë grumbullimi, largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura vetëm për Resortin turistik “G. C.” pa përfshirë fshatra apo zona të tjera përreth. Kjo tregon një devijim të disa investimeve nga nevojat komunitare drejt projekteve të zhvillimit privat. Në Bashkinë Lushnje nuk parashikohen investime për ITUN në planifikimin afatshkurtër dhe afatmesëm.

Konkluzion 5: Mungesa e një plani të detajuar të zbatimit për objektivin specifik 2.2 "Mbulimi me trajtim i ujërave të përdorura" nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve përbën një mangësi kritike në realizimin e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2023-2030. Mbështetja në Projekti DSIP si një zëvendësim për këtë plan nuk është e mjaftueshme, pasi DSIP ishte dakordësuar para hartimit të vetë Strategjisë dhe nuk përmbush plotësisht kërkesat e saj për strukturim dhe zbatim të qartë.
Pa një plan zbatimi specifik, procesi i realizimit të objektivit 2.2 mbetet i paqartë**,** duke rrezikuar efektivitetin e investimeve, koordinimin institucional dhe përmbushjen e rezultateve të parashikuara. Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve duhet të trajtojë këtë mangësi, duke hartuar një plan operacional të detajuar me faza të qarta, burime financiare dhe indikatorë matës**,** për të garantuar një qasje të strukturuar në trajtimin e ujërave të ndotura urbane. Vetëm nëpërmjet këtij plani mund të sigurohet një zbatim i koordinuar, transparent dhe efikas i investimeve në këtë sektor strategjik.

Konkluzion 6: Pa një strukturë të qartë dhe një plan konkret për burimet e financimit, procesi i financimit të SKFSUK rrezikon të mbetet i paqartë dhe me vonesa, duke ndikuar negativisht në realizimin e objektivave të strategjisë. AKUK duhet ta trajtojë këtë si një prioritet urgjent, duke garantuar një qasje të strukturuar, transparente dhe të koordinuar në investimet e ujësjellës-kanalizimeve.

Konkluzion 7: Pa një strukturë të qartë raportimi dhe monitorimi, rrezikohet zbatimi i SKSFUK, duke sjellë vonesa dhe pasiguri në investimet e sektorit. Zbatimi i masave që lidhen me raportimin dhe eurinë e strategjisë do të sigurojë transparencë, llogaridhënie dhe efektivitet në realizimin e objektivave të strategjisë.

Konkluzion 8: Mungesa e planifikimit të fondeve për ITUN gjatë viteve 2019-2024 tregon një problematikë të theksuar në strukturimin e investimeve të sektorit. Kjo mangësi është reflektuar

edhe në vitin 2025, ku për disa projekte ende nuk janë hartuar projekt-preventivat për përcaktimin e vlerës së investimit. Mungesa e një qasjeje të strukturuar në planifikimin buxhetor dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik vë në rrezik koordinimin dhe realizimin optimal të investimeve.

Konkluzion 9: Mungesa e një sistemi të qartë dhe të strukturuar për përfshirjen e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve (AKUK) në të gjitha projektet e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura krijon mundësi për një boshllëk institucional dhe informativ, duke rrezikuar koordinimin dhe efektivitetin e investimeve në sektorin UK.

Konkluzion 10: Mungesa e një mekanizmi të strukturuar për një shpërndarje më të drejtë të investimeve, vë në rrezik vazhdimësinë dhe efektivitetin e projekteve ITUN në vitet e ardhshme. Mungesa e një strategjie të balancuar të investimeve ka ndikuar në përjashtimin e bashkive si Lushnja nga planifikimi afatshkurtër dhe afatmesëm, duke lënë pa financime zona me nevoja të larta infrastrukturore.

12.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve të marrë masa për të hartuar dhe miratuar një plan zbatimi të detajuar për objektivin specifik 2.2 "Mbulimi me trajtim i ujërave të përdorura", në përputhje me kërkesat e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2023-2030, ku të përfshihen:

- Përshkrim i qartë i veprimeve të nevojshme për realizimin e objektivit, arritjen e përqindjes së popullsisë që do të mbulohet me shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura urbane, duke detajuar fazat e zbatimit dhe burimet e financimit;
- Afate të qarta dhe indikatorë matës për monitorimin e progresit të investimeve dhe eficiencës së infrastrukturës së trajtimit të ujërave të ndotura;
- Harmonizimin e Projektit DSIP me Strategjinë, duke e integruar atë si një mjet mbështetës, pa e zëvendësuar rolin e planit të zbatimit të detajuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve të rishikojë dhe përcaktojë qartë në PBA burimet e financimit për arritjen e objektivit specifik 2.2.1 “Impiante të trajtimit të ujërave të ndotur për aglomerime > se 2000 pe”, duke e pasqyruar si masë korrigjuese në përditësimin e SKSFUK 2023-2030, me synimin që të garantohet qëndrueshmëri e financimit.

Mars 2026

13.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve të hartojë një Plan Operacional për Përthithjen e Fondeve të BE-së**,** duke vendosur indikatorë të matshëm, si identifikimi i projekteve për financim, numri i aplikimeve gjatë një periudhe të caktuar, krijimin e një platforme raportimi dhe status aplikimi etj. me synim monitorimin dhe raportimin e progresit.

Mars 2026

14.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve në cilësinë e institucionit përgjegjës kryesor të hartojë raportin për ecurinë e Planit të Veprimit për vitin 2024, bazuar në analizën e progresit dhe të propozojë veprimet korrigjuese, nëse është e nevojshme, me synim përditësimin e SKSFUK 2023-2030.

Menjëherë

14.2 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të hartojë raportin e konsoliduar duke u bazuar në raportet e dërguara nga institucionet përgjegjëse, i cili do të shërbejë në vlerësimin e efektivitetit të planeve të veprimit për arritjen e rezultateve të parashikuara.

Menjëherë

15.1 Rekomandimi: Njësia e Projekteve me Financim të Huaj pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve të marrë masa për plotësimin e projekt preventivave të planifikuara për vitin 2025, për ndërtimin e kolektorëve dhe ITUN-eve në Shkodër dhe Berat, si dhe për forcimin e kapaciteteve për parashikimin dhe planifikimin e fondeve në kohë, me synim garantimin e një menaxhim më efektiv dhe një zbatim të suksesshëm të projekteve.

Brenda vitit 2025

16.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve të marrin masa për përditësimin e akteve ligjore/nënligjore me qëllim që AKUK të ketë akses të plotë në informacione e të dhëna në projektet e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura, pavarësisht institucionit që i zbaton ato.

Brenda vitit 2025

16.2 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrë masa për krijimin e një procesi institucional të koordinimit periodik ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe institucioneve të tjera të përfshira në fushën e projekteve dhe investimeve. Ky mekanizëm synon të mundësojë identifikimin, planifikimin dhe përcaktimin e burimeve të financimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të investimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve.

Menjëherë

17.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të vlerësojnë mundësinë e rishikimit të metodologjisë së planifikimit dhe alokimit të fondeve, bazuar në dendësinë e popullsisë, nivelin e amortizimit të rrjetit, rëndësinë ekonomike dhe impaktin social, në mënyrë që të sigurohet një shpërndarje më e drejtë dhe e ekuilibruar e investimeve në ITUN.

Brenda vitit 2025

4.2.3 Si ka funksionuar vendosja e impianteve individuale të trajtimit të ujërave të ndotura?

Me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut nga ndikimet negative të ujërave të ndotura, u miratua ligji nr.9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura.[107] Duke pasur si objekt[108] të zbatimit të tij ujërat e ndotura urbane, ky ligj përcakton se cilat janë detyrat e organeve shtetërore për sa i përket trajtimit mjedisor të ujërave të ndotura, si dhe përcakton detyrimet që kanë personat fizikë dhe juridikë, veprimtaritë e të cilëve shkarkojnë ujëra të ndotura. Personat fizikë dhe juridikë, veprimtaritë e të cilëve shkarkojnë ujëra të ndotura kanë detyrimin të administrojnë dhe të trajtojnë ujërat e ndotura.[109] Ky detyrim, që ligji u ngarkon këtyre personave, realizohet nëpërmjet ndërtimit dhe funksionimit të sistemit të kanalizimeve të brendshme, ndërtimit dhe funksionimit të impiantit të trajtimit, ndërtimit dhe funksionimit të rrjetit të kanalizimeve, për largimin e ujërave të ndotura urbane deri në kolektor, nxitjes së ripërdorimit të dobishëm të ujërave të trajtuara, trajtimit të llumrave dhe të lëndëve të ngurta, që dalin nga impiantet e trajtimit, sipas kërkesave dhe kushteve të vendosura në lejen mjedisore, zbatimit të normave të lejuara të shkarkimeve të lëngëta.[110] Sipas përcaktimeve të ligji nr.9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", Ministria e Mjedisit, agjencitë rajonale dhe Inspektorati i Mjedisit, krahas organeve të ngarkuara me ligj për administrimin e rezervave ujore, ndihmojnë funksionimin e procesit të trajtimit mjedisor të ujërave të ndotura

[107] Ligji nr.9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", neni 1
[108] Ligji nr.9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", neni 2
[109] Ligji nr.9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", neni 6, pika 1, gërma c
[110] Ligji nr.9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", neni 6

dhe kontrollojnë zbatimin e tij në të gjitha nivelet.[111] Në pikën 2 të nenit 4 të këtij ligji gjithashtu përcaktohet se: "*Organet shtetërore, qendrore e vendore, secili në linjën e vet, bashkëpunojnë me Ministrinë e Mjedisit për: a) përcaktimin e teknikave, teknologjive dhe metodave më të mira të mundshme për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura dhe të përdorura, në përputhje me llojin e natyrën e tyre; b) hartimin e planeve për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura në mënyrë të integruar, si pjesë e planeve të menaxhimit të baseneve ujëmbledhëse përkatëse; c) krijimin e kuadrit ligjor bashkëkohor, për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura dhe të përdorura; ç) përsosjen e rrjetit institucional përgjegjës; d) sigurimin dhe përdorimin e frytshëm të mjeteve të nevojshme financiare; dh) kontrollin e vazhdueshëm të veprimtarive, që shkaktojnë ndotje të ujërave, si dhe të subjekteve që angazhohen në trajtimin dhe pastrimin e tyre."*

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit luan një rol kyç në promovimin e praktikave të qëndrueshme që ndihmojnë në ruajtjen e cilësisë së ujërave larës dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm nëpërmjet formulimit, hartimit dhe sigurimit të zbatimit të politikave mjedisore, si dhe krijimit të kuadrit ligjor bashkëkohor, për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura në Shqipëri. Gjithashtu, është institucioni përgjegjës për transpozimin e të gjitha aspekteve mjedisore kryesorë të ujit si dhe direktivave të BE-së. [112] Ligji nr.9115, datë 24.07.2003 përcakton Inspektoratin e Mjedisit, si organ përgjegjës, për ushtrimin e kontrolleve për respektimin e normave të shkarkimeve të lëngëta, si dhe për kontrollin e zbatimit të rregullave dhe të kërkesave për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura dhe kushtet e vendosura në lejen mjedisore.[113] Me krijimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, kompetencat e ish- Inspektoratit të Mjedisit i kaluan kësaj agjencie, si dhe Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit[114]. Me VKM nr. 568, datë 17.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" u shfuqizua VKM nr. 103, datë 04.02.2015, "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve", e ndryshuar.[115]

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, si institucion në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ka si funksion monitorimin e cilësisë së mjedisit në Shqipëri.[116] Ajo kryen inspektimin dhe kontrollin tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore.[117] Në lidhje me inspektimin dhe kontrollin e veprimtarive lidhur me sektorin e mjedisit dhe ujërave AKM realizon: sigurimin e kontrollit shtetëror të mbrojtjes së mjedisit; kryerjen e inspektimeve dhe kontrolleve përmes një programi tematik mbi bazë risku, të miratuar nga ministri përgjegjës për mjedisin, për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore; sigurimin e zbatimit dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e inspektimit të mjedisit dhe ujërave.[118] Këto funksione të AKM-së janë përgjegjesi e sektorit të inspektimit të burimeve ujore në drejtorinë e inspektim-kontrollit.[119]

[111] Ligji nr.9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", neni 4, pika 1

[112] VKM nr. 448, datë 26.7.2023 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023–2030", fq 9.

[113] Ligji nr.9115, datë 24.7.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", neni 21

[114] Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit nuk është subjekti këtij auditimi, për këtë arsye do të trajtohet vetëm roli i AKM-së për sa i përket kontrollit dhe inspektimeve që ajo kryen në fushën e mjedisit dhe të ujërave.

[115] VKM nr. 568, datë 17.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", IV Dispozita Kalimtare dhe të Fundit, pika 4

[116] Rregullore e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit, Nr. 120 datë 12.01.2021, Neni 5, pika f.

[117] VKM nr. 568, datë 17.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", II. Përgjegjësitë Funksionale të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, pika 4

[118] VKM nr. 568, datë 17.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", III. Organizimi dhe Funksionimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, pika 5.4

[119] Rregullore e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit, fq 55

Për të adresuar problemin e shkarkimit të ujërave të ndotura të patrajtuara në ujërat larëse, Shqipëria miratoi Aktin Normativ nr. 8, më 28 dhjetor 2023. Ky akt parashikon që subjektet që operojnë pranë zonave bregdetare, liqeneve dhe lumenjve, të tilla si hotelet dhe restorantet, të instalojnë sisteme individuale për trajtimin e ujërave të ndotura brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e aktit. Akti gjithashtu krijon një Task Forcë në varësi të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK), e cila do të mbikëqyrë zbatimin e aktit, do të kryejë inspektime dhe do të vendosë gjoba që variojnë nga 1.5 deri në 2.65 milionë lekë për mosrespektim të tij. Shkeljet e përsëritura mund të çojnë në heqjen e licencave dhe kufizimin e lejeve të ardhshme të ndërtimit. Kjo nismë synon të përmirësojë mbrojtjen e mjedisit dhe të harmonizohet me standardet e Bashkimit Evropian për menaxhimin e ujërave.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka kryer inspektime lidhur me procesin e trajtimit mjedisor të ujërave të ndotura.

AKM duhet të kryejë inspektim dhe kontroll tematik për respektimin e kërkesave ligjore të kushteve mjedisore.[120] AKM, nëpërmjet programeve tematike vjetore mbi bazë risku të miratuara nga ministri, kryen kontrolle dhe inspektime në sektorin e ujërave. Këto inspektime janë përgjegjësi e sektorit të inspektimit të burimeve natyrore (ujërave) në Drejtorinë e Inspektim-Kontrollit në AKM.[121] Për periudhën 2020-2022, AKM ka planifikuar inspektime në subjekte që krijojnë dhe shkarkojnë ujëra të ndotura në plazhe dhe në zona të tjera të vendit.[122] Këto inspektime kishin për qëllim ndër të tjera evidentimin e operatorëve si hotele, restorante etj., detyrimin e tyre për t'u lidhur me rrjetet e kanalizimeve të impianteve të trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura si dhe vënien në punë sipas parametrave të projektit të këtyre impianteve. Konkretisht:

- Për vitin 2020 janë planifikuar në total 343 inspektime në programin vjetor[123], nga ku janë realizuar vetëm 74 (21.5%) inspektime me objekt shfrytëzimin e burimeve ujore[124].
- Për vitin 2021 janë planifikuar në total 661 inspektime, nga ku janë realizuar 290 (48 %) inspektime në subjekte që shfrytëzojnë burime ujore.[125]
- Për vitin 2022 janë planifikuar në total 661 inspektime[126], nga ku janë realizuar 264 (40 %), inspektime pa detajuar objektin e kontrollit/inspektimit.
- Për vitin 2023 janë planifikuar në total 661 inspektime[127], nga ku janë realizuar 199 (30 %) inspektime pa detajuar objektin e kontrollit/inspektimit.[128]

Në programet vjetore veçanërisht të viteve 2020, 2021, 2022, në pikën 1.4 të tyre përcaktohet kontrolli i subjekteve që shkarkojnë dhe trajtojnë ujëra të ndotura edhe pse nuk parashikohet sa do të jetë numri i kontrolleve/inspektimeve të tilla. Nga analizat vjetore nuk identifikohet nëse janë bërë inspektime në subjekte që shkarkojnë apo trajtojnë ujëra të ndotura. Nga informacionet e siguruara nga AKM, në territorin e bashkive subjekt auditimi janë realizuar vetëm dy

[120] VKM nr. 568, datë 17.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", II. Përgjegjësitë Funksionale të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, pika 4.

[121] Rregullore e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit, fq. 55

[122] Programi vjetor nr. 635/1, datë 23.12.2020, Programi nr. 26 prot., datë 06.01.2021, Programi nr. 599/1 prot., datë 24.01.2022

[123] Programi vjetor i inspektimeve i miratuar nr. 635/1, datë 23.12.2020.

[124] Analiza Vjetore e Sektorit të Inspektimit të Burimeve natyrore (ujërave) në Drejtorinë e Inspektim-Kontrollit, AKM, 2020.

[125] Sipas analizës vjetore të Drejtorisë Inspektim-Kontrollit, Sektori i Inspektimit të Burimeve natyrore (ujërave) Qershor – Dhjetor 2021. 1 Janar 2021 - 31 Maj 2021, nuk kanë ushtruar aktivitet për shkak të Pandemisë Covid-19.

[126] Programi i miratuar me nr. 599/1 prot., datë 24.01.2021.

[127] Programi i miratuar me nr. 190/1 prot., datë 12.01.2023.

[128] Sipas analizës vjetore të Drejtorisë Inspektim-Kontrollit, Sektori i Inspektimit të Burimeve natyrore (ujërave) Qershor – Dhjetor 2023.

inspektime në ITUN-in e Vlorës (dt. 07.06.2024) dhe Himarës (dt. 04.06.2024), por edhe këto inspektime nuk kanë pasur në fokusin e tyre mënyrën e funksionimit të tyre sa i përket procesit të trajtimit të ujërave të ndotura, respektimit të vlerave kufi të tyre, gjendjes infrastrukturore të impianteve etj. Grupi i auditimi kërkoi informacione shtesë nga AKM lidhur me kontrollin dhe inspektimin e procesit të trajtimit të ujërave të ndotura urbane.[129] Referuar përgjigjes së AKM-së për këtë kërkesë të grupit të auditimit rezulton se në bashkitë subjekt auditimi nuk është kryer asnjë inspektim me fokus trajtimin e ujërave të ndotura urbane.

Në aktin normativ nr. 8 datë 28.12.2023 nuk është përcaktuar/përkufizuar territori që përbën zonën bregdetare në funksion të zbatimit të këtij akti.

Dispozitat e aktit normativ nr. 8, datë 28.12.2023 gjejnë zbatim për subjektet që zhvillojnë veprimtari ekonomike, në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve dhe që shkarkojnë ujëra të ndotura të patrajtuara, pranë ose në ujërat larëse.[130] Pra, vërehet qartë nga ky përcaktim i aktit normativ se, kriteri që përcakton nëse një subjekt është pjesë e fushës së zbatimit të këtij akti, është zhvillimi i veprimtarisë ekonomike në zonën bregdetare. Neni 2 i aktit normativ përmban një sërë përkufizimesh, përfshirë edhe llojet e veprimtarive ekonomike ushtruar nga subjektet, por në asnjë prej pikave të tij nuk gjejmë një përkufizim të "zonës bregdetare".

Me qëllim identifikimin e saktë të subjekteve që kanë detyrimin të zbatojnë aktin normativ nr.8, datë 28.12.2023, është e domosdoshme dhe e nevojshme të jetë e qartë se çfarë kuptojmë me termin "zonë bregdetare", për efekt të zbatimit të këtij akti.

Një përkufizim për termin "zonë bregdetare" është përcaktuar në ligjin nr.10234, datë 18.2.2010 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin "Për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare në Mesdhe", të Konventës së Barcelonës "Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të rajoneve bregdetare të Mesdheut". Sipas nenit 2, pika e), përkufizimi i fjalës "zonë bregdetare" është si më poshtë:

"Zonë bregdetare" do të thotë zona gjeomorfologjike në secilën anë të bregut të detit, ku kryqëzimi ndërmjet pjesëve detare dhe tokësore bëhet në formën e sistemeve komplekse ekologjike dhe burimore të përbëra nga komponentë jetësorë dhe jo jetësore/fizikë që bashkëjetojnë dhe ndërveprojnë me komunitetet njerëzore dhe aktivitetet përkatëse sociale-ekonomike.[131]

Identifikimi i subjekteve nga ana e Task-Forcës është bërë duke marrë të dhëna nga shoqëritë rajonale të ujësjellës kanalizimeve të subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike[132].

Ky proces është realizuar pa përcaktuar më parë saktësisht territorin ku shtrihet veprimtaria e Task- Forcës, sipas përkufizimit të zonës bregdetare. Me qëllim identifikimin e numrit të saktë të subjekteve që janë pjesë e fushës së zbatimit të aktit, duhet fillimisht të përcaktohet, për secilën bashki, territori ku Task-Forca shtrin veprimtarinë e saj, duke u bazuar në përkufizimin e "zonës bregdetare". Mungesa e përcaktimit të kuptimit për "zonën bregdetare" në dispozitat e aktit normativ, si dhe mos marrja parasysh nga ana e Task-Forcës së ndonjë përkufizimi për termin në fjalë, në akte të tjera ligjore apo nënligjore, e bën të pamundur identifikimin e saktë të totalit të subjekteve që janë në fushën e zbatimit të këtij akti.

Duke qenë se neni 4 i aktit parashikon detyrimin për të gjitha subjektet që zhvillojnë veprimtari ekonomike[133] që, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ, vendosin impiantin ose sisteme individuale, me qëllim trajtimin e ujërave të ndotura, identifikimi jo i saktë i numrit total të tyre, cënon zbatimin e aktit normativ nr. 8, e për pasojë e bën të pamundur përmbushjen e qëllimit për të cilin është ai është miratuar.

[129] Email i grupit të auditimit më date 25.04.2025

[130] Akt Normativ nr. 8, datë 28.12.2023, neni 3

[131] https://qbz.gov.al/share/lrQPePa_QR2DFar28sS02Q

[132] E-mail nga Task-Forca, datë 19.12.2024

[133] Akt Normativ nr. 8, datë 28.12.2023 neni 2, pika 1 dhe 2

"Data base" e krijuar nga Task-Forca është jo e plotë dhe e pasaktë.

Akti normativ nr. 8, datë 28.12.2023, në nenin 7 të tij, përcakton detyrat e Task-Forcës gjatë ushtrimit të funksioneve të saj. Konkretisht pika 1, gërma b e këtij neni përcakton, si një nga detyrat e kësaj Task-Force, "*mbledhjen e informacionit dhe krijimin e një data base për të dhënat e të gjitha subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike dhe shkarkojnë ujëra të ndotura të trajtuara dhe të patrajtuara pranë ose në ujërat larëse*". I njëjti parashikim gjendet dhe në nenin 4, pika 3 të rregullores për funksionimin e Task-Forcës.[134] Si një akt i brendshëm, rregullorja detajon më tej se si do të realizohet veprimtaria dhe funksionimi i Task-Forcës, me qëllim përmbushjen e detyrave që i ngarkon Akti Normativ nr.8. Megjithatë, në këtë rregullore nuk gjendet asnjë përcaktim për mënyrën se si konkretisht Task-Forca e realizon këtë detyrë, për qëllime të zbatimit të aktit. Përcaktimi në aktin normativ kërkon që "data base", e krijuar nga Task-Forca, të përmbajë të dhëna për të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike dhe shkarkojnë ujëra të ndotura të trajtuara dhe të patrajtuara pranë ose në ujërat larëse. Për realizimin e kësaj, nevojitet fillimisht të identifikohet numri total i këtyre subjekteve. Identifikimi i numrit të saktë të tyre rezulton i pamundur, në kushtet kur Task-Forca nuk ka përcaktuar më parë saktësisht territorin ku shtrihet veprimtaria e saj, në bazë të përkufizimit për termin "zonë bregdetare".

Task-Forca ka krijuar një "data base" lidhur me të gjitha inspektimet/kontrollet që grupet e inspektimit në terren kanë kryer për trajtimin e ujërave të ndotura me qëllim verifikimin dhe zbatimin e aktit normativ.[135] Sipas kësaj "data base", rezultojnë rreth 2400 inspektime të kryera nga Task-Forca gjatë periudhës maj-tetor 2024.[136]

"Data base" e krijuar nga Task Forca nuk tregon numrin e saktë të subjekteve (të evidentuara deri sot) në të gjithë Shqipërinë, që kanë detyrimin të zbatojnë aktin normativ nr. 8. Arsyet që lidhen me numrin jo të saktë të subjekteve të evidentuara nga Task Forca janë:

- Mos kërkimi i informacionit nga ana e Task Forcës ndaj institucioneve të tjera;
- Mos marrja e informacionit të saktë në rastet kur ajo e ka siguruar atë.

Task-Forca nuk ka kërkuar të dhëna apo informacione nga institucione që kanë pasur ndër vite detyrimin për të identifikuar subjektet që shkarkojnë e trajtojnë ujëra të ndotura, si Agjencia Kombëtare e Mjedisit apo Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.[137]

Nga ana tjetër, Task-Forca ka kërkuar të marrë listat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike nga shoqëritë rajonale të ujësjellës kanalizimeve, por nuk ka marrë informacion të saktë prej tyre apo ndonjë listë referuese të bizneseve të regjistruara.[138]

Nga ana tjetër, nga totali i inspektimeve rezultojnë rreth 290 raste inspektimesh, ku për subjektet në "data base" gjendet shënimi "të mbyllura". Lidhur me këto subjekte, është pasqyruar ky shënim në "data base", pasi gjatë inspektimeve në terren të kryera nga grupet e kontrollit, këto subjekte kanë qenë mbyllur.[139] Krahasimisht, për periudhën maj-tetor, numri më i lartë i inspektimeve me këtë shënim, pasqyruar në "data base", i përket muajit maj dhe shtator, muaj të cilët përkojnë përkatësisht me kohën para çeljes së sezonit turistik dhe me kohën e mbylljes së sezonit turistik. Në këto kushte, Task-Forca nuk ka informacion të saktë nëse këto subjekte operojnë apo jo. Evidentimi i numrit total të subjekteve, nga të dhënat e "data base", paraqitet i

[134] Urdhër nr. 65, datë 19.04.2024 "Për miratimin e Rregullores së funksionimit dhe strukturës organizative të Task-Forcës për monitorimin, inspektimin dhe marrjen e masave me qëllim rregullimin e pasojave që vijnë nga mostrajtimi i ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse në zonat bregdetare dhe bregun e liqeneve dhe të lumenjve", neni 4, pika 3

[135] Email nga Task-Forca, datë 18.10.2024

[136] Burimi: Databaza e vendosur në dispozicion nga Task-Forca e AKUK.

[137] Email nga Task-Forca, datë 19.12.2024 dhe datë 17.03.2025

[138] Email nga Task-Forca, datë 19.12.2024 dhe datë 17.03.2025

[139] Email nga Task-Forca, datë 19.12.2024 dhe datë 17.03.2025

vështirë edhe për arsye se shumë subjekte nuk kanë dhënë NIPT (rezultojnë rreth 570 raste inspektimesh pa shënimin përkatës të NIPT-it për këto subjekte në "data base"), gjë që e bën të pamundur identifikimin. Për më tepër, nga "data base" rezultojnë rreth 20 subjekte pa emër. Gjithashtu, disa nga subjektet, gjatë ri inspektimeve të kryera nga grupet e kontrollit në terren, kanë rezultuara të mbyllura.[140]
Sa më sipër, për të gjitha arsyet e përmendura, "data base" i krijuar nga Task-Forca nuk arrin të japë një informacion të plotë dhe të saktë lidhur me të dhënat e të gjitha subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike dhe shkarkojnë ujëra të ndotura të trajtuara dhe të patrajtuara pranë ose në ujërat larëse.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka të dhëna të përditësuara mbi numrin e strukturave akomoduese që operojnë dhe që potencialisht gjenerojnë ujëra të ndotura.
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka detyrimin të publikojë të dhëna për sa i përket strukturave akomoduese në faqen zyrtare të saj, sipas shpërndarjes gjeografike dhe destinacionit turistik.[141]
Aktualisht, të vetmet të dhëna të publikuara në faqen zyrtare të MTM janë ato të Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023.[142]
Sipas këtyre të dhënave, në gjithë vendin rezulton një total prej 2437 struktura akomoduese që operojnë. Hotelet përbëjnë rreth 65% të totalit, ndërsa pjesa tjetër janë shtëpi e dhoma. Megjithatë këto te dhëna nuk japin informacion për shpërndarjen gjeografike të këtyre strukturave, si dhe janë të dhëna që i përkasin periudhës para vitit 2019.
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në vitin 2019 ndërmori procesin e kategorizimit të strukturave akomoduese.[143] Nga të dhënat e depozituara prej këtyre strukturave nëpërmjet e-albania, MTM ka gjeneruar të dhëna, të ndara sipas qyteteve, për totalin e këtyre strukturave, llojin e tyre, si dhe kapacitete (dhoma/shtretër).[144] MTM ka adresën e saktë të tyre, si dhe të dhëna mbi shërbimet që ofrojnë.
Gjithashtu, MTM i konfirmoi grupit të auditimit se, INSTAT nuk ka të dhëna në lidhje me strukturat akomoduese të ndara me qarqe apo qytete. Të dhënat e publikuara kanë vetëm vlerat në total të strukturave akomoduese, sipas llojit të tyre për periudhën 2020-2023, sipas tabelës nr. 16 më poshtë.

Tab. nr. 16 Strukturat akomoduese për vitet 2020-2023

Përshkrimi i strukturave akomoduese sipas tipit	**Strukturat akomoduese**			
	2020	**2021**	**2022**	**2023**
Hotele dhe Struktura të ngjashme	1,237	1,256	1,385	1,549
Struktura pushimi dhe për qëndrime të shkurtra	177	145	157	239
Struktura kampingu,, mjete levizëse pushimi	55	56	38	29
Total	**1,469**	**1,457**	**1,580**	**1,817**

Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Të dhënat më lartë nuk janë të publikuara në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. MTM, në lidhje me këtë fakt, është shprehur se këto janë të dhëna administrative, që vijnë nga

[140] Email nga Task-Forca, datë 17.03.2025
[141] Urdhër nr.20, datë 01.03.2023 "Për ngritjen e Task-Forcës Ndërinstitucionale të sezonit turistik veror 2023", shtojca nr.1, plani i masave për sezonin turistik veror 2023
[142] Vendim nr. 413, datë 19.6.2019 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qendrueshëm të Turizmit 2019–2023 dhe të Planit të Veprimit"
[143] Email nga MTM, datë 08.10.2024
[144] Tabela Kategorizimi i strukturave akomoduese sipas qyteteve në Aneksin nr. 5

vetëraportimi i strukturave dhe si të tilla nuk kanë saktësinë e të dhënave statistikore që publikohen në faqen e ministrisë.

Nga rreth 1000 subjekte të identifikuara nga Taskë Forca, vetëm 154 prej tyre kanë përfunduar procesin e instalimit të impiantit individual të trajtimit të ujërave të ndotura.

Akti normativ nr.8 ka si qëllim trajtimin e ujërave të ndotura, për subjektet që kryejnë veprimtari ekonomike në zonat bregdetare dhe bregun e liqeneve e të lumenjve, të cilat nuk i trajtojnë ujërat e ndotura dhe i shkarkojnë ato pranë ose në ujëra larëse.

Ky qëllim realizohet nëpërmjet vendosjes së impiantit apo sistemit të grumbullimit, trajtimit dhe largimit të ujërave të ndotura nga ana e subjekteve, sipas rregullores teknike[145], të miratuar me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për infrastrukturën dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin.[146] Standardet e parashikuara nga kjo rregullore teknike në lidhje me mënyrën e funksionimit të impianteve individuale apo parametrave të tyre teknikë nuk janë objekt auditimi, duke qenë se këto impiante ende nuk janë kolauduar. Ndër të tjera, ky akt parashikon se të gjitha subjektet që zhvillojnë veprimtari ekonomike në zona bregdetare ose në afërsi të tyre, duhet të vendosin impiantin individual të trajtimit të ujërave të ndotura, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ.[147] Task-Forca ka identifikuar një numër total rreth 1000 subjekte deri sot (në bashkitë subjekt auditimi), që kanë detyrimin të zbatojnë aktin normativ nr.8, datë 28.12.2023.[148] Në tabelën më poshtë paraqitet numri total subjekteve të identifikuara nga Task-Forca, i ndarë sipas bashkive subjekt auditimi, si dhe numri total i subjekteve, për të cilat ka përfunduar procesi i instalimit të impiantit individual të trajtimit të ujërave të ndotura, të ndara sipas bashkive respektive si më poshtë:

Tabela nr. 17 Numri i subjekteve të identifikuara dhe i atyre me impiant të instaluar sipas bashkive

Bashki	**Nr i subjekteve të identifikuara**	**Nr i subjekteve me impiant të instaluar**
Shkodër	144	15
Lezhë	105	7
Durrës	258	21
Kavajë	157	9
Rrogozhinë	1	1
Vlorë	142	75
Himarë	78	23
Lushnje	36	-
Fier	51	3
		154

Burimi: Task-Forca [149]

Nga tabela vërehet se numri më i lartë subjekteve është identifikuar në Bashkinë Durrës, ndjekur më pas nga ajo e Kavajës, Shkodrës dhe Vlorës, ndërsa Bashkia Rrogozhinë rezulton me numrin më të ulët të subjekteve identifikuar. Megjithatë, këto të dhëna nuk janë të sakta, duke qenë se Task-Forca nuk ka marrë informacion të saktë nga shoqëritë rajonale të ujësjellës kanalizimeve për subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike, si dhe nuk ka kërkuar të dhëna nga AKM dhe MTM për këto subjekte. Kjo shifër ka dalë nga kontrollet ne terren të grupeve të inspektimit të Task-Forcës.

[145] Rregullorja Teknike "Mbi standardet për trajtimin e ujërave të ndotura për subjektet që shkarkojnë ujëra të ndotura të patrajtuara pranë ose në ujëra larëse"

[146] Akt Normativ nr. 8, datë 28.12.2023, "Për marrjen e masave urgjente, për mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës, për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse", neni 1

[147] Akt Normativ nr. 8, datë 28.12.2023, neni 4

[148] Email nga Task-Forca, datë 17.03.2025

[149] Task-Forca e ngritur me Aktin Normativ Nr. 8, datë 28.12.2023

Për të ilustruar këtë konstatim, mjafton të përmendim rastin e Bashkisë Rrogozhinë. Gjatë vizitave në terren në korrik 2024, grupi i auditimit evidentoi me dhjetëra subjekte në këtë bashki që janë objekt i aktit, ndërkohë në tabelën e Task-Forcës e rezulton vetëm një subjekt.
Nga totali i rreth 1000 subjekteve të identifikuara, numri i subjekteve, deri më tani, që kanë përfunduar procesin e instalimit të impiantit individual të trajtimit të ujërave të ndotura dhe janë në gjendje pune, është gjithsej 154 subjekte.[150]
Vërehet nga tabela e mësipërme se numrin me të lartë të subjekteve që kanë përfunduar procesin e instalimit të impiantit individual të trajtimit të ujërave të ndotura e ka Bashkia e Vlorës, ndjekur më pas nga ajo e Himarës dhe Durrësit, ndërsa në Lushnje nuk rezulton asnjë subjekt me impiant individual të trajtimit të ujërave të ndotura të instaluar.

Task - Forca nuk ka marrë masa administrative në shumë prej rasteve të mos vendosjes së impianteve individuale.

Task-Forca ka si mision monitorimin, inspektimin dhe marrjen e masave, me qëllim rregullimin e pasojave që vijnë nga mostrajtimi i ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujërat larëse, në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve dhe të lumenjve, nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në këto zona.[151]
Akti normativ nr 8, datë 28.12.2023, në nenin 7, gërma ç përcakton si një nga detyrat e kësaj Task-Force: "*marrjen e masave administrative në rastet kur konstatohen shkeljet, sipas këtij akti normativ*". I njëjti parashikim gjendet dhe në nenin 4, pika 5 të rregullores për funksionimin e Task-Forcës.[152]
Me qëllim verifikimin dhe zbatimin e Aktit Normativ nr.8, me urdhër të Drejtorit të Task Forcës, janë ngritur grupe pune, të cilët kanë kryer inspektime në terren për të verifikuar dhe për të konstatuar subjektet, që sipas aktit duhet të jenë të pajisura me impiant për trajtimin e ujërave të ndotura.[153] Inspektimi kryhet mbi bazën e një procedimi administrativ, të bazuar në Aktin Normativ Nr.8.[154] Urdhrat e punës bëhen sipas një plani periodik inspektimi për të kryer kontrollin e subjekteve që shkarkojnë ujëra të ndotura urbane, sipas kategorive të subjekteve, ku ndarja e grupeve të terrenit bëhet në zbatim të fushave dhe prioriteteve të përcaktuara në këtë plan periodik.[155] Plani periodik i inspektimit hartohet[156] nga drejtori i Task-Forcës, me qëllim sigurimin e zbatimit të parimit të përgjegjësisë mjedisore[157] "Ndotësi paguan".

[150] Email nga Task-Forca, datë 19.12.2024
[151] Urdhër nr. 65, datë 19.04.2024 "Për miratimin e Rregullores së funksionimit dhe strukturës organizative të Task-Forcës për monitorimin, inspektimin dhe marrjen e masave me qëllim rregullimin e pasojave që vijnë nga mostrajtimi i ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse në zonat bregdetare dhe bregun e liqeneve dhe të lumenjve", neni 2
[152] Urdhër nr. 65, datë 19.04.2024 "Për miratimin e Rregullores së funksionimit dhe strukturës organizative të Task-Forcës për monitorimin, inspektimin dhe marrjen e masave me qëllim rregullimin e pasojave që vijnë nga mostrajtimi i ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse në zonat bregdetare dhe bregun e liqeneve dhe të lumenjve", neni 4, pika 5
[153] Urdhër nr. 65, datë 19.04.2024 "Për miratimin e Rregullores së funksionimit dhe strukturës organizative të Task-Forcës për monitorimin, inspektimin dhe marrjen e masave me qëllim rregullimin e pasojave që vijnë nga mostrajtimi i ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse në zonat bregdetare dhe bregun e liqeneve dhe të lumenjve", neni 6, pika 4, gërma c
[154] Urdhër nr. 65, datë 19.04.2024 "Për miratimin e Rregullores së funksionimit dhe strukturës organizative të Task-Forcës për monitorimin, inspektimin dhe marrjen e masave me qëllim rregullimin e pasojave që vijnë nga mostrajtimi i ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse në zonat bregdetare dhe bregun e liqeneve dhe të lumenjve", neni 24, pika 1
[155] Urdhër nr. 65, datë 19.04.2024 "Për miratimin e Rregullores së funksionimit dhe strukturës organizative të Task-Forcës për monitorimin, inspektimin dhe marrjen e masave me qëllim rregullimin e pasojave që vijnë nga mostrajtimi i ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse në zonat bregdetare dhe bregun e liqeneve dhe të lumenjve", neni 25, pika 2
[156] Urdhër nr. 65, datë 19.04.2024, neni 25, pika 1
[157] Urdhër nr. 65, datë 19.04.2024 "neni 6, pika 4, gërma d

Task-Forca ka përcaktuar si objektit të inspektimit të saj: kontrollin e dokumentacionit teknik-ligjor, kontrollin nëse aktiviteti disponon impiant trajtimi për ujërat e ndotura, kontrollin për kryerjen e infrastrukturës së nevojshme të kanalizimeve brenda perimetrit të aktivitetit, kontrollin e lidhjes së kanalizimeve brenda perimetrit të aktivitetit dhe lidhjes se tyre me kolektorët e zonës etj.[158]
Task-Forca, pas kryerjes së monitorimit dhe inspektimit, kur konstaton mos vendosjen e impiantit apo sistemit individual në përputhje me rregullat teknike për trajtimin e ujërave të ndotura nga subjektet, merr masat administrative përkatëse.[159]
Nga një numër total rreth 1000 subjekte, deri sot (në të gjitha bashkitë subjekt auditimi), që kanë detyrimin të zbatojnë aktin, vetëm 154 prej tyre kanë përfunduar procesin e instalimit të impiantit individual të trajtimit të ujërave të ndotura. Pra, rezultojnë në total 818 subjekte të identifikuara, të cilat nuk kanë instaluar impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura. Për këto subjekte, sipas parashikimeve të aktit normativ, Task-Forca duhet të kishte vendosur masë administrative me gjobë. Gjatë ushtrimit të vepimtarisë së saj, kjo strukturë ka vendosur një total prej 52 gjobash për shkeljet e konstatuara nga subjektet që nuk kanë zbatuar detyrimet e përcaktuara në këtë akt.

Referuar "data base" së Task-Forcës, në rreth 2400 inspektime, rezultojnë rreth 200 raste kur subjektet e inspektuara i bëjnë shkarkimet e ujërave të ndotura në gropë septike. Akti normativ nr.8 parashikon kontrollin në terren të subjekteve për zëvendësimin e gropave septike me impiante apo sisteme individuale për trajtimin e ujërave të ndotura.[160] Meqenëse "data base" nuk ka informacion të plotë, nga 200 subjekte që rezultojnë me gropë septike, grupi i auditimit ka përzgjedhur në mënyrë rastësore 14 prej tyre, të cilave Task-Forca duhet t'u kishte vendosur masë administrative. Në këto 14 subjekte, Task-Forca ka vendosur masë administrative vetëm për një prej tyre.
Gjatë riinspektimeve të kryera nga grupet e inspektimit në terren të Task-Forcës, disa nga këto subjekte kanë paraqitur aplikimin e bërë për lidhjen e kontratës për vendosjen e impiantit dhe janë informuar që afatet ligjore kanë përfunduar dhe duhet të instalojnë impiantin, në përputhje me afatet ligjore të parashikuar në kontratat respektive. Ndërsa sa i përket rasteve të tjera, gjatë kohës që inspektorët kanë shkuar për riinspektim,disa subjekte kanë rezultuar të mbyllura. Kjo mund të vijë dhe si pasojë që periudha e riinspektimeve përkon me kohën e mbylljes së sezonit turistik.[161] Për të dyja rastet e sipërpërmendura, Task-Forca nuk ka dhënë informacion se sa është numri i këtyre subjekteve.

Gjithashtu, nga të dhënat e "data base", rezultojnë rreth 204 subjekte, të cilave iu është lënë një afat i përcaktuar, nga ana e Task-Forcës gjatë inspektimeve, për vendosjen e impiantit individual të trajtimit të ujërave të ndotura. Nga këto raste, janë përzgjedhur me kampionim, për efekt të këtij auditimi, 20 prej tyre. Pas kalimit të afatit, këto subjekte janë riinspektuar nga Task-Forca. Vetëm për dy prej tyre janë marrë masa administrative, ndërkohë që një subjekti i është lënë afat i ri (nuk ka informacion se çfarë ka ndodhur edhe pas kalimit të afatit të dytë), dy subjekte kanë lidhur kontratën për instalim impianti dhe një subjekt është informuar sërish në lidhje me detyrimet e aktit. Ndërsa për sa i përket pjesës tjetër të subjekteve, ato kanë qenë të mbyllura gjatë kohës shtator-nëntor të vitit ushtrimor 2024, kur inspektorët kanë shkuar për riinspektim.
Akti Normativ nr.8 përcakton, si një nga detyrat e kësaj Task-Force, vendosjen e një tabele për trajtimin ose jo të ujërave të ndotur, në një vend të dukshëm nga publiku, pas kryerjes së

[158] Email nga Task-Forca, datë 18.10.2024
[159] Akt Normativ nr. 8, datë 28.12.2023, "Për marrjen e masave urgjente, për mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës, për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse", neni 8, pika 1&2
[160] Akt Normativ nr. 8, datë 28.12.2023, neni 7, paragraf 1, gërma a, pika ii.
[161] Email nga Task-Forca, datë 26.03.2025

inspektimit apo monitorimit të subjekteve që kryejnë veprimtari ekonomike në zonat bregdetare.[162]

Gjatë punës në terren, Task-Forca ka evidentuar probleme të shumta në njohjen dhe në zbatimin e ligjit nga ana e subjekteve, ndaj fillimi i veprimtarisë konsistoi në informimin dhe ndërgjegjësimin e subjekteve lidhur me legjislacionin në fuqi.[163] Sipas dispozitave të aktit, mosvendosja apo heqja e tabelës dënohet me gjobë.[164] Referuar "data base" së Task-Forcës, në rreth 2400 inspektime, rezultojnë 46 raste kur subjektet e inspektuara kanë refuzuar vendosjen e tabelës për mostrajtimin e ujërave të ndotura. Nga këto 46 raste, janë përzgjedhur me kampionim, për efekt të këtij auditimi, 10 prej tyre. Në këto 10 subjekte, vetëm njëri prej tyre rezulton se, gjatë riinspektimit të kryer nga ana e Task-Forcës, ka lidhur një kontratë për instalimin e impiantit individual.[165] Kurse për 9 subjektet e tjera, Task-Forca i ka vënë në dijeni ato lidhur me aktin normativ dhe detyrimet që rrjedhin nga ai, si dhe se duhet të marrin të gjitha masat për vendosjen e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura.[166] Pra, në lidhje me këto 9 subjekte, të cilat kanë refuzuar vendosjen e tabelës për mostrajtim të ujërave të ndotura, Task-Forca nuk ka marrë masë administrative, siç parashikon neni 8, pika 2 e aktit normativ, por është mjaftuar me informimin e tyre në lidhje me detyrimet që burojnë nga ky akt. Megjithatë, akti normativ nuk parashikon në asnjë dispozitë të tij procesin e informimit apo ndërgjegjësimit të subjekteve nga ana e Task-Forcës lidhur me detyrimet e tyre sipas këtij akti. Për këto situata, i vetmi veprim që parashikohet nga akti, është dënimi me gjobë i këtyre subjekteve.

Task-Forca nuk ka arkëtuar asnjë prej gjobave të vendosura.

Task-Forca, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, ka vendosur një total prej 52 gjobash për shkeljet e konstatuara nga subjektet që nuk kanë zbatuar detyrimet e përcaktuara në aktin normativ.[167] Në tabelën nr. 18 paraqitet numri i gjobave për secilën bashki subjekt auditimi, vlera e tyre në lekë, numri i gjobave të ankimura, vlera e arkëtuar në lekë, numri i subjekteve me gjoba të dyfishta, si dhe numri i subjekteve të mbyllura si rezultat i masave administrative.

Tabela nr. 18 Masat administrative sipas bashkive

Bashkia	Nr. i gjobave	Vlera e gjobave (lekë)	Nr. i gjobave të ankimuara	Vlera e arkëtuar (lekë)	Nr. i subjekteve me gjoba të dyfishta	Nr. i subjekteve të mbyllura si rezultat i masave administrative
Shkodër	12	19,400,000.00	2	-	-	-
Lezhë	3	6,700,000.00	2	-	-	-
Durrës	16	29,100,000.00	4	-	-	-
Kavajë	7	13,200,000.00	4	-	-	-
Rrogozhinë	-	-	-	-	-	-
Lushnje	-	-	-	-	-	-
Fier	-	-	-	-	-	-
Vlorë	13	23,300,000.00	8	-	-	-
Himarë	1	1,900,000.00		-	-	-

Burimi: Taskë Forca e AKUK

Akti normativ parashikon të drejtën e subjekteve të ankimojnë vendimin për marrjen e masave administrative pranë gjykatës kompetente për çështjet administrative.[168] Nga tabela vërehet se,

[162] Akt Normativ nr. 8, datë 28.12.2023, "Për marrjen e masave urgjente, për mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës, për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse", neni 7, pika 1, gërma dh

[163] Email nga Task-Forca, datë 17.03.2025

[164] Akt Normativ nr. 8, datë 28.12.2023, neni 8, pika 2

[165] Email nga Task-Forca, datë 26.03.2025

[166] Email nga Task-Forca, datë 26.03.2025

[167] Email nga Task-Forca, datë 19.12.2024

[168] Akti Normativ nr. 8, datë 28.12.2023, "Për marrjen e masave urgjente, për mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës, për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse", neni 10

nga totali i 52 gjobave të vendosura, 20 prej tyre janë ankimuar nga subjektet. Arsyeja kryesore, ku subjektet kanë mbështetur ankimimin e tyre, është pretendimi lidhur me faktin se këto subjekte janë të lidhur me kolektorët e qytetit dhe i shkarkojnë ujërat e ndotura urbane në impiantin që zotëron Shoqëria Rajonale e Ujësjellës-Kanalizime, ku ata bëjnë pjesë.[169] Në lidhje me këtë pretendim, Task-Forca iu ka bërë me dije se ky rrjet nuk i plotëson standardet për trajtimin e ujërave të ndotura, sipas aktit normativ dhe rregullores teknike.[170] Gjithashtu, subjektet janë sqaruar nga Task-Forca se është konstatuar që gjatë sezonit turistik, duke qenë se numri i turistëve që frekuentojnë qytetin është i lartë, impianti që zotëron Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime është mbingarkuar dhe nga kolapsi shkakton ndotje mjedisore.[171]
Akti normativ nr. 8 përcakton detyrimin për të gjitha subjektet që zhvillojnë veprimtari ekonomike në zonat bregdetare dhe që shkarkojnë ujëra të ndotura të patrajtuara, të vendosin impiantin ose sisteme individuale (brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e tij), me qëllim trajtimin e këtyre ujërave, sipas rregullores teknike[172]. Ndërkohë që, sipas parashikimeve në dispozitat e rregullores teknike[173], çdo subjekt pavarësisht nëse i trajton ujërat e ndotura urbane me anë të sistemit qendror të trajtimit të ujërave urbane, është i detyruar të instalojë një sistem/impiant individual të trajtimit të ujërave të ndotura. Pra, pavarësisht se subjektet paguajnë një tarifë mujore në faturën e ujit, lidhur me menaxhimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, sipas aktit normativ nr. 8, këto operatorë ekonomikë duhet të instalojnë impiante individuale, e cila kërkon një kosto shtesë që duhet të përballohet nga ana e operatorëve ekonomikë. Kjo është edhe arsyeja kryesore që operatorët ekonomikë e kanë kundërshtuar aktin normativ nr. 8 me argumentin se për të njëjtin shërbim duhet të paguajnë dy herë, tarifën e largimit dhe përpunimit që është e përmuajshme dhe që i paguhet shoqërive të UK-ve[174] si dhe ndërtimin e impiantit individual.

Nga tabela nr. 18 vërehet se, nga 32 gjoba të paankimuara, asnjë prej tyre nuk është arkëtuar. Task-Forca, në lidhje me këtë fakt, ka theksuar se një numër i lartë i masave administrative të vendosura me gjobë ndaj subjekteve janë ankimuar pranë gjykatave administrative respektive, duke sjellë si pasojë një fluks të madh pune për juristët e kësaj strukture, në ndjekje të procesve gjyqësore.[175] Ndodhur në kushte të tilla, Task-Forca sqaron se e ka pasur të vështirë fillimin dhe ndjekjen e ekzekutimit dhe arkëtimit të këtyre gjobave, pasi terreni është shumë i gjerë dhe në objekt kontrolli përfshihen shumë subjekte, si dhe veprimtaria e kësaj strukture ka filluar me ndërgjegjësimin e informimin e tyre në lidhje me aktin.[176]
Task-Forca, me vendosjen e masës administrative, u lë një afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh subjekteve përkatëse për plotësimin e standardeve për trajtimin e ujërave të ndotura.[177] Në rast se, pas afatit 60 (gjashtëdhjetë)-ditor, ajo konstaton mosplotësimin e standardeve nga subjektet e dënuara, ajo dënon me gjobë, me vlerë dyfishin e masës së vendosur ndaj subjektit përkatës

[169] Email nga task-forca, datë 19.12.2024, datë 17.03.2025
[170] Email nga Task-Forca, datë 19.12.2024
[171] Email nga Task-Forca, datë 19.12.2024
[172] Udhëzim i Përbashkët nr. 01, datë 01.02.2024 i ministrit përgjegjës për infrastrukturën dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin për miratimin e Rregullores Teknike "Mbi standardet për trajtimin e ujërave të ndotura për subjektet që shkarkojnë ujëra të ndotura të patrajtuara pranë ose në ujëra larëse"
[173] Rregullorja Teknike "Mbi standardet për trajtimin e ujërave të ndotura për subjektet që shkarkojnë ujëra të ndotura të patrajtuara pranë ose në ujëra larëse", neni 6 ku parashikohet se :*"Subjektet që ushtrojnë veprimtari ekzistuese, janë në proces ndërtimi ose kanë aplikuar për leje ndërtimi, në bazë të kapacitetit dhe zgjidhjeve teknike ekzistuese apo që janë planifikuar për* t'u zbatuar, të lidhura ose jo me rrjetin publik te kanalizimeve, duhet të instalojnë impiante të trajtimit të ujërave të ndotura sipas përcaktimeve të kategorive shprehur në nenin 2, të Aktit Normativ nr.8, datë 28.12.2023".
[174] https://erru.al/vendime-per-tarifa/
[175] Email nga Task-Forca, datë 03.04.2025
[176] Email nga Task-Forca, datë 03.04.2025
[177] Akt Normativ nr. 8, datë 28.12.2023, "Për marrjen e masave urgjente, për mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës, për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse", neni 9, pika 1

herën e parë.[178] Nga tabela vërehet se, asnjë subjekti nuk i është vendosur masë administrative gjobë e dyfishtë nga Task-Forca. Me përfundimin e sezonit turistik, kjo Task- Forcë, sipas njoftimit nga ministria përgjegjëse për turizmin, i propozon institucioneve përgjegjëse për marrjen e masave për heqjen e licencë, lejes ose autorizimit, për kryerjen e veprimtarisë ekonomike ndaj të gjitha subjekteve, të cilat nuk kanë plotësuar standardet për trajtimin e ujërave të ndotura edhe pas marrjes së masës administrative.[179] Në këtë rast, nuk ka subjekte që janë mbyllur si rezultat i masave administrative. Kjo për arsye se ka marrë në konsideratë faktin që ka evidentuar probleme të shumta në njohjen dhe në zbatimin e ligjit nga ana e subjekteve, si dhe vështirësitë ekonomike që ato kanë hasur.

18. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka detyrim respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore duke ushtruar kontrolle e monitorime në subjekte që shkarkojnë dhe trajtojnë ujëra të ndotura si për subjekte që janë të pajisur me leje mjedisi ashtu edhe për subjekte që nuk janë të pajisur me leje mjedisi. Nga auditimi u konstatua se, përgjatë periudhës 2020-2023, në territorin e bashkive subjekt auditimi, AKM nuk ka ushtruar kontrolle dhe inspektime në subjekte që shkarkojnë dhe trajtojnë ujëra të ndotura urbane pavarësisht nëse ato janë apo jo të pajisur me leje mjedisi. Inspektimet e vetme të bëra nga ana e AKM-së në territorin e bashkive subjekt auditimi janë ato në ITUN-in e Vlorës dhe Himarës, por edhe këto jo me fokus trajtimin e ujërave të ndotura urbane. Kjo situatë tregon se nuk i është dhënë prioritet procesit të shkarkimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mungesa e inspektimeve për respektimin e kushteve dhe standardeve mjedisore të procesit të përpunimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura cënon drejtpërsëdrejti cilësinë e mjedisit, duke qenë se ujërat e ndotura të patrajtuara ndotin mjedisin ku ato shkarkohen.

19. Gjetje nga auditimi: Dispozitat e aktit normativ nr 8, datë 28.12.2023 gjejnë zbatim për subjektet që zhvillojnë veprimtari ekonomike, në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve dhe që shkarkojnë ujëra të ndotura të patrajtuara, pranë ose në ujërat larëse. Megjithatë në aktin normativ nuk ka një përkufizim, për sa i përket termit "zonë bregdetare". Identifikimi i subjekteve, që janë pjesë e fushës së zbatimit të aktit, është një proces i realizuar, pa përcaktuar saktësisht (për secilën bashki) territorin ku shtrihet veprimtaria e Task- Forcës. Në këtë mënyrë cënohet zbatimi i aktit normativ nr.8, e për pasojë bëhet e pamundur përmbushja e qëllimit për të cilin është ai është miratuar.

20. Gjetje nga auditimi: Akti normativ nr. 8, datë 28.12.2023 përcakton si një nga detyrat e kësaj Task-Force, "*mbledhjen e informacionit dhe krijimin e një "data "për të dhënat e të gjitha subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike dhe shkarkojnë ujëra të ndotura të trajtuara dhe të patrajtuara pranë ose në ujërat larëse*". Nga auditimi rezultoi se Task-Forca ka krijuar një bazë të dhënash që përmbledh inspektimet dhe kontrollet e kryera nga grupet e inspektimit në terren lidhur me trajtimin e ujërave të ndotura. Megjithatë, kjo bazë të dhënash nuk pasqyron saktësisht numrin e subjekteve që kanë detyrimin për të zbatuar aktin normativ nr. 8, datë 28.12.2023 dhe nuk përmban informacion të plotë mbi të dhënat identifikuese të këtyre subjekteve. Pasaktësia e të dhënave lidhet kryesisht me mungesën e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional. Konkretisht, edhe pse Task-Forca ka kërkuar informacion nga Shoqëritë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizimeve në lidhje me subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike, nuk ka marrë të dhëna të sakta apo ndonjë listë referuese të bizneseve të regjistruara nga ana e tyre. Gjithashtu, Task-Forca nuk ka kërkuar të dhëna apo informacione nga institucione të tjera që kanë pasur ndër vite përgjegjësi për identifikimin e subjekteve që shkarkojnë apo trajtojnë ujëra të ndotura, si Agjencia Kombëtare e Mjedisit apo Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Nga analiza e të dhënave të përfshira në "data base" rezultuan raste të subjekteve pa

[178] Akt Normativ nr. 8, datë 28.12.2023, neni 9, pika 2
[179] Akt Normativ nr. 8, datë 28.12.2023, neni 9, pika 3

emër, pa NIPT, si dhe subjekte të evidentuara me statusin "të mbyllura", për të cilat Task-Forca nuk zotëron informacion nëse vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet apo jo.

21. Gjetje nga auditimi: Sipas planit të masave për sezonin turistik veror 2023, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka detyrimin të publikojë në faqen zyrtare të saj të dhëna mbi strukturat akomoduese, të klasifikuara sipas shpërndarjes gjeografike dhe destinacioneve turistike. Në vitin 2019, kjo ministri ndërmori një proces të kategorizimit të strukturave akomoduese, duke gjeneruar të dhëna të detajuara sipas qyteteve, përfshirë numrin total të strukturave, llojin dhe kapacitetet e tyre (në dhoma dhe shtretër). Nga auditimi rezultoi se, me përjashtim të vitit 2019, Ministria nuk disponon të dhëna të përditësuara për periudhën 2020–2023 në lidhje me numrin e strukturave akomoduese që janë në funksion dhe që potencialisht gjenerojnë ujëra të ndotura.

22. Gjetje nga auditimi: Akti normativ nr.8, datë 28.12.2023 parashikon detyrimin për të gjitha subjektet që zhvillojnë veprimtari ekonomike që, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ, të vendosin impiantin ose sisteme individuale, me qëllim trajtimin e ujërave të ndotura. Task-Forca, pas kryerjes së monitorimit dhe inspektimit, kur konstaton mos vendosjen e impiantit apo sistemit individual për trajtimin e ujërave të ndotura nga subjektet, merr masat administrative përkatëse. Kjo Task-Forcë, gjatë vitit 2024 ka identifikuar rreth 1000 subjekte (në bashkitë subjekt auditimi), që kanë detyrimin të zbatojnë aktin, por vetëm 154 prej tyre kanë përfunduar procesin e instalimit impiantit individual të trajtimit të ujërave të ndotura. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, kjo strukturë ka vendosur në total 52 gjoba për shkeljet e konstatuara nga subjektet, që nuk kanë zbatuar detyrimet e përcaktuara në këtë akt. Nga auditimi rezulton se, për rreth 800 subjekte, të cilat nuk kanë instaluar impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura urbane, Task-Forca nuk ka vendosur masë administrative me gjobë.

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, Task-Forca nuk ka arkëtuar asnjë prej 52 gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara nga subjektet që nuk kanë zbatuar detyrimet e përcaktuara në aktin normativ. Nga totali i 52 gjobave, 20 prej tyre janë ankimuar nga subjektet. Në lidhje me arkëtimin e 32 gjobave të paankimuara, Task-Forca ka theksuar se e ka pasur të vështirë fillimin dhe ndjekjen e ekzekutimit dhe arkëtimit të këtyre gjobave, pasi terreni është shumë i gjerë dhe në objekt kontrolli përfshihen shumë subjekte, si dhe veprimtaria e kësaj strukture ka filluar me ndërgjegjësimin e informimin e tyre në lidhje me aktin.
Task-Forca nuk ka proceduar me vendosjen e masave administrative gjobë e dyfishtë për subjektet që janë objekt kontrolli i kësaj strukture, si dhe me propozimin organeve përgjegjëse për heqjen e licencës, të lejes ose të autorizimit për kryerjen e veprimtarisë ekonomike ndaj subjekteve që nuk kanë plotësuar standardet edhe pas vendosjes së masave administrative. Kjo situatë ka ardhur për shkak se Task-Forca ka marrë në konsideratë faktin që ka evidentuar probleme të shumta në njohjen dhe në zbatimin e ligjit nga ana e subjekteve, si dhe vështirësitë ekonomike që ato kanë hasur.

Konkluzion 11: Veprimtaria e Taskë Forcës nuk ka rezultuar efektive duke qenë se vetëm 154 nga rreth 1000 subjekte kanë vendosur impiantit individual të trajtimit të ujërave të ndotura kur detyrimi i këtij akti ka qenë që për brenda muajit mars 2024 të gjithë operatorët ekonomikë të vendosnin këto impiante. Vetë akti normativ ka mangësi të theksuara sa i përket mënyrës së zbatimit të tij duke qenë subjektiv në drejtim të përzgjedhjes së operatorëve duke qenë se nuk përcakton qartë nëse subjektet/operatorët ekonomikë ndodhen në zonë bregdetare apo jo. Kusht kryesor për vendosjen e impianteve individuale të trajtimit të ujërave të ndotura është nëse operatorët ekonomikë janë në apo pranë zonave bregdetare. Mos përcaktimi i qartë i këtij detyrimi në këtë akt nënligjor, krijon subjektivizëm nga zbatuesit e tij. Mangësi të theksuara janë vërejtur edhe në *data-base* e krijuar nga Taskë-Forca duke qenë se nuk ka bashkëpunuar me institucione të tjera (si Ministria e Turizmit dhe Mjedisit apo Agjencia Kombëtare e Mjedisit) për të identifikuar sa më saktë operatorët ekonomikë që duhet të jenë subjekt i zbatimit të aktit normativ nr. 8.

18.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa që të kontrollojë dhe inspektojë subjektet që gjenerojnë, shkarkojnë dhe trajtojnë ujëra të ndotura urbane, me qëllim respektimin e kushteve, kritereve dhe standardeve mjedisore.

Në vijimësi

19.1 Rekomandimi: Task-Forca e ngritur në zbatim të Aktit normativ nr 8, datë 28.12.2023 të marrë masa, që në funksion të përkufizimit të zonës bregdetare, të përcaktojë saktësisht territorin gjeografik ku shtrihet veprimtaria e saj për të gjitha bashkitë ku gjen zbatim akti normativ nr. 8 datë 28.12.2023.

Menjëherë

20.1 Rekomandimi: Task-Forca të marrë masa për përmirësimin e cilësisë dhe saktësisë së bazës së të dhënave mbi subjektet që trajtojnë ose shkarkojnë ujëra të ndotura, duke forcuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit me Shoqëritë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizimeve, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Ministrinë e Mjedisit, me qëllim sigurimin e një liste të plotë, të përditësuar dhe të verifikuar të subjekteve të regjistruara që ushtrojnë veprimtari ekonomike dhe kanë detyrimin për trajtimin e ujërave të ndotura.

Brenda vitit 2025 e në vijimësi

20.2 Rekomandimi: Task-Forca të marrë të gjitha masat që të planifikojë kryerjen e inspektimeve në terren gjatë sezonit turistik për të minimizuar rastet e gjetjes mbyllur të operatorëve ekonomikë që duhet të vendosin impiantin individual të trajtimit të ujërave të ndotura.

Në vijimësi

21.1 Rekomandimi: Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit të marrë masa për përditësimin dhe publikimin e rregullt të të dhënave mbi strukturat akomoduese, sipas shpërndarjes gjeografike dhe destinacioneve turistike.

Mars 2026

22.1 Rekomandimi: Task-Forca të marrë masa për të siguruar pajisjen me impiante individuale të 818 subjekteve që aktualisht nuk i kanë instaluar ato. Në rast të moszbatimit të këtij detyrimi nga subjektet përkatëse, Task-Forca të aplikojë masa administrative në përputhje me parashikimet e akteve ligjore ne fuqi.

Mars 2026

23.1 Rekomandimi: Task-Forca të marrë të gjitha masat e nevojshme për arkëtimin e 32 gjobave të vendosura dhe të paankimuara nga subjektet. Në rastet kur, edhe pas aplikimit të masave administrative, subjektet nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore, Task-Forca të procedojë me vendosjen e gjobës së dyfishtë.

Mars 2026

4.2.4 A janë zbatuar standardet mjedisore të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane në bashkitë subjekt auditimi?

Disa prej ITUN-eve nuk janë ose nuk kanë qenë të pajisur me leje mjedisi.

Sipas përcaktimeve ligjore për lejen dhe mbrojtjen e mjedisit impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane duhet të jenë të pajisura me leje mjedisi .[180] Agjencia Kombëtare e Mjedisit garanton respektimin e kushteve të lejeve të mjedisit. Impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urvane duhet të jenë të pajisur me Leje Mjedisi të Tipit B dhe kapaciteti i tyre duhet të përmbajë

[180] Ligj Nr. 8934, datë 14.7.2002 Për Lejet e Mjedisit, i ndryshuar, neni 34, pika 4, .

të gjitha instalimet për trajtimin e llumrave të gjeneruara prej tyre.[181] Leja e mjedisit ka si qëllim kryesor të sigurojë që aktivitetet ekonomike, industriale apo ndërtimore të zhvillohen në përputhje me standardet dhe legjislacionin mjedisor, duke minimizuar ndikimet negative ndaj mjedisit dhe shëndetit të njerëzve.[182] Leja mjedisit është e domosdoshme për përfitimin e të drejtës lidhur me funksionimin e instalimit të cituar në leje.[183] Përmes saj synohet të parandalohen ndotjet e ajrit, ujit dhe tokës. Në rastin e ITUN-eve, leja e mjedisit siguron që ato të respektojnë kërkesat ligjore dhe të ndërmarrin masa për të reduktuar çdo ndikim potencial negativ.

Siç është përmendur edhe në pyetjen audituese 4.2.1, ekzistojnë 9 impiante trajtimi të ujërave të ndotura në territorin e bashkive subjekt auditimi. Nga këto 9 impiante, nga të dhënat e siguruara, 3 prej tyre nuk kanë leje mjedisi dhe konkretisht këto impiante janë ai i Kavajës, Vlorës dhe i Dhrales në Dhërmi. Në mënyrë të detajuar, për secilin prej impianteve situata paraqitet si më poshtë:

ITUN-et e Vlorës, Palasës dhe Dhrale në Dhërmi - gjatë vizitave në terren me përfaqësues së UKV-së në ITUN Vlorë, si dhe nga informacionet e marra nga AKM dhe AKUK[184], grupi i auditimit ka konstatuar se, pavarësisht se impianti i Vlorës dhe Dhrales operojnë, ata nuk janë të pajisur me lejen e mjedisit. Ndërsa, ITUN-i i Palasës është pajisur me leje mjedisi.

ITUN-i i Kavajës - nga verifikimet dhe takimet e kryera nga grupi i auditimit në korrik të vitit 2024, me përfaqësues të UK-Durrës (i cili mbikëqyr ITUN-in e Kavajës), është konstatuar se ky impiant nuk ka qenë funksional[185] prej tre vitesh dhe nuk ka dokument që vërteton pajisjen me leje mjedisi.

ITUN-et e Durrësit, Lalëzit dhe Lezhës janë pajisur me leje mjedisi në vitin 2023.[186] Grupit të auditimit i është bërë me dije se impianti i Durrësit ka funksionuar që në vitin 2013,[187] ndërsa ai i Lezhës është vënë në shfrytëzim në vitin 2014. Megjithatë, nga konfirmimi i AKM-së si dhe UK-ve rajonale, këto impiante nuk kanë qenë të pajisura me leje mjedisi përpara vitit 2023.[188] Ndërkohë dy *ITUN-et e Shkodrës* (Shiroka dhe Velipoja) janë pajisur me leje mjedisi që prej vitit 2013.

Impiantet individuale të trajtimit të ujërave të ndotura urbane nuk janë të pajisura me leje mjedisi.[189]

Në ligjin për lejet e mjedisit[190], përcaktohet se të gjitha instalimet për impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane duhet të jenë të pajisura me leje mjedisi. Për sa i përket pajisjes së impianteve individuale me leje mjedisore, grupi i auditimit ka konstatuar se të 154 impiantet/instalimet individuale të cituara më sipër nuk janë të pajisura me këtë leje. Në takimet dhe intervistat me AKM-në, grupit të auditimit i është bërë me dije se, asnjë prej subjekteve që kanë vendosur impiante individuale të trajtimit të ujërave të ndotura, nuk ka bërë kërkesë për pajisjen me leje mjedisi. Task Forca mban qëndrimin se, referuar aktit normativ nr. 8 dt., 28.12.2023, këto impiante nuk kanë detyrimin të pajisen me leje mjedisi.[191] Pavarësisht qëndrimit të Task-Forcës, akti normativ nuk ka detyrimin të bëj një përcaktim të tillë, për sa kohë ekziston një ligj i posaçëm që rregullon çështjet për lejen mjedisore

[181] Ligj Nr. 10 448, datë 14.7.2011, i ndryshuar, Për Lejet e Mjedisit, Shtojca 1, kategoria 6.1.
[182] Ligj Nr. 10 448, datë 14.7.2011, i ndryshuar, Për Lejet e Mjedisit, neni 1.
[183] Ligj Nr. 10 448, datë 05.09.2011 Për Lejet e Mjedisit, i ndryshuar, neni 3, pika 13.
[184] Kthim përgjigje pyetësorit datë 20.01.2025.
[185] Kthim përgjigje pyetësorit të dërguar në datë 20.12.2024
[186] Leje mjedisore Lalëz datë 30.03.2023, me nr. prot., 2166, nr. identifikimi të Lejes 4434, Durrës datë 16.06.2023, nr. 3913 Prot., nr. identifikimi të lejes 4508, Lezhë me Leje Mjedisore nr. 4013/1, datë 18.07.2023, nr. prot., 4600.
[187] Kthim përgjigje pyetësorit datë 12.09.2024
[188] Email: ITUN Durrës, dt 21.04.2025
[189] Sqarim: Kjo nen çështje trajton mos pajisjen e impianteve individuale me leje mjedisi.
[190] Ligj Nr. 10 448, datë 05.09.2011 Për Lejet e Mjedisit, Shtojca 1, pika 6.1.
[191] Burimi nga të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit datë 19.12.2024.

ITUN-et me leje mjedisi nuk kanë dorëzuar periodikisht raportet e vetëmonitorimit.

Impiantet e trajtimit të ujërave urbane, të cilat janë të pajisura me leje mjedisi, kanë detyrim plotësim e kushteve të përcaktuara në to. Për të parë nëse këto kushte janë plotësuar, ato kanë detyrim ligjor të kryejnë vetëmonitorim. Subjektet që administrojnë impiantet të cilat janë të pajisura me leje mjedisi, kanë detyrimin që të dorëzojnë periodikisht pranë AKM-së, raportet e vetëmonitorimit.[192] Grupi i auditimit ka kërkuar nga AKM raportet e vetëmonitorimit (6 mujore dhe vjetore) sipas përcaktimit të lejes së mjedisit, që impiantet zotërojnë.

Bashkia e Himarës e cila administron impiantin "Dhralë-Palasë"[193], është i pajisur me leje mjedisore në vitin 2017. Në kushtin nr. 12 të lejes së mjedisit përcaktohet detyrimi i raportimit në AKM në mënyrë periodike çdo 6 muaj. Nga të dhënat e siguruara nga AKM, rezulton se nuk ka dokument vërtetues mbi dërgimin e raportit të vetëmonitorimit përgjatë periudhës 2019-2022. Konkretisht, Bashkia Himarë ka dorëzuar dy raporte të vetëmonitorimit, pranë AKM, për periudhën:

- Mars 2023 – Shtator 2023;
- Dhjetor 2023 – Qershor 2024.

Për sa i përket impiantit të Lezhës, nga të dhënat e siguruara nga AKM, rezulton se Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë (e cila administron këtë impiant) nuk ka raportuar periodikisht për periudhën 2019-2021. SHRUK Lezhë ka dorëzuar raportin e vetëmonitorimit, pranë AKM, për periudhën:

- Prill 2022 – Tetor 2022;
- Tetor 2022 – Prill 2023;
- Prill 2023 – Tetor 2023.

Impianti i Velipojës i administruar nga SHRUK Shkodër është i pajisur me leje mjedisi në vitin 2013.[194] Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga AKM, është konstatuar se SHRUK Shkodër nuk ka raportuar periodikisht mbi procesin e vetëmonitorimit të këtij impianti. SHRUK Shkodër ka dorëzuar raportin e vetëmonitorimit pranë AKM vetëm për periudhën:

- Nëntor 2022 – Maj 2023;
- Maj 2023 – Nëntor 2023;
- Dhjetor 2023 – Qershor 2024.

Impianti i Shirokës i administruar nga SHRUK Shkodër është i pajisur me leje mjedisi në vitin 2014. Në kushtin nr. 6 të lejes mjedisore, përcaktohet detyrimi i raportimit në AKM në mënyrë periodike çdo 6 muaj.[195] Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit është konstatuar se, raportimi nuk është kryer në mënyrë periodike. Konkretisht, SHRUK Shkodër ka dorëzuar raportin e vetëmonitorimit pranë AKM vetëm për periudhën:

- Gusht 2020 – Shkurt 2021;
- Prill 2022;
- Gusht 2022 – Shkurt 2023;
- Gusht 2023 – Shkurt 2024.

SHRUK Durrës e cila administron ITUN-et në Durrës të pajisur me leje mjedisi në vitin 2023 nuk ka dorëzuar në AKM asnjë raport vetëmonitorimi që pas marrjes së lejeve të mjedisit.[196]

[192] VKM Nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a dhe b, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit,si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja", kreu III, pika 9, gërma "gj".

[193] Leje Mjedisi PN-4545-01.2017

[194] Leje Mjedisi në datë 10.12.2013, nr. prot., 9139 ka një kapacitet prej 15800 m³/ditë.

[195] Leje Mjedisi nr. 8761 prot., datë 21.08.2014

[196] ITUN Durrës me leje mjedisi PN-1836-06-2023. ITUN Lalëz me leje mjedisi PN-1722-03-2023.

Leja e mjedisit e ITUN-it të Velipojës nuk është e përditësuar me kërkesat ligjore
Ndryshimet në ligjin nr. 108/2024, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011, 'Për lejet e mjedisit'", përcaktojnë se edhe lejet e lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij akti duhet të përditësohen në përputhje me kërkesat e reja, në mënyrë që të sigurohet unifikimi i praktikës ligjore dhe forcimi i mekanizmave të mbrojtjes së mjedisit. Në mbështetje të këtij ligji është VKM-ja nr. 419, datë 25.06.2014[197], ku përcaktohet formati që duhet të përmbajë leja e mjedisit, me të dhënat e detyrueshme mbi parametrat e shkarkimeve që gjenerohen nga impiantet. Leja e mjedisit e Velipojës nuk është e përditësuar sipas formatit të përcaktuar në këtë VKM. Leja mjedisore e impiantit të Velipojës nuk përcakton vlera kufi për shkarkimet e ujërave sipas përcaktimit në VKM-në nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse". Konkretisht, në kushtin nr. 4 të lejes mjedisore të impiantit të Velipojës, ku duhet të pasqyrohen qartë këto informacione, është shënuar se "nuk aplikohen norma", çka tregon mungesë të plotë të përputhshmërisë me kriteret ligjore të sipërcituara.

24. Gjetje nga auditimi: Referuar ligjit për lejet e mjedisit, impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN) duhet të pajisen me Leje Mjedisi të Tipit B. ITUN-i i Vlorës dhe i Kavajës nuk janë të pajisur me leje mjedisi edhe pse duhet theksuar se ITUN-i i Kavajës nuk është funksional prej 3 vitesh. Mungesa e lejes së mjedisit nuk garanton respektimin e kushteve dhe standardeve mjedisore përgjatë procesit të trajtimit të ujërave të ndotura urbane.

25. Gjetje nga auditimi: Referuar ligjit për lejet e mjedisit, impiantet individuale, duhet të jenë të pajisura me lejen e mjedisit. Impiantet individuale të trajtimit të ujërave të ndotura urbane të vendosura nga subjektet që operojnë pranë zonave bregdetare nuk janë pajisur me leje mjedisi. Këtyre subjekteve nuk i është kërkuar deri më sot pajisja me leje mjedisi nga ana e Task-Forcës, e cila është edhe institucioni kryesor i angazhuar në instalimin impianteve individuale në subjektet që operojnë pranë zonave bregdetare.

26. Gjetje nga auditimi: Impiantet nën administrimin e SHRUK-ve Durrës, Shkodër, Vlorë dhe bashkisë Himarë që zotërojnë leje mjedisore nuk kanë dorëzuar periodikisht në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, raportet e vetëmonitorimit, veprime në mos përputhje me kushtet e lejeve të mjedisit, ku përcaktohet detyrimi i subjekteve që të dorëzojnë raportet e vetëmonitorimit çdo 6 muaj. Konkretisht, Bashkia Himarë nuk ka dorëzuar raportin e vetëmonitorimit përgjatë periudhës 2019-2022 për impiantin e "Dhralë-Palasë". SHRUK Lezhë nuk ka dorëzuar në AKM raportet e vetëmonitorimit përgjatë periudhës 2019-2021 për impiantin e Lezhës. Ndërsa, SHRUK Shkodër për impiantin e Velipojë nuk ka dorëzuar raportin e vetëmonitorimit për periudhën 2019-2021. SHRUK Durrës nuk ka dorëzuar asnjë raport monitorimi pranë AKM-së për impiantet e Durrësit dhe Lalëzit, që prej pajisjes së këtyre impianteve me leje mjedisi në vitin 2023.

27. Gjetje nga auditimi: VKM nr. 419, datë 25.06.2014 përcakton formatin standard që duhet të kenë lejet e mjedisit, duke përfshirë të gjitha të dhënat e detyrueshme si, parametrat ose nivelet kufi të shkarkimeve. Në këtë VKM parashikohet detyrimi për përditësimin në përputhje me formatin e ri të përcaktuar për të gjitha lejet e dhëna para hyrjes në fuqi të saj. Nga auditimi ka rezultuar se, leja e mjedisit e impiantit të Velipojës nuk është përditësuar nuk është përditësuar në përputhje me kërkesat e këtij vendimi. Mungesa e përditësimit sipas formatit të përcaktuar në VKM nr. 419, datë 25.06.2014 cenon përmbushjen e kërkesave teknike dhe nuk garanton respektimin e normave mjedisore të shkarkimit, duke riskuar cilësinë e ujërave të ndotura të trajtuara nga ky impiant.

[197]VKM Nr. 419, datë 25.06.2014, Shtojca 1.

Konkluzion 12: Standardet mjedisore të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura cënohen nga mungesa e lejeve mjedisore në disa prej impianteve, mosrespektimi i kushteve të lejeve mjedisore ekzistuese, mungesa e raportimeve periodike si dhe mos inspektimi i subjekteve që shkarkojnë e trajtojnë ujëra të ndotura urbane. Këto çështje përbëjnë një pengesë serioze për zbatimin e standardeve mjedisore.

Rekomandimi 24.1: Shoqëritë Rajonale të Ujësjellës Kanalizimeve Vlorë dhe Durrës të marrin masa për pajisjen me lejen përkatëse të mjedisit për impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane Vlorë dhe Kavajë.

Mars 2026

25.1 Rekomandimi: Taskë-Forca në bashkëpunim me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit të marrë masa për njoftimin dhe detyrimin e pajisjes me leje mjedisi të subjekteve private që vendosin impiante individuale për trajtimin e ujërave të ndotura.

Mars 2026

26.1 Rekomandimi: Shoqëritë Rajonale të Ujësjellës Kanalizimeve Shkodër, Durrës, Lezhë si dhe bashkia Himarë të marrin masa për të siguruar dorëzimin e raportit të vetëmonitorimit çdo 6 muaj pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, sipas përcaktimeve në kushtet e lejes mjedisore të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura, që ato administrojnë.

Në vijimësi

27.1 Rekomandimi: Shoqëria Rajonale e Ujësjellës-Kanalizimeve Shkodër, të marrë masa për përditësimin e lejes mjedisore të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në Velipojë, e cila të sigurojë përfshirjen e të gjitha të dhënave të detyrueshme, veçanërisht parametrat teknikë dhe normat kufi të shkarkimeve, me qëllim garantimin e monitorimit të saktë dhe mbrojtjen e cilësisë së ujërave të trajtuara.

Mars 2026

5. ANEKSI 1. Rezultatet e vlerësimit të parametrave mikrobiologjike në territorin e bashkive subjekt auditimi[198]

Bashkitë	Nr	Plazhet	2019		2020		2021		2022		2023	
			FC[199]	IE[200]	FC	IE	FC	IE	FC	IE	FC	IE
SHKODËR	1	B-R B.	88	86	44	23	124	139	163	159	49	51
	2	Hotel A.	42	29	39	23	148	91	224	168	52	106
	3	B-R F.	30	29	41	27	133	84	238	186	71	151
	4	Hyrja Plazh	34	36	49	38	130	137	130	474	84	135
	5	Pallatet e Reja	73	88	41	31	117	68	236	200	131	117
	6	D. V.	49	64	37	27	101	74	236	214	185	200
	7	Prane Lagunes Vilunit	56	42	58	47	83	54	218	154	126	216
LEZHË	8	Ish kabinat	52	74	80	60	124	86	192	176	255	191
	9	Hotel "D"	46	48	75	65	115	122	184	194	221	251
	10	Hotel "K"	41	48	106	116	125	86	194	218	317	418
	11	B-R Gj.	34	27	59	42	120	136	202	213	476	570
	12	Kune	39	36	77	75	93	106	230	166	231	268
	13	Hyrja qendrore, djathtas, tek Palmat	23	14	31	33	70	64	271	286	144	218
	14	Në qëndër të hyrjes qëndrore, tek Antena	23	13	24	26	70	67	327	263	107	137
	15	Majtas hyrjes qëndrore, Bar-Restorant USA	27	15	28	31	97	64	204	180	152	267
DURRËS	16	Plazhi Currila 1	91	85	56	57	125	110	171	175	391	205
	17	Plazhi Currila 2	68	54	53	71	141	135	134	149	209	153
	18	Plazhi Zhiron (Kështjella)	306	208	379	336	756	595	1941	3159	950	763
	19	Ura e Dajlanit	78	75	39	42	174	97	193	169	581	447
	20	Plazhi F. (Hotel & SPA P.)	62	86	26	20	85	74	184	177	295	280

[198] Burimi: ISHP. Me ngjyrë të kuqe janë plazhet që kanë rezultuar me cilësi të keqe ose Kategori D.
[199] FC: escheria coli
[200] IE: enterococcus

	21	Plazhi T. V. (Hotel V.)	67	67	37	37	88	56	157	141	264	234
	22	Plazhi G. (Piceri-Restorant G.)	153	234	37	29	147	133	147	126	313	188
	23	A. (Hotel C-G)	151	226	42	30	228	215	187	173	302	205
	24	Hekurudha (tek Policia)	107	123	46	62	167	162	192	159	267	180
	25	Hotel A.	85	79	25	21	66	49	152	131	169	121
	26	Plazhi Iliria (Pista)	55	50	27	32	109	94	127	105	182	105
	27	Iliria pranë Bllokut (Hotel Vila L.)	95	81	26	25	133	104	95	81	174	152
	28	Ministria e Rendit	57	89	21	16	102	118	74	59	117	155
	29	Kompleksi T.	82	101	67	51	94	95	384	273	327	288
	30	Pas Kanalit (Plepa)	704	821	569	449	790	749	3856	3375	2887	2682
	31	Shkëmbi i Kavajës (Restorant T.)	267	336	89	64	218	148	1674	1464	928	880
	32	Bar-Hotel H.	138	128	65	43	133	112	954	788	374	387
	33	Plazhi B.	143	211	54	29	123	100	276	243	304	361
	34	Plazhi Hotel A.	144	87	43	33	132	97	152	138	358	269
	35	Kompleksi X.	103	87	33	25	154	116	146	131	501	329
	36	Kompleksi Xh.	179	138	57	60	206	155	376	400	514	576
	37	Kepi i Rodonit	54	41	27	40	65	72	145	136	77	42
	38	Fshati Turistik L.	60	37	29	34	87	67	164	201	79	55
	39	Plazhi Pubik pas Lurës	56	51	39	53	102	58	138	151	77	120
	40	Gjiri Lalzit 4- Kompleksi A.	53	52	30	26	53	54	113	117	138	118
	41	Gjiri Lalzit 5- Fshati Turistik L. 3	89	77	46	37	105	64	132	131	205	172
KAVAJË	42	M.	127	137	61	61	190	162	458	616	1384	1718
	43	V.	116	127	49	46	165	140	448	518	1214	1416
	44	Golem-Kosmira	87	84	44	59	132	116	310	395	1107	1294
	45	Vapori mbytur	82	92	72	58	262	218	221	202	2877	4750

	46	Kompleksi FAFA (ish Piceri J.)	79	66	68	70	125	120	167	141	189	117
	47	Piceri A.	75	85	56	67	190	195	212	86	167	102
	48	M. A.	64	45	77	74	288	347	224	221	462	347
	49	Lokali R.	56	44	56	68	242	244	210	337	462	138
	50	Bunkeri Bardhë	63	52	61	71	198	175	224	257	138	110
	51	Qerret, Ish Fusha Sportit	55	68	30	33	118	118	170	140	2328	804
	52	Qerret, Kompleksi B.	75	73	32	29	115	126	216	212	3198	1159
	53	Qerret, Bar-Kafe H.	78	74	65	79	133	147	272	283	4412	1758
RROGOZHINË	54	Spille Djathtas, Bar-Rest. M.	59	51	33	39	114	113	87	90	293	327
	55	Spille Qender, Hotel B.	57	62	44	56	202	258	253	308	286	326
	56	Greth i Mesëm, Palmat e fundit	60	78	64	81	233	219	112	114	345	344
VLORË	57	Plazhi i Vjetër, Kampi i Pionierëve	124	184	290	141	388	375	1187	1953	295	447
	58	Plazhi i Vjetër, Kabinat	114	137	200	175	344	355	1039	1473	304	500
	59	Shkolla e Marinës	637	497	415	329	520	500	4953	5929	965	1191
	60	Plazhi i Ri	176	259	160	145	260	241	1467	2526	499	814
	61	Ish Vilat, Blloku	30	20	35	39	53	52	165	150	66	100
	62	Jonufër	59	29	22	16	120	76	213	231	120	255
	63	Plazhi P.	26	11	17	15	42	33	66	106	59	83
	64	Plazhi L. B.	40	15	28	26	54	42	93	95	55	80
	65	Radhimë, Hotel G.	30	24	31	25	57	43	203	238	117	183
	66	Lokali B.	38	38	31	25	59	59	531	953	212	295
	67	Para Xh. (djathtas)	28	16	53	42	194	243	215	237	67	97
	68	Bar-Restorant O. (ne mes)	33	55	48	31	228	258	208	188	101	99

	69	Bar-Restorant K. (majtas)	47	35	56	31	191	198	214	154	141	83
	70	Kompleksi O.	27	13	65	73	97	94	153	191	110	193
	71	Bar- Restorant A.	22	19	58	71	88	102	208	279	133	307
	72	Para Repartit Pashaliman	14	9	46	43	73	68	209	143	87	178
HIMARË	73	Palasa 1	5	4	13	3	15	14	48	10	30	30
	74	Palasa 2	5	4	12	3	15	15	57	30	37	28
	75	Plazhi te L.	5	7	18	6	47	30	74	48	89	44
	76	Hotel A.	89	135	34	27	55	66	99	130	270	165
	77	Kampi i Punëtorëve	18	12	67	69	55	75	113	199	66	28
	78	Plazhi i Drimadhes 1	14	18	40	43	74	93	73	111	187	80
	79	Plazhi i Drimadhes 2	18	10	38	42	76	98	79	90	154	81
	80	Borshi djathtas	67	53	59	69	71	88	106	117	73	76
	81	Borshi në mes	70	47	71	55	68	69	133	125	118	105
	82	Borshi majtas	34	27	55	48	141	123	93	89	82	75
	83	Qeparo majtas	97	71	58	62	194	108	121	194	132	122
	84	Qeparo djathas	71	59	66	57	159	123	155	415	168	167
	85	Himarë Qendër	105	77	56	45	104	88	459	1237	182	161
	86	Pas Shkëmbit	114	134	45	29	86	104	291	832	115	106
	87	Potam A.	46	39	45	25	72	53	86	149	80	51
	88	Hotel L.	103	70	32	14	65	70	113	159	118	89
	89	Plazhi Livadhe 1	36	21	17	8	66	36	86	165	52	74
	90	Plazhi Livadhe 2	34	11	19	6	42	42	72	113	64	55
	91	Plazhi Livadhe 3	22	8	15	4	40	39	72	78	67	51
	92	Jalë majtas	9	35	20	21	132	49	54	61	92	86
	93	Jalë djathas	9	9	30	14	84	75	62	51	73	81
	94	Lukova djathtas	23	9	21	8	68	79	62	89	72	91
	95	Lukova në mes	30	22	16	9	67	69	75	99	55	78
	96	Lukova majtas	20	10	16	11	56	94	60	98	49	59

FIER	97	Hyrja në plazh, tek Policia, Bunkeri	61	44	44	80	147	50	215	183	246	130
	98	Kulla e Ujit	71	38	56	60	131	58	270	198	215	89
	99	Plazhi Darzezë	69	33	59	59	102	46	225	157	138	140
	100	Lokali Gj. Seman							150	149	125	260
	101	Bar restorant 4 F. Seman							117	111	73	87
	102	Lokali I. L. Darzezë							254	238	63	72
	103	Ish reparti ushtarak Pish Poro							141	150	120	148
	104	Hyrja në plazh, tek Policia	45	43	64	111	125	65	154	142	196	195
	105	Hyrja kryesore në plazh	98	70	77	90	82	43	211	168	220	205
	106	1000 m larg dhe majtas pikës 2	55	53	61	71	96	56	222	194	154	171

ANEKSI 2. Cilësia e ujërave larës sipas kategorive në përqindje

Shteti	Numri total i Ujërave larës	A (%)	B (%)	C (%)	D (%)
Spanjë	2,275	87.6%	7.8%	1.7%	1.7%
Portugali	667	86.2%	8.5%	1.6%	0.4%
Francë	3,361	74.9%	15.5%	4.1%	2.9%
Gjermani	2,291	90.3%	5.9%	1.6%	0.3%
Hollandë	746	72.3%	17.0%	4.2%	4.3%
Danimarkë	1,044	93.9%	4.3%	0.2%	0.5%
Suedi	468	72.9%	12.0%	4.5%	5.1%
Finlandë	304	87.2%	6.9%	3.0%	1.6%
Estoni	65	66.2%	18.5%	9.2%	3.1%
Letoni	59	74.6%	15.3%	3.4%	1.7%
Belgjikë	130	67.7%	30.0%	2.3%	0.0%
Poloni	739	54.9%	14.3%	4.5%	2.8%
Lituani	121	89.3%	6.6%	3.3%	0.0%
Itali	5,533	90.3%	5.7%	1.9%	1.3%
Greqi	1,731	95.8%	1.0%	0.2%	0.0%
Kroaci	936	96.7%	2.4%	0.5%	0.0%
Bullgari	96	94.8%	5.2%	0.0%	0.0%
Austri	260	96.9%	2.7%	0.4%	0.0%
Qipro	123	97.6%	0.0%	0.0%	0.0%
Çeki	153	79.1%	13.7%	1.3%	0.0%
Hungari	283	62.5%	21.9%	3.5%	2.1%
Malta	148	77.0%	16.2%	3.4%	3.4%
Luksemburg	17	88.2%	11.8%	0.0%	0.0%
Rumani	50	70.0%	30.0%	0.0%	0.0%
Slloveni	47	78.7%	17.0%	2.1%	0.0%
Sllovakia	32	71.9%	18.8%	3.1%	0.0%
Zvicër	196	74.5%	9.7%	2.0%	2.6%
Shqipëri	123	28%	32%	12%	28%

Burimi: Agjencia Evropiane e Mjedisit

ANEKSI 3. Llojet e impianteve për trajtimin e ujërave të përdorura në vitin 2021

Impiantet për trajtimin e ujërave të përdorura në vitin 2021			
Nr.	**Shoqëria Operuese**	**Vendndodhja**	**Lloji i impiantit të trajtimit**
1.	Sh.A UK Shkodër	Shirokë	- Trajtim biologjik me llum aktiv - Nuk shkarkojnë ujëra industriale ne ITUN
2.	Sh.A UK Shkodër	Velipojë	- Uji trajtohet me basene SBR dhe rreze ultraviolet.
3.	Sh.A UK Lezhë	Kune, Shëngjin	- Biodiversitet, trajtim biologjik deri ne nivel primar i avancuar - Nuk shkarkojnë ujëra industriale ne ITUN. - Trupa pritëse Lumë
4.	Sh.A UK Durrës	Porto Romano	- ITUN Durrës përdor një teknologji te llumit aktiv, të avancuar me trajtim biologjik terciar, ku përftohet Biogaz për prodhimin e energjisë elektrike. Përbehet nga: linja e para trajtimit, trajtimit primar, sekondar dhe terciar (reduktim i fosforit) & (Reduktim I azotit) - Trupa pritëse Det
5.	Sh.A UK Durrës	Hamallaj	- Trajtim biologjik me llum aktiv (Pranim /Para trajtim/ Oxigjenim/Dekantues/Trashues/ Qetësues/Centrifuge)
6.	Sh.A UK Kavajë	Qerret Kavaje	- Uji trajtohet ne nivel sekondar. - - Shkarkojnë ujëra industriale ne ITUN dhe janë të para trajtuar. - Trupa pritëse Det
7.	Sh.A UK Vlorë	Vlorë	- Trajtim biologjik me llum aktiv me para trajtim dhe trajtim primar. - Nuk shkarkojnë ujëra industriale ne ITUN - Trupa pritëse Det
8.	Sh.A UK Vlorë	Orikum	- Trajtim biologjik me llum aktiv - I përfunduar pritet te lidhet me sistemin e kanalizimeve
9.	Bashkia Himare	Dhrale, Palase.	- Trajtim biologjik me llum aktiv 1. Grile fine (vetëpastrim); 2. Para sedimentim yndyre, vaj (FOG) vaska e mbledhjes se llumit; 3. Rezervuari i barazimit (i ajrosur); 4. Pompim i vazhdueshëm i rrjedhës; 5. Matja e rrjedhës; 6. Trajtim biologjik; 7. Sedimentim-riciklim llumi & refuzim; 8. Klorinim - pompim te filtrimi; 9. Filtrimi i rërës; 10. Mbledhja e ujit të trajtuar
10.	Bashkia Himare	Drimadhe, Dhermi.	- Trajtim biologjik me llum aktiv - Impianti është në ndërtim
11.	Sh.A UK Sarandë	Çukë.	- Trajtim biologjik me llum aktiv nëpërmjet pondeve te ajruara, trajtimi i ujërave deri në nivel sekondar - Nuk shkarkojnë ujëra industriale ne ITUN - Trupa pritëse Lumë

Burimi: AKUK/ përpunoi grupi i auditimit

ANEKSI 4. Formati i Planit të Veprimit të Kostuar dhe Detajuar

Qëllimi i Politikës II: Zgjerimi dhe përmirësimi i aksesit në sistemet për grumbullimin, largimin dhe trajtimin. Zgjerimi dhe përmirësimi i aksesit në sistemet për grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura për popullsinë.

II. PROGRAMI BUXHETOR: Programi buxhetor i MIE "Ujesjelles Kanalizime"											
Nr.	**Emertimi**	**Kosto indikative (në Lekë)**			**Burimi i mbulimit**						**Hendeku financiar (në Lekë) (pa zbritur tavanet buxhetore 2026-2030)**
					Buxhet Shteti (në Lekë) PBA 2023-2025			**Financim i Huaj (ne Lekë) PBA 2023-2025**			
		KORENTE	**KAPITALE**	**TOTAL KOSTO**	**KORENTE**	**KAPITALE**	**TOTAL KOSTO**	**KORENTE**	**KAPITALE**	**TOTAL KOSTO**	
2.2	**OBJEKTIVI SPECIFIK 2.2:** Rritja e aksesit te popullsise te lidhur me nje ITUN										
2.2.1	Impiante të trajtimit të ujërave të ndotur për aglomerime > se 2000 pe										
2.2.1.1	Vlerësimi i gjendjes aktuale të sistemeve të grumbullimit e trajtimit të ujërave të ndotura si dhe adresimi i nevojave për zgjerim dhe/ose për nivele më të avancuara trajtimi	**75,000,000**	-	**75,000,000**			-			-	**75,000,000**
2.2.1.2	Përcaktimi i nevojave për kolektorë/stacione pompimi shtesë.	**37,500,000**	-	**37,500,000**							**37,500,000**

2.2.1.3	Përgatitja e inventarit të qendrave të banuara me më shumë se 1000 p.e. si bazë për identifikimin dhe përzgjedhjen e aglomerateve.	**22,500,000**	-	**22,500,000**							**22,500,000**
2.2.1.4	Përgatitja e një liste të të gjitha industrive që prodhojnë ujëra të ndotur të biodegradueshëm me ngarkesë ≥ 4,000 p.e.	**22,500,000**	-	**22,500,000**							**22,500,000**
2.2.1.5	Projektimi, Zbatimi dhe Mbikëqyrja e Projekteve të Infrastrukturës për rritjen e mbulimit me impiante trajtimi të ujërave të ndotur.	**799,448,143**	**15,988,962,863**	**16,788,411,006**	**206,435,722**	**1,857,921,500**	**2,064,357,222**	**324,994,580**	**2,924,951,220**	**3,249,945,800**	**11,474,107,984**
	Kosto totale Qëllimi i Politikës II (objektiva specifike 2.2.1)	**956,948,143**	**15,988,962,863**	**16,945,911,006**	**206,435,722**	**1,857,921,500**	**2,064,357,222**	**324,994,580**	**2,924,951,220**	**3,249,945,800**	**11,631,607,984**

ANEKSI 5. Kategorizimi i strukturave akomoduese sipas qyteteve

Qyteti	Bujtine	Fjetinë (Hostel)	Kamping	Hotel	Motel	Resort	Qendër kurative	Fjetje dhe mëngjes (B&B)	Totali i Strukturave të certifikuara	Nr. Dhomash	Numër shtretërish	Numër të punësuarish
Kruja	0	0	0	12	0	1	0	2	15	246	448	121
Durrës	6	2	0	131	3	0	0	19	161	4,478	9,875	2,274
Qarku Durrës	**6**	**2**	**0**	**143**	**3**	**1**	**0**	**21**	**176**	**4,724**	**10,323**	**2,395**
Saranda	1	1	0	104	1	1	0	30	138	3,387	7,397	1,392
Vlora	2	1	0	90	0	1	0	24	118	2,683	6,007	1,286
Orikum	1	1	1	37	0	0	0	7	47	1,205	2,695	461
Himare	2	3	4	85	0	0	0	94	188	3,414	8,994	1,766
Ksamil	1	1	1	79	0	0	0	40	122	1,974	4,462	650
Qarku Vlore	**7**	**7**	**6**	**395**	**1**	**2**	**0**	**195**	**613**	**12,663**	**29,555**	**5,555**
Elbasan	4	0	0	21	3	0	15	2	45	991	2,009	357
Korçë	30	0	0	58	1	0	0	6	95	1,185	2,212	748
Pogradec	8	0	0	19	1	0	0	3	31	822	1,891	241
Qarku Elbasan & Korçë	**42**	**0**	**0**	**98**	**5**	**0**	**15**	**11**	**171**	**2,998**	**6,112**	**1,346**
Tepelene	5	0	0	3	0	0	0	0	8	100	221	94
Gjirokastër	5	1	0	19	1	0	0	10	36	471	955	236
Përmet	4	0	0	5	0	0	0	5	14	159	386	122
Qarku Gjirokastër	**14**	**1**	**0**	**27**	**1**	**0**	**0**	**15**	**58**	**730**	**1,562**	**452**
Bulqize	2	0	0	1	0	0	0	1	4	37	76	31
Burrel	1	0	0	2	0	0	0	0	3	22	42	15
Dibër	9	0	0	11	2	0	1	2	25	503	1,055	128
Qarku Dibër	**12**	**0**	**0**	**14**	**2**	**0**	**1**	**3**	**32**	**562**	**1,173**	**174**
Kurbin	1	0	0	4	1	0	0	0	6	99	134	72
Lezhe	6	2	0	71	1	3	0	24	107	3,385	7,459	1,523
Rreshen	2	0	0	1	0	0	0	0	3	29	65	28
Qarku Lezhe	**9**	**2**	**0**	**76**	**2**	**3**	**0**	**24**	**116**	**3,513**	**7,658**	**1,623**

Tirane	8	10	0	199	7	1	0	40	265	6,437	11,156	3,985
Kavaje	2	1	2	96	0	5	0	17	123	5,777	13,891	3,321
Qarku Tirane	**10**	**11**	**2**	**295**	**7**	**6**	**0**	**57**	**388**	**12,214**	**25,047**	**7,306**
Shkodër	15	2	1	74	0	0	0	104	196	4,326	11,887	1,474
Kukës	1	0	0	3	1	0	0	0	5	102	214	51
Tropoje	8	0	0	8	0	0	0	1	17	249	483	82
Qarku Shkodër & Kukës	**24**	**2**	**1**	**85**	**1**	**0**	**0**	**105**	**218**	**4,677**	**12,584**	**1,607**
Berat	15	1	1	26	2	0	0	2	47	781	1,521	300
Fier	1	0	0	8	0	0	0	2	10	174	352	109
Kuçovë	1	0	1	3	0	0	0	0	5	66	136	31
Lushnje	1	0	0	6	2	0	0	3	12	227	458	85
Skrapar	1	0	0	2	0	0	0	0	3	41	62	10
Qarku Berat &Fier	**19**	**1**	**2**	**45**	**4**	**0**	**0**	**7**	**77**	**1,289**	**2,529**	**535**
Totali	**143**	**26**	**11**	**1178**	**26**	**12**	**16**	**438**	**1,849**	**43,370**	**96,543**	**20,993**

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT